



Save the Children

# MANUAL TRAJNIMI PËR PROFESIONISTËT QË PUNOJNË ME FËMIJËT NË SISTEMIN PENITENCIAR

INFBOTUES

# MANUAL TRAJNIMI PËR PROFESIONISTËT QË PUNOJNË ME FËMIJËT NË SISTEMIN PENITENCIAR

Manuali i trajnimit për profesionistët që punojnë me fëmijët në sistemin penitenciar është përgatitur në kuadër të projektit “Promovimi i Drejtësisë Miqësore për fëmijët në kontakt me ligjin”. Ky manual do t’u shërbejë të gjithë profesionistëve që punojnë me fëmijët në sistemin penitenciar.

Përgatitur nga:

**Dr. Femi Sufaj**  
**Marinela Sota**  
**Rasim Gjoka**

**Koordinoi: Elidjana Hoxha Metani**

**Redaktoi: Olta Çakçiri**

Ky botim publikohet në kuadër të projektit **“Promovimi i Drejtësisë Miqësore për fëmijët në kontakt me ligjin”** të organizatës Save the Children, i cili zbatohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

© 2012 Save the Children

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret për qëllime jo-fitimprurëse, me kusht që ç’do riprodhim të shoqërohet me njohjen e Save the Children si burim.

## Përmbajtja

### **KAPITULLI SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR/INSTRUMENTET DHE STANDARDET**

- Moduli 1 Hyrje në sistemin e drejtësisë për të mitur
- Moduli 2 Instrumentet Ndërkombëtarë të lidhur me Administrimin e Drejtësisë për të Mitur
- Moduli 3 Standardet e kujdesit në kushtet e burgimit

### **KAPITULLI PUNA ME FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT NË SISTEMIN PENITENCIAR**

- Moduli 1 Parimet e punës me fëmijët dhe adoleshentët brenda sistemit penitenciar
- Moduli 2 Praktika e punës në grup me fëmijët në konflikt me ligjin
- Moduli 3 Puna individuale - teknika dhe metoda të punës me fëmijët në konflikt me ligjin
- Moduli 4 Teknika të përfshirjes së fëmijëve
- Moduli 5 Komunikimi i punonjësve të institucioneve penitenciare me fëmijët në konflikt me ligjin, komunikimi midis kolegëve në sektorë të ndryshëm
- Moduli 6 Konsumimi profesional

### **KAPITULLI DREJTËSIA RESTAURUESE**

- Moduli 1 Drejtësia restauruese e orientuar nga të miturit në konflikt me ligjin
- Moduli 2 Procesi i Ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve

# **KAPITULLI: SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR/INSTRUMENTET DHE STANDARDET**

## **MODULI 1**

### **HYRJE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR**

Hyrje

1.1 Kërkesa themelore

1.2. Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin e drejtësisë për të mitur

1.2.1 Termi drejtësi për të mitur

1.2.2 Standardet e vendosura nga KDF dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë

1.2.3 Legjislacioni dhe praktika e vendit tonë.

## **MODULI 2**

### **INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE TË LIDHURA ME ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR**

Hyrje

2.1 Instrumentet kryesore ndërkombëtare

2.2 Konventa për të Drejtat e Fëmijës

2.2.1 Karakteristika të përgjithshme të Konventës

2.2.2 Parimet kryesore

2.2.3 Komente mbi përmbajtjen e Konventës

2.2.4 Diskutime dhe ushtrime mbi zbatimin

## **MODULI 3**

### **STANDARDET E KUJDESIT NË KUSHTET E BURGIMIT**

Hyrje

3.1 Parimet bazë të burgimit dhe mbikëqyrjes

3.2 Menaxhimi i institucioneve për të mitur

3.3 Ushtrime

# MODULI 1

## HYRJE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR

### PËRMBAJTJA

#### HYRJE

1.1 Kërkesa Themelore

1.2 Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin e drejtësisë për të mitur

1.2.1 Termi drejtësi për të mitur

1.2.2 Standardet e vendosura nga KDF dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë

1.2.3 Legjislacioni dhe praktika e vendit tonë

#### OBJEKTIVAT

Në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë të aftë:

- Të identifikojnë dhe të reflektojnë mbi idetë e ndryshme rreth drejtësisë për të mitur.
- Të kuptojnë rolin e aktorëve të ndryshëm në drejtësinë për të mitur dhe nevojën e një qasjeje multidisiplinare.

#### REZULTATET E PRITSHME:

- Pjesëmarrësit do të informohen rreth koncepteve dhe parimeve themelore të drejtësisë për të mitur.
- Do të përmirësohet shërbimi dhe do të rritet efektiviteti i punës në institucionet penale për të mitur.

METODOLOGJIA: *Brainstorming*, Ushtrime në grup, Prezantime në PowerPoint

MJETET: Manual i trajnimit, Video-Projektor, Lap top, *Flipchart*, mjete individuale

PËRSHKRIMI I MODULIT: Moduli prezanton një vështrim të përgjithshëm në sistemin e drejtësisë për të mitur: rolin e aktorëve të ndryshëm në këtë sistem; parimet nga të cilat udhëhiqet drejtësia për të mitur; konceptet bazë si mosha e përgjegjësisë penale; standardet e vendosura dhe situatën në vendin tonë.

## Hyrje

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme të politikave shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Në bazë të këtyre politikave qëndrojnë parimet themelore të Kushtetutës, të konventave të OKB-së dhe të instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se fëmijët, për shkak të veçorive të moshës dhe të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të posaçme nga familja dhe institucionet shtetërore. Kujdes i veçantë në këtë kuadër është treguar ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme sistemin e drejtësisë për të mitur.

Administrimi i drejtësisë për të miturit ka një rëndësi praktike për sistemet e ndryshme ligjore në gjithë botën. Ai pasqyron interesat e shoqërisë për të promovuar shtetin e së drejtës dhe ka për synim riintegrimin e fëmijëve të akuzuar për shkeljen e ligjit.

Drejtësia për të miturit nuk mbulon vetëm situatat në të cilat është shfaqur një konflikt me legjislacionin penal. Ajo përfshin edhe çështje të tilla si parandalimi i delinkuencës, zbatimi i ligjit, gjykimi dhe rehabilitimi. Drejtësia për të mitur është një fushë kyç e politikës sociale e cila merret me fëmijët e marginalizuar dhe të harruar nga ndryshimet social-ekonomike numri i të cilëve është gjithnjë në rritje.

Fusha e veprimit të standardeve ndërkombëtare që lidhen me drejtësinë për të miturit, e ndikuar nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës, pasqyron këto realitete. Shumica e dispozitave të Konventës janë të lidhura drejtpërdrejt me drejtësinë për të miturit. Respektimi i të drejtave si arsimimi, kujdesi shëndetësor, mbrojtja nga abuzimi dhe shfrytëzimi, informacioni i përshtatshëm, një standard i duhur jetese dhe udhëheqja e përshtatshme morale ndihmon në mbajtjen e fëmijëve larg përfshirjes në krime dhe është thelbësor kur trajtohen ata që hyjnë në konflikt me ligjin.

Kërkimet bëjnë të qartë se mbyllja e fëmijëve në institucione është një proces shumë i dhimbshëm për çdo fëmijë; ajo dëmton zhvillimin e fëmijës dhe jep efektin e kundërt në socializimin e tij/saj. Gjithashtu, në përgjithësi, është pranuar që mohimi i lirisë rrallëherë është një masë efektive për sa i përket rehabilitimit, riintegrimin dhe parandalimit të shkeljeve të mëtejshme. Fëmijëve shpesh u mohohet liria për shkelje të vogla jo të dhunshme ose edhe pa kryer asnjë shkelje.

Studimi i të dhënave mbi kriminalitetin, jo vetëm në Shqipëri por në të gjitha vendet e botës, tregon për një rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në krime si subjekte të veprave penale. Në vendet Evropiane, mesatarisht 1.2% e numrit total të të burgosurve janë fëmijë nën 18 vjeç, me një luhajtje nga zero në 6.2%, ndërsa të burgosurit e moshës 18-21 vjeç llogariten të jenë 6.3% e totalit të përgjithshëm, me një luhajtje nga zero në 18.3%<sup>1</sup>. Në Shqipëri, sipas statistikave të v. 2010, janë dënuar në total 656 fëmijë<sup>2</sup>, nga të cilët 594 janë dënuar për krime dhe 62 për kundërvajtje. Këta fëmijë përbëjnë 8.3% të numrit total të të dënuarve (7856). Për çdo 100 mijë fëmijë (mosha 0-18 vjeç) rezulton të jenë dënuar për krime 54 fëmijë. Po të studiojmë tabelën që vijon, rezulton se numri i fëmijëve të përfshirë në kriminalitet ka ardhur duke u rritur, veçanërisht gjatë viteve 2008-2010.

Vitet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
<b>Krime</b>	251	259	313	258	238	198	356	362	594
<b>K/Vajtje</b>	23	49	7	31	30	13	51	49	62
<b>Total</b>	274	308	320	289	268	211	407	411	656

<sup>1</sup>Council of Europe Annual Penal Statistics [Këshilli i Evropës, Statistikat Penale Vjetore], viti 2007

<sup>2</sup>Vjetari Statistikor 2010, botim i Ministrisë së Drejtësisë

## **1.1 KËRKESA THEMELORE**

Sistemi i drejtësisë për të mitur mbështetet në këto parime themelore:

### **1.1.1. Sistemi duhet të jetë i arsyeshëm dhe humanitar**

Të gjithë instrumentet ndërkombëtarë, konventat, udhëzimet dhe rekomandimet mbi të drejtat e njeriut sanksionojnë respektin për dinjitetin e çdo personi dhe të drejtat dhe liritë themelore si e drejta për të jetuar, liria e shprehjes, ndalimi i torturës, e drejta për arsimim dhe e drejta për një standard adekuat të jetesës. Rrjedhimisht, një sistem humanitar është ai që:

a) respekton dinjitetin njerëzor dhe

b) u referohet traktateve dhe deklaratave të ndryshme të OKB-së mbi të drejtat e njeriut dhe zhvillimit të nevojave të fëmijëve.

Një sistem racional është ai që është njëkohësisht efektiv dhe ekonomik në arritjen e qëllimeve dhe kryerjen e misionit të tij. Trajtimi me dinjitet dhe garantimi e respektimi i të drejtave themelore të njeriut përbën bazën e filozofisë së trajtimit dhe sigurimit të të miturve në institucionet penale. Akomodimi i të miturit të dënuar apo nën masën e sigurisë së arrestit me burg, pra kushtet e fjetjes, ushqimit dhe higjienës, kontrollet që ushtrohen, ndihma shëndetësore dhe çdo veprim tjetër duhet të përshkohet nga ndjenjat njerëzore dhe të respektit për dinjitetin njerëzor. Diskutoni me pjesëmarrësit raste në të cilat konstatohen shkelje të të drejtave njerëzore dhe cenim i dinjitetit.

### **1.1.2 Fëmijët duhet të trajtohen me humanizëm**

Në funksion të këtij parimi, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) ndalon në mënyrë të qartë torturën dhe dënimin kapital si dhe burgimin e përjetshëm pa mundësi lirimi për të gjithë personat nën 18 vjeç ndërsa e kufizon përdorimin e privimit të lirisë si një masë e mjet të fundit, kur të gjitha zgjidhjet e tjera alternative nuk duken të përshtatshme. Në rastet në të cilat dënimin me burgim është i nevojshëm, ai duhet të jepet për periudhën më të shkurtër të mundshme. Privimi nga liria nuk mund të jetë i paligjshëm ose arbitrar; ai duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të ndjekë kushtet ligjore duke përfshirë rishikimin nëpërmjet një vendimi gjyqësor. Në rastet e privimit nga liria, fëmijët duhet të trajtohen me humanizëm dhe në një mënyrë që merr parasysh nevojat e tyre të veçanta duke përfshirë të drejtën për të gëzuar asistencë të përshtatshme. Sistemi i drejtësisë për të mitur në vendin tonë është duke bërë progres, vit pas viti, si rezultat i aplikimit të një kuadri ligjor në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjatë vitit 2010, nga 656 të mitur të dënuar për krime dhe kundërvajtje, vetëm 119 janë mbyllur në burg në cilësinë e të arrestuarve dhe të dënuarve. Po kështu, procedura lehtësuese po përdoren për lirim me kusht dhe kalimin në shërbim prove. Politika kriminale për të miturit ka karakter rehabilitues dhe parandalues duke u dhënë të miturve në konflikt me ligjin gjithë asistencën e nevojshme për t'u integruar në shoqëri dhe për të bërë kthesën e duhur. Mbyllja në institucionet penale është një moment shumë i rëndë për të miturit dhe, nëse nuk menaxhohet me kujdes, mund të sjellë ndikime negative tek ata dhe të shkaktojë rënien në mbretërinë e kriminimit.

### **1.1.3 Sistemi duhet të ketë fëmijën në qendër ose të jetë i orientuar drejt fëmijëve**

Një sistem i orientuar drejt fëmijëve i njeh ata si subjekt të lirive dhe të drejtave themelore dhe siguron që të gjitha veprimet me fëmijët të jenë të udhëhequra nga interesi më i lartë i fëmijës. Drejtësia e orientuar drejt fëmijëve nuk bazohet vetëm në ca rregulla të drejtësisë por edhe në rivlerësimin e pandërprerë të programeve të zhvillimit duke u mbështetur në parimet e KDF-së si interesi më i lartë i fëmijës, mosdiskriminimi, pjesëmarrja dhe e drejta e jetës dhe e zhvillimit për të cilat do të diskutohet më gjerësisht në vijim. Mirëpo, ndodh që një punonjës të mos i ketë parasysh këto parime gjatë veprimeve apo vendimeve që merr në lidhje me fëmijët. Ta zëmë se një i mitur kryen një shkelje e cila është e parashikuar në ligj dhe në rregulloren e përgjithshme. Pas shkeljes, mbahet një raport dhe më pas komisioni disiplinor e dëgjon të miturin e në fund vendos një masë



disiplinore të cilën e ka të mbështetur në ligj. Por, nëse do të udhëhiqeshim nga parimi i marrjes në konsideratë të interesit më të lartë të fëmijës, do të shihnim një alternativë tjetër, të ndryshme nga veçimi dhe përjashtimi, e cila do t'i krijonte fëmijës mundësinë për të mos ndërprerë programet që është duke ndjekur dhe do të kishte shumë më tepër ndikim sesa një ndëshkim edhe pse ky i fundit do të ishte i bazuar në ligj.

#### **1.1.4 Sistemi duhet të ketë një qasje multidisiplinare dhe të specializuar**

Sistemi i drejtësisë duhet të synojë të inkurajojë specializimin në praktikën e drejtësisë së fëmijëve dhe zhvillimin e një sistemi të veçantë dhe unik të drejtësisë penale që i trajton fëmijët në një mënyrë të përshtatshme për moshën e tyre dhe nivelin e pjekurisë dhe zhvillon institucione dhe sisteme të projektuara për të arritur këtë qëllim. Qasja e sistemit të drejtësisë duhet të përfshijë të gjithë aktorët nga fillimi dhe të vërë theks të veçantë në bashkëpunimin dhe koordinimin mes subjekteve relevante si policia, prokurorët, gjykatat, avokatët, punëtorët socialë dhe shërbimi i provës, burgjet dhe paraburgimet, programet e diversionit etj.

Diskutoni me pjesëmarrësit si është bashkëpunimi i shërbimit të burgjeve dhe paraburgimeve me shërbimin e provës, me shërbimet e tjera sociale, me familjen e të miturit dhe me gjykatën; si është bashkëpunimi brenda ekipit multidisiplinar të një institucioni penal të përbërë nga shërbimi social, shërbimi i sigurisë, shërbimi shëndetësor, shërbimi ligjor etj.

Më poshtë jepen disa **terma të nevojshëm** që lidhen me drejtësinë për të mitur të cilat janë marrë nga Juvenile Justice Training Manual [Manual Trajnimi mbi Drejtësinë për të Mitur], botim i UNICEF dhe Penal Reforme International. Shpjegime të këtyre termave gjenden edhe në akte të brendshme si Ligji nr. 10347, datë 1.11.2010, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës” si dhe në shumë publikime të tjera.

*Të dhëna të sakta për drejtësinë për të rinjtë:* Mbajtja minimale e të dhënave duhet të përfshijë emrin e çdo fëmije, datën e lindjes, krimin e supozuar ose arsyen për ndalim, anëtarët e familjes ose kujdestarët aktualë, vendin apo vendet e ndalimit, datën dhe arsyen për transferimet ndërmjet institucioneve dhe historinë gjyqësore.

*Gjykoj:* Të zgjidhësh një rast nëpërmjet procedurës gjyqësore.

*Seancë dëgjimi për gjykim:* Fazë në procedurat e gjyqit në të cilën paraqiten argumentet, dëshmitë dhe provat për të përcaktuar nëse një fëmijë e ka kryer me të vërtetë krimin e supozuar.

*Paskujdesja:* Mbikëqyrje dhe kujdes për fëmijët pasi largohen nga programet komunitare ose lirohen nga institucionet për të miturit. Paskujdesja mund të përfshijë provën, këshillimin dhe regjistrimin në një program komunitar ose forma të tjera të trajtimit. Shërbimet e mbikëqyrjes planifikohen për të mbështetur kthimin e fëmijëve te familjet dhe komunitetet e tyre dhe për të zvogëluar mundësinë që ata të futen prapë në telashe.

*Alternativa ndaj burgosjes:* Mund t'i referohet një qortimi ose paralajmërimi nga policia; një kërkesë ndjese me shkrim ose me gojë; një eseje me shkrim për efektet e krimit të kryer; shërbimit/punës në komunitet; dëmshpërblimit për viktimën; pjesëmarrjes në një kurs për aftësimin për jetën; këshillimit ose trajtimit terapeutik për abuzimin me drogat ose alkoolin apo programeve të tjera të drejtësisë restauruese.

*Paralajmërim:* Paralajmërim zyrtar që i jepet shkelësve që pranojnë fajin e tyre.

*Institucione riedukimi:* Institucione për izolimin e individëve të akuzuar ose të dënuar për veprimtari penale ose delinkuente.

*Përgjegjësia penale:* Moshë e përgjegjësisë penale është momenti kur një fëmijë është përgjegjës për sjelljen e tij/saj dhe mund të deklarohet fajtor nga gjykata.

*Kriteret për ndalimin përpara gjyqit:* Kushtet bazë që duhet të plotësohen për të justifikuar ndalimin e fëmijëve përpara bërjes së gjyqit. Këto kriterë mund të përfshijnë dosje të mëparshme penale, rrezikun e largimit, mungesën e kujdestarëve me të cilët fëmija të mund të qëndrojë etj.

*Ruajtje:* Shih "Heqja e lirisë/burgosja".

*Heqja e lirisë/burgosja:* Çdo formë burgimi ose vendosjeje e fëmijës në një situatë kujdestarie publike ose private, nga e cila fëmija nuk lejohet të largohet sipas dëshirës, me anë të një urdhri të lëshuar nga një autoritet gjyqësor, administrativ apo çdo autoritet tjetër publik. Kjo nënkupton çdo formë të vendosjes rezidenciale, përfshirë dhomat e paraburgimit të policisë, shkollat e kualifikimit, shkollat e riedukimit, qendrat e trajtimit, shkollat e reformimit, qendrat e edukimit dhe riedukimit, shtëpitë e dorëzarisë, qendrat e trajnimit, institucionet specifike për të rinjtë ose institucione të riedukimit të të rriturve, përfshirë institucione të sigurisë së lartë.

*Burgosja me të rriturit:*

*Në komisariate:* Rastet në të cilat fëmijët dhe të rriturit mbahen në të njëjtën qeli.

*Në institucione riedukimi:* Kur fëmijët mbahen në të njëjtat institucione riedukimi ku mbahen edhe të rriturit, përfshirë në të njëjtën godinë apo në të njëjtën qeli, dhe ndërveprojnë me të rriturit gjatë periudhave të çlodhjes ose vakteve të ngrënies.

*Ndalimi:* Izolimi i përkohshëm i një fëmije të supozuar si delinkuent në pritje të lirimit përpara gjyqit, procedurave gjyqësore ose masave.

*Masat:* Vendim i marrë në lidhje me rastin e një fëmije. Shembujt përfshijnë p.sh. vendimin e një gjyqtari të gjykatës rinore për të rrëzuar një padi ose për të urdhëruar një fëmijë të marrë pjesë në një program të trajtimit të drogave ose të kryejë shërbime komunitare. Masat që mund të merren nga gjykata rinore ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- *Rrëzim padie:* Një urdhër i gjykatës për të ndërprerë një çështje pa kryer gjykimin e rastit. Rrëzimi mund të ndodhë kur nuk ka prova të mjaftueshme për ta çuar çështjen në gjykim, kur nuk priten vendime ose veprime të mëtejshme ose kur rasti është duke u shqyrtuar nga një gjykatë tjetër.
- *Vendosje:* Largimi nga shtëpia i një fëmije që ka kryer një shkelje dhe vendosja e tij/saj për një periudhë të caktuar kohe diku tjetër, në një *institucion rinor* apo institucion tjetër.
- *Prova:* Vendosja e një fëmije që ka kryer një shkelje nën mbikëqyrjen e gjykatës. Gjatë provës, fëmija duhet të ruajë një sjellje të mirë, të mos kryejë shkelje tjetër dhe të plotësojë çdo kusht tjetër që gjykata mund ta gjykojë të përshtatshëm për t'u vënë.
- *Prova përpara gjykimit:* Vendosja në provë e një fëmije që ka kryer një shkelje përpara se gjykatësi të marrë një vendim përfundimtar. Përfundimi i suksesshëm i periudhës së provës rezulton në një *rrëzim* të plotë të akuzave për përfshirje të fëmijës në shkelje.

*Seanca e dhënies së masës:* Seancë e mbajtur pas *seancës së marrjes së vendimit* në të cilën gjykatësi vendos masat për një *çështje* që lidhet me një fëmijë.

*Shmangia (Diversioni):* Kanalizimi i fëmijëve larg sistemit formal të drejtësisë nëpërmjet procedurave dhe programeve alternative. Një fëmijë, për shembull, mund të referohet në një program shërbimi për komunitetin për të kryer punë vullnetare në mënyrë që të “shlyejë borxhin” me komunitetin.

*Plane individuale rehabilitimi:* Një dokument që përshkruan karakteristikat e veçanta të një konflikti që ka fëmija me ligjin, i cili hartohet për të përshtatur rehabilitimin me çdo të mitur individualisht. Në qoftë se këto shërbime, siç janë këshillimi për abuzimin me substancat, këshillimi për familjen ose mbështetja për arsimim, janë të nevojshme, ato do të përshkruhen në një plan individual të rehabilitimit të të miturit.

*Seancë dëgjimore:* Një procedurë e gjykatës për të caktuar një mënyrë veprimi ose për të vendosur mbi përfshirjen ose mospërfshirjen e një fëmije në një shkelje. Në marrjen e vendimit dëgjojnë argumentet, dëshmitarët dhe faktet nga një zyrtar i gjyqësorit ose nga një organ administrativ.

*Ndalim/arrestim:* Veprimi i marrjes së një fëmije në ruajtje nga policia me synimin për ta akuzuar atë për një vepër penale. Procesi i drejtësisë për të miturit shpesh fillon me një hetim nga një oficer policie, o sepse oficeri vëren një kundërvajtje gjatë momentit të kryerjes, o sepse një akt i tillë është denoncuar. Në momentin e ndalimit ose arrestimit, oficeri i policisë, në përgjithësi, ndërmerr një nga këta tre hapa: 1) E lë fëmijën të lirë dhe e dërgon pranë prindërve të tij/saj me një vërejtje ose qortim 2) E liron fëmijën dhe e çon pranë prindërve me kushtin që fëmija të futet në një program komunitar diversioni 3) E mban fëmijën në ruajtje dhe referon rastin në gjykatat për të miturit për procedim të mëtejshëm.

*I mitur (Juvenile):* Një fëmijë në ose nën moshën maksimale që hyn në kompetencat e *gjykatës për të rinjtë*, sikurse përcaktuar në legjisllacionin vendor. Në shumicën e shteteve hyjnë në juridiksionin e gjykatës për të miturit fëmijët e moshës 18 vjeç ose më pak.

*Gjykatë për të miturit:* Një gjykatë që ka autoritet për çështjet që përfshijnë individët nën një moshë të caktuar, zakonisht 18 vjeç.

*Drejtësia për të miturit:* Legjisllacioni, normat dhe standardet, procedurat, mekanizmat dhe dispozitat, institucionet dhe organet që aplikohen në mënyrë specifike për shkelësit e mitur. Këto nuk janë domosdoshmërisht të inkuadruara brenda një sistemi të veçantë të drejtësisë për të miturit. Në kodin penal, për shembull, mund të ekzistojnë dispozita të veçanta për të miturit, megjithëse ato trajtohen në gjykatën penale dhe jo në atë për të miturit.

*Aftësitë për jetën:* Aftësitë që u nevojiten njerëzve për të ndërtuar një jetesë të qëndrueshme dhe për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri.

*Përfaqësim ligjor:* Përfaqësim në gjykatë nga një avokat i kualifikuar. Kjo nuk është njësoj me “asistencën ligjore”, e cila mund të ofrohet nga OJF-të, asistentët ligjorë ose edhe drejtpërdrejt nëpërmjet trajnimit për të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin.

*Ndërmjetësimi:* Një procedurë alternative ndaj asaj gjyqësore në të cilën një person neutral ndihmon dy ose më shumë njerëz të zgjidhin një konflikt dhe të arrijnë një zgjidhje të pranueshme për të gjitha palët.

*Mosha minimale e përgjegjësisë penale:* Mosha nën të cilën fëmijët nuk konsiderohen të aftë për të kryer shkelje të legjisllacionit penal. *Shënim:* Kodet penale shpesh përjashtojnë marrjen në konsideratë të moshës minimale në rastet e krimeve shumë serioze. Fëmijët që janë nën moshën minimale të përgjegjësisë penale

duhet të njoftohen pasi dispozitat për trajtimin e këtyre fëmijëve mund të jenë të dykuptimta, çka mund të sjellë abuzim.

*Paralajmërim ose qortim nga policia:* Paralajmërimi nga policia është një formë e *shmangies* së “nivelet të parë” ose “informale” dhe mund të parandalojë që fëmijë që kanë kryer shkelje të vogla ose që nuk kanë kryer shkelje të kalojnë kohë në institucionet e burgimit.

*Shmangie paragjyqësore:* Rastet për të cilat është aplikuar shmangia përpara gjyqit zakonisht kërkojnë që fëmijët shkelës të pranojnë kushtet e një ose më shumë sanksioneve që mund të përfshijnë shërbimin në komunitet, dëmshpërblimin e viktimës, ndërmjetësimin/takimin familjar ose provën. Me qëllim që të kuptohet deri ku mund të shtrihet përdorimi i shmangies paragjyqësore, duhet të analizohen të gjithë mekanizmat e mundshëm të saj në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve të të miturve.

*Prova:* Vendosja e një fëmije që ka kryer një shkelje nën mbikëqyrjen e gjykatës. Gjatë provës, fëmija duhet të ketë një sjellje të mirë, të mos kryejë shkelje të reja dhe të plotësojë çdo kusht tjetër që gjykata mund ta gjykojë të përshtatshme të vendosë.

*Prova përpara gjykimit:* Vendosja e një fëmije që ka kryer një shkelje në provë përpara se gjykatësi të marrë një vendim përfundimtar. Plotësimi me sukses i periudhës së provës rezulton në një rënie të plotë të akuzave për përfshirjen e fëmijës në shkelje.

*Recidivizmi:* Përsëritja e sjelljes kriminale.

*Programi rezidencial:* Program që zhvillohet në mjedise strehimi në të cilat fëmijët jetojnë që janë të ofruara nga vetë programi. Programet rezidenciale nuk kanë rrethimet dhe pajisjet e sigurisë që zakonisht shoqërojnë *mjediset e korrektimit ose të burgimit*. Një program rezidencial, për shembull, mund të zhvillohet në një ndërtesë të kthyer në pallat me apartamente ose në një shtëpi përdhese.

*Drejtësia restauruese:* Drejtësia që e bën kundërvajtësin përgjegjës për riparimin e një dëmi të shkaktuar nga ai vetë, i jep kundërvajtësit një mundësi për të provuar aftësitë dhe cilësitë e tij pozitive dhe për të analizuar ndjenjat e fajit në mënyrë konstruktive dhe përfshin edhe personat e tjerë apo strukturat që kanë një rol në zgjidhjen e konfliktit siç mund të jenë viktimat, prindërit, anëtarët e tjerë të familjes, shkollat dhe bashkëmoshatarët.

*Raport i hetimit social:* Raporti i hetimit social është një vlerësim i rrethanave të kaluara dhe aktuale sociale të një personi të akuzuar dhe i nevojave dhe motivimit të tij për të marrë trajtim ose forma të tjera alternative të kujdesit joizolues (p.sh. urdhër për punë në komunitet, provë). Shih gjithashtu: *Plan individual i rehabilitimit*.

*Kufijtë kohorë për ndalimin paragjyqësor:* Kufijtë kohorë ligjorë për ndalimin paragjyqësor luhaten nga 24 në 48 orë përpara daljes para gjykatësit. Kufiri kohor ligjor nuk duhet ta tejkalojë këtë hark kohor.

*Torturë:* Një akt me anë të të cilit i shkaktohet qëllimisht një personi dhimbje ose vuajtje e rëndë, fizike ose mendore, me synimin për të marrë nga ai/ajo informacion mbi një person të tretë ose një rrëfim, duke e dënuar atë për një akt që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet se ka kryer ose duke e frikësuar apo duke e detyruar atë, ose për çdo arsye tjetër të bazuar në diskriminim të çdo lloji, kur kjo dhimbje ose vuajtje shkaktohet nga apo me nxitjen, miratimin ose dijeninë e një zyrtari publik apo një personi që ka një detyrë publike. Këtu nuk përfshihet dhimbja ose vuajtja që vjen vetëm si rezultat apo është pjesë përbërëse ose

aksidentale e sanksioneve ligjore. [Neni 1: Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Brutale, Çnjerëzore ose Degraduese]<sup>3</sup>.

## 1.2 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR

1.2.1 Termi “drejtësia për të mitur”

1.2.2 Standardet e vendosura nga KDF dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë

1.2.3 Legjislacioni dhe praktika e vendit tonë.

### 1.2.1 Termi “drejtësia për të mitur”

Në këtë nënçështje do të diskutojmë termat për të kuptuar se çfarë përfaqëson sistemi i drejtësisë për të mitur, çfarë dallimesh ka në raport me sistemin e drejtësisë për të rritur, cili është raporti dhe në çfarë marrëdhëniesh duhet të jenë aktorët e ndryshëm të sistemit të drejtësisë për të mitur - policia, prokuroria, gjykatat, institutet penale për të mitur (qendrat e ndalimit, të paraburgimit dhe burgjet), shërbimet sociale për të mitur, shërbimi i provës, mbrojtja ligjore, qendrat joqeveritare të asistencës psikologjike dhe ligjore për fëmijë - kush konsiderohet fëmijë sipas KDF dhe legjislacionit të vendit tonë etj.

Në teori, sistemi i drejtësisë për të mitur përbëhet nga legjislacioni, procedurat dhe proceset, personeli dhe institucionet të përfshirë në trajtimin e fëmijëve të cilët kryejnë veprat penale. “*Sistemi i drejtësisë për të mitur përbëhet nga ligjet, politikat, udhëzuesit, normat zakonore, sistemet, profesionistët, institucionet për trajtim të posaçëm për fëmijët në konflikt me ligjin*”<sup>4</sup>. Për shkak të nevojave specifike dhe rrethanave të fëmijëve, funksionimi i këtij sistemi duhet të jetë i ndryshëm nga funksionimi i sistemit të drejtësisë për të rritur. Megjithatë, në realitet, ka probleme me sistemin e drejtësisë për të miturit.

Nuk ekziston një sistem i vetëm por një përzierje komplekse dhe mbivendosje në mes shumë sistemeve të ndryshme: fëmijët kalojnë përmes proceseve, institucioneve dhe personelit të një shumëllojshmërie departamentesh të ndryshme qeveritare, agjencish dhe organizatash të tilla si policia, shërbimet sociale dhe departamentet e provës, gjyqësori, qendrat e paraburgimit dhe burgjet. Edhe pse këto institucione janë menduar të jenë të ndërlidhura, të koordinuara dhe të ndërvarura, në realitet, çdo sektor ka buxhetin, mandatin, autoritetin dhe rregulloren e vet dhe jo kurdoherë shihet një bashkëpunim dhe koordinim i rregullt midis tyre.

Kodi Penal i Shqipërisë nuk ka një përkufizim të qartë se kush konsiderohet fëmijë në konflikt me ligjin. Një dispozitë e K. Penal shprehet se një person nën 14 vjeç nuk ka përgjegjësi penale. Për kundërvajtjet penale mosha e përgjegjësisë penale është 16 vjeç. Në një dispozitë tjetër thuhet se “Për të miturit të cilët në momentin që kanë kryer krimin ishin nën 18 vjeç dënimi me burgim nuk mund të kalojë gjysmën e dënimit të vendosur nga ligji për aktet penale të kryera”.

Mosha e përgjegjësisë penale në vendet e BE është si vijon:

<sup>3</sup>Juvenile Justice Training Manual, botim i UNICEF dhe Penal Reforme International

<sup>4</sup> Manual për matjen e treguesve të drejtësisë për të miturit, botim i United Nations, Office on Drugs and Crime dhe UNICEF, New York 2006

Austria 14  
 Belgjika 16\*/\*\*18  
 Bullgaria 14  
 Qipro 7  
 Rep. Çeke 15  
 Danimarka 15  
 Estonia 14  
 Finlanda 15  
 Franca 10\*\*\*/13  
 Gjermania 14  
 Greqia 8\*\*\*/13  
 Hungaria 14  
 Irlanda 12  
 Italia 14  
 Lituania 14\*\*/16  
 Letonia 14  
 Luksemburgu 10  
 Malta 9  
 Holanda 12  
 Polonia 13  
 Portugalia 12\*\*\*\*/16  
 Rumania 14\*\*/16  
 Sllovakia 14/15  
 Sllovenia 14\*\*/16  
 Spanja 14  
 Suedia 15  
 Britania e Madhe 10

(shënim \*vetëm për shkelje trafiku, \*\*për krime serioze, \*\*\*vetëm masa edukative, \*\*\*\*mbrojtje e veçantë e fëmijëve)

Mosha e përgjegjësisë penale përcakton moshën në të cilën veprimet e kryera nga fëmijët mund të trajtohen sipas ligjit penal. Kjo luhetet së tepërmi nga njëri shtet në tjetrin. Po ashtu, ka përkufizime të ndryshme ligjore të moshës në të cilën një fëmijë mund të mbahet i burgosur në godinat e sistemit të burgjeve. Legjislacioni ndërkombëtar është shumë i qartë në lidhje me cili duhet të konsiderohet fëmijë. KDF, neni 1, thotë se “...me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më para në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet”. Instrumentet ndërkombëtare për drejtësinë penale kanë të njëjtin përkufizim për të miturit. Në Rregullat e Kombeve të Bashkuara “Për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria” rregulli nr 11 a) thotë: I mitur është çdo person nën 18 vjeç. Në disa shtete, asnjë person nën 18 vjeç nuk dënohet me burgim. Këta të rinj duhet të mbahen nën

kujdestarinë e një agjencie sociale dhe jo në një vend i cili është pjesë e sistemit të drejtësisë penale. Për të miturit burgimi duhet të jetë masa e fundit dhe të aplikohet për raste të veçanta.

### 1.2.2 Standardet e vendosura nga KDF dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë

Neni 40 i KDF përcakton një listë me minimumin e garancive që duhet të jenë të vlefshme për një fëmijë që akuzohet për një vepër penale. Disa reflektojnë parimet e parashikuara më parë për çdo person, përfshirë edhe fëmijët, në instrumente të tjerë ndërkombëtarë, por disa të tjera janë të aplikueshme posaçërisht për fëmijët. “Rregullat e Pekinit” vendosin: Garancitë themelore procedurale si prezumimi i pafajësisë, e drejta për t’u informuar në lidhje me akuzën, e drejta për të mos folur, e drejta për t’u këshilluar, e drejta për të pasur të pranishëm një prind ose kujdestar ligjor, e drejta për të pyetur dëshmitarët dhe e drejta për të apeluar vendimin në një shkallë më të lartë duhet të garantohen në të gjitha shkallët e procedimit.

Të gjitha këto janë çështje me rëndësi që përfaqësojnë elementë thelbësorë për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe që janë të njohura botërisht në instrumentet ekzistues të të drejtave të njeriut. Procedurat duhet të drejtohen nga interesi më i lartë i të miturit dhe duhet të kryhen në një atmosferë mirëkuptimi e cila ta lejojë të miturin të marrë pjesë dhe të shprehet lirisht.

- *Të prezumohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia*

Kjo reflekton dispozitat e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, neni 11, dhe të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14 (2). Raste të zbatimit të procedurave duke bërë presion mbi fëmijët, duke u drejtuar atyre pyetje provokuese dhe sugjestionuese, të shoqëruara herë-herë me presion psikologjik apo fizik si dhe një trajtim në institucionet penale në mënyrë të ndryshme nga të dënuarit, bien ndesh me standardin e prezumimit të pafajësisë.

- *Të informohet menjëherë dhe drejtpërdrejt për akuzat e ngritura kundër tij, nëse është e përshtatshme me anë të prindërve ose përfaqësuesve ligjorë, dhe të marrë ndihmën juridike ose çdo ndihmë tjetër për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij.*

Neni 9 (2) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon që kushdo që arrestohet të informohet menjëherë për çdo akuzë që drejtohet ndaj tij. “Konventa shton edhe kërkesën për të informuar të miturin”, nëse është e përshtatshme, nëpërmjet prindit ose kujdestarit ligjor dhe kjo kërkesë shtohet në kuadrin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.

- *Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë.*

Dispozita të tilla të ngjashme ekzistojnë në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut neni 10 dhe në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Konventa kërkon një gjykim pa vonesë të tepruar në rastin e fëmijëve. Neni 40 nuk i referohet paraburgimit sepse neni 37 kërkon që kufizimi i lirisë, në çdo rast, të përdoret si një masë ekstreme dhe për një periudhë sa më të shkurtër të mundshme.

- *Të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes ose të pohojë veten fajtor, të merren në pyetje ose të bëjë të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta.*

Kjo sipas Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14 , të cilat kërkojnë që, në përcaktimin e akuzës penale, çdo person të ketë të drejtën të mos detyrohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë.

- *Në qoftë se vendoset se ka shkelur ligjin penal, të bëjë ankim kundër këtij vendimi si dhe çdo mase të marrë si pasojë para një autoriteti ose instance gjyqësore kompetente më të lartë, të pavarur dhe të paanshme, në përputhje me ligjin.*

Neni 14 (5) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon sa vijon: "Çdo person i dënuar për një krim duhet të ketë të drejtën e rishikimit të vendimit dhe dënimit të tij nga një gjykatë më e lartë sipas ligjit".

- *Të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret.*

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14(3) garanton të njëjtën të drejtë. Kjo është e rëndësishme jo vetëm në rastin e një fëmije që flet një gjuhë tjetër por edhe në rastin e një fëmije me aftësi të kufizuara.

- *Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.*

Neni 14(1) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon rregulla të përgjithshme në lidhje me dëgjimin publik të seancave, duke përcaktuar raste të veçanta në të cilat shtypi dhe publiku mund të mos lejohen të marrin pjesë: "çdo gjykim i bërë për një çështje penale ose gjatë një procesi gjyqësor duhet të bëhet publik, me përjashtim të rasteve kur interesi i të miturve kërkon ndryshe ose në qoftë se procesi ka të bëjë me mosmarrëveshje martesore ose me kujdestarinë e fëmijës". Rregullat e Pekinit e zgjerojnë përmbajtjen e saj. "E drejta e fëmijës për fshehtësi duhet të respektohet në të gjitha shkallët e gjyqimit në mënyrë të tillë që të shmanget çdo dëmtim që mund t'i shkaktohet fëmijës nga publiciteti i tepërm. Në parim, asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e fëmijës që abuzohet nuk duhet të publikohet". Kjo dispozitë thekson rëndësinë e mbrojtjes së jetës private për të miturin. Të miturit janë veçanërisht të prekshëm ndaj stigmatizimeve.

Shtetet Anëtare duhet të bëjnë përpjekje për të promovuar nxjerrjen e ligjeve dhe krijimin e procedurave, autoriteteve dhe institucioneve që merren me fëmijët që hetohen, akuzohen ose që njihen si faktorë për shkeljen e ligjit penal. Komiteti vazhdimisht ka propozuar një sistem të ndryshëm drejtësie për të miturit. Rregullat e Pekinit theksojnë se "Përpjekje të shumta duhen bërë për të vendosur në çdo legjislacion kombëtar disa ligje, rregulla dhe dispozita të aplikueshme në mënyrë të veçantë për të miturit dhe institucione të caktuara për funksionimin e administrimit të drejtësisë për të mitur, të cilët duhet :

- a) Të përmbushin nevojat e të miturit, ndërkohë që mbrojnë të drejtat e tij themelore.
- b) Të përmbushin nevojat e shoqërisë.
- c) Të zbatojnë rregullat me drejtësi dhe paanshmëri.

Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ka hartuar disa rekomandime specifike në zbatim të nenit 40 të KDF. Komiteti ka konstatuar se, në shumicën e shteteve anëtare, nuk janë caktuar gjyqtarë për të miturit dhe ka mangësi në programet e trajnimit të këtyre gjyqtarëve. Komiteti ka mirëpritur përshtatjet e fundit dhe hyrjen në fuqi të kodeve të reja për të miturit të cilët përfaqësojnë një progres të rëndësishëm drejt harmonizimit të legjislacionit dhe të politikave me dispozitat e Konventës dhe sigurimin e një kuadri ligjor për zbatimin e saj.



Duhet të përcaktohet mosha minimale nën të cilën fëmijët do të konsideroheshin si të papërgjegjshëm për veprimet e tyre kundër ligjit penal: Në këtë aspekt legjislacioni ynë është në përputhje me standardet e KDF. Mosha e përgjegjësisë penale në Shqipëri është 14 vjeç për krime dhe 16 për kundërvajtje.

Duhet të përdoren masa të përshtatshme për t'i trajtuar këta fëmijë, duke shmangur procedurat gjyqësore dhe duke siguruar respektin e plotë të të drejtave të njeriut dhe garancive ligjore. "Rregullat e Pekinit" e zgjerojnë kuptimin e tyre në mbështetjen që i bëjnë shmangies së procedimit penal në rregullin 11. një

Duhet të merret në konsideratë që, kur kemi të bëjmë me shkelës të ligjit që janë të mitur, të bëhet e mundur shmangia e procedimit penal nga autoritetet përkatëse, sipas rregullit 14(1).

Policia, prokuroria ose agjenci të tjera që kanë të bëjnë me çështjen e të miturve duhet të autorizohen të merren me këtë çështje sipas diskrecionit të tyre, pa iu drejtuar seanceve formale, në përputhje me kriteret e përshkruara më poshtë të pasqyruara në legjislacionin vendës si dhe me parimet që përmbajnë këto rregulla.

Çdo shmangie nga këto procedura duhet të kërkohet nga i mituri, prindi ose kujdestari ligjor dhe ky vendim duhet të merret nga autoriteti përkatës.

Një sërë dispozitash si urdhrat e mbikëqyrjes, përkujdesjes, drejtimit, këshillimeve, lirimit me kusht dhe riedukimit; programet e trajtimit, edukimit dhe mësimin të profesioneve dhe alternativa të tjera të përkujdesjes nga ana e institucioneve duhet të jenë të pranishme për të siguruar që fëmijët të trajtohen në mënyrë të përshtatshme dhe në përpjesëtim me rrethanat dhe kundërvajtjen e tyre (Neni40).

#### **1.2.4 Legjislacioni dhe praktika e vendit tonë**

Dispozitat ligjore lidhur me të miturit në vendin tonë janë të shpërndara në shumë kode dhe akte nënligjore. Mungon një legjislacion ose kod gjithëpërfshirës lidhur me drejtësinë për të mitur, siç parashikohet në Rregullat e Pekinit. Nuk ka një sistem ligjor të unifikuar vetëm për të mitur. Ka ligje brenda të cilëve të miturit trajtohen në mënyrë të veçantë, ka akte të tjera ku të miturit trajtohen pa dallim nga të rriturit. Deri tani, është bërë një punë e konsiderueshme nga shteti shqiptar për përshtatjen e legjislacionit vendas në frymën e instrumenteve ndërkombëtare por aplikimi në praktikë mbetet çështja më e rëndësishme ku duhet vënë theksi në mënyrë të vazhdueshme.

Kushtetuta është ligji themelor në të cilin deklarohen politikat dhe vlerat më të thella të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës, dinjiteti i njeriut dhe liritë e tij janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe mbrojtë". Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese. Në Kushtetutën e vendit përcaktohet se çdo person të cilit i është hequr liria ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij. Në bazë të legjislacionit shqiptar, të pandehurit të mitur i sigurohet ndihma juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon. Gjatë fazës së gjykimit, sipas moshës së të miturit, gjykata mban parasysh kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

Kodi i Procedurës Penale përcakton një sërë garancish për mbrojtjen e të miturve dhe personalitetit të tyre, konkretisht: pyetja e të miturit në seancë me dyer të mbyllura; e drejta e përfaqësuesit ligjor

të të miturit për të mbrojtur interesat e tij me cilësinë e të dëmtuarit akuzues; mbrojtja e detyrueshme profesionale për të miturin nën 18 vjeç; ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve dhe të fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të të miturit të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale; mosarrestimi për një vepër penale që përbën kundërvajtje. Kodi penal ka parashikuar moshën e përgjegjësive penale dhe dënimin e të miturit me ½ e masës së dënimit që mund të marrë një i rritur.

Në gjykatat e shkallës së parë, me dekret të Presidentit nr. 5351, datë 11.06.2007, janë krijuar seksionet e gjykatave për të mitur në gjashtë gjykata të vendit. Sipas Ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor, është parashikuar përfshirja në përbërjen e trupit gjykues për çështjet e të miturve e një psikologu. Në ligjin nr. 8645, datë 11.03.1999, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve” është parashikuar zgjidhja e kundërvajtjeve penale pa iu drejtuar procedurës gjyqësore. Ligji nuk shprehet në mënyrë të veçantë për të miturit por i përfshin ata në kategorinë e personave që kanë kryer një kundërvajtje penale pavarësisht nga mosha.

Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale dhe Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me paraburgim dhe të paraburgosurve parashikojnë mbajtjen e të miturve në institucione të veçanta ose në seksione të veçanta të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale. Gjithashtu, këto ligje parashikojnë lehtësira në procedurat e vizitave, informimit, ndihmës së psikologut, aplikimit të programeve riintegruese, arsimit të detyruar etj.

Një nga aktet më të rëndësishme të shtetit shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është Ligji nr. 10347, datë 1.11.2010. Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën<sup>5</sup>. Ligji ka për qëllim:

a) *mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjisllacionit në fuqi;*

b) *marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;*

c) *marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;*

ç) *sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.*

---

<sup>5</sup>Copyright 2012 - [www.ligjet.org](http://www.ligjet.org), Ligji nr. 10347, datë 1.11.2010, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”

Ligji ka dhënë edhe disa përkufizime të termave që lidhen me fëmijët. Kështu, ndërmyet disa përkufizimeve, në ligj gjen pasqyrim edhe termi “ fëmijë”. "Fëmijë" është çdo person i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht<sup>6</sup>. Ky përkufizim është më i gjerë se ai që jepet në nenin 2 të KDF apo në akte të tjera të deritanishme brenda vendit. Kështu, duke u mbështetur në parimin e “dyshimit të arsyeshëm”, ligji ka bërë një zgjerim të konceptit duke orientuar drejt organet e policisë, prokurorisë apo të zbatimit të vendimeve penale që, në rastet kur mungojnë të dhënat e sakta për përcaktimin e saktë të moshës por ekzistojnë arsye për të menduar se personi është fëmijë, personi duhet të trajtohet me statusin e fëmijës, deri sa të saktësohet mosha e tij. Në lidhje me termat e tjerë, referojuni nenit 3 të Ligjit nr. 10347, datë 1.11.2010.

Në nenin 5 të Ligjit Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës janë sanksionuar parimet kryesore për t’u mbajtur në konsideratë nga të gjithë personat juridikë apo fizikë të cilët do të merren me fëmijët. Mbrojtja e të drejtave bëhet duke garantuar:

*1. Interesin më të lartë të fëmijës, si konsideratë mbizotëruese, në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative ose legjislativë.*

*2. Barazinë dhe asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij.*

*3. Eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinioneve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.*

*4. Respektimin e përgjegjësisë, të të drejtave dhe të detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën.*

*5. Krijimin e kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim.*

*6. Parimin e respektimit të mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.*

Ligji, ka sanksionuar një paketë të rëndësishme të lirive dhe të drejtave të fëmijës, si:

*E drejta e jetës, e mbijetesës dhe e drejta për zhvillim (neni 6).*

---

<sup>6</sup> Po aty.

*E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe për të ruajtur identitetin (neni 7).*

*E drejta për të qëndruar me prindërit (neni 8).*

*E drejta për ribashkim familjar (neni 9).*

*E drejta për të siguruar kthimin (neni 10).*

*E drejta e shprehjes (neni 11).*

*Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë (neni 12).*

*Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore (neni 13).*

*Liria e jetës private (neni 14).*

*E drejta për të marrë informacion (neni 15).*

*E drejta për arsimim (neni 16).*

*E drejta për pushime dhe argëtime kulturore e sportive (neni 17).*

*E drejta për një nivel jetese të përshtatshëm (neni 18).*

*E drejta për kujdes shëndetësor (neni 19).*

*E drejta për mbrojtje sociale (neni 20).*

*Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës (neni 21).*

*Fëmija mbrohet nga çdo formë e: a) dhunës fizike dhe psikologjike; b) ndëshkimit trupor dhe trajtimit poshtërues e denigrues; c) diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes; ç) keqtrajtimit dhe braktisjes; d) mospërfilljes dhe neglizhimit; dh) shfrytëzimit dhe abuzimit; e) dhunës seksuale.*

*Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik (neni 22).*

*Mbrojtja nga përdorimi i substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope (neni 23).*

*Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual (neni 24).*

*Mbrojtja nga përfshirja në konfliktet e armatosura (neni 25).*

*Mbrojtja e fëmijës nga tortura, dënimi dhe trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues (neni 26).*

*Mbrojtja e fëmijës që i është hequr apo kufizuar liria (neni 27).*

*Ushtrimi i kujdesit prindëror (neni 28).*

*Përkujdesja alternative (neni 29).*

*Fëmija me aftësi të kufizuar (neni 30).*

*Fëmija që i përket pakicave kombëtare (neni 31).*

Ligji nr. 10347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, ka parashikuar mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës të cilët janë:

Në nivel kombëtar:

- a) Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
- b) Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- c) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Në nivel vendor:

- a) njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut;
- b) njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki/komunë.

Në zbatim të Ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" si dhe të KDF dhe të gjitha udhëzimeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare, shteti shqiptar ka hartuar Planin e Veprimit për Fëmijët 2012-2015 i cili është miratuar me VKM nr. 182, datë 13.03.2012. Plani është hartuar pas Planit Strategjik për Fëmijët për periudhën 2005-2011.

Për shkak se ky manual u drejtohet kryesisht punonjësve që punojnë me të mitur në institucionet penale por edhe në shërbimin e provës (specialistëve që merren me trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin), do të prezantojmë vetëm pjesën që ka të bëjë me drejtësinë për të mitur, e cila ndodhet në kapitullin për mbrojtjen ligjore të të miturve.

Reforma në drejtësinë për të mitur ka njohur progres gjatë viteve të fundit. Ministria e Drejtësisë është angazhuar në hartimin e një strategjie të re sektoriale për drejtësinë për të mitur e cila do të ketë për qëllim trajtimin e të gjitha problemeve ligjore që hasin fëmijët në Shqipëri. Vazhdimësia e politikave ekzistuese si edhe hartimi i politikave të reja në fushën e drejtësisë për të miturit synojnë arritjen e disa objektivave strategjikë<sup>7</sup>:

1. Mbrojtja e fëmijëve në konflikt me ligjin;
2. Sigurimi i mbrojtjes së duhur për fëmijët nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin;
3. Mbrojtja e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë të krimit.

Arritja e objektivit strategjik 1, "Mbrojtja e fëmijëve në konflikt me ligjin", kërkon realizimin e objektivave që lidhen me:

1. Rritjen e efikasitetit të procedimeve ligjore ndaj të miturve si dhe shkurtimeve të afateve kohore të tyre;
2. Rritjen e përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim dhe efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur;
3. Rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin.

Rritja e efikasitetit të procedimeve ligjore ndaj të miturve dhe shkurtimeve të afateve kohore të tyre është një proces kompleks që do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të aksesit në sistemin e

---

<sup>7</sup>VKM nr. 182, datë 13.03.2012, Për miratimin e Planit të veprimit për Fëmijët, 2012-2015

drejtësisë me anë të krijimit të seksioneve të të miturve në të gjitha gjykatat e shkallës së parë. Krijimi i gjashtë seksioneve të të miturve ka qenë një hap pozitiv në drejtim të krijimit të një trupe të specializuar për gjykimin e të miturve.

Objektivi 2, “Rritja e përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim dhe efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”, do të arrihet nëpërmjet rritjes së eficiencës së zbatimit të dënimeve alternative për të miturit në të gjithë territorin nëpërmjet forcimit të shërbimit të provës. Shërbimi i provës, që zbaton dënimet alternative, ka nevojë të zgjerojë prezencën e tij në të gjithë territorin si dhe të përmirësojë cilësinë e dhënies së shërbimit. Rritja e aplikimit të praktikave më të mira në zbatimin e dënimeve alternative për të mitur kërkon hartimin e rregulloreve e protokolleve të veçanta për zbatimin e këtyre masave. Ligji i ri për ndërmjetësimin rregullon licencimin e ndërmjetësve dhe detyron krijimin e një dhome për të miturit. Licencimi është në proces dhe krijimi i dhomës së ndërmjetësve është një masë që pritet të realizohet brenda 2012-ës.

Në objektivin 3, “Rehabilitimi i të miturve në konflikt me ligjin”, synohet përmirësimi i kuadrit ligjor për dhënien dhe ekzekutimin e vendimeve penale për të mitur. Në nenin 5 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” përcaktohet qartë që: “Ekzekutimi i vendimeve për të miturit dhe gratë bëhet në vende dhe në mënyra të veçanta e favorizuese”. Aktualisht, vepron vetëm një I EVP ndaj të miturve në Kavajë por nevojitet krijimi i institucioneve të tjera në mënyrë që të miturit të mos vuajnë më dënimin nëpër seksionet e I EVP-ve, siç është vepruar deri më sot, por në I EVP-të e specializuara për ta. Në këtë mënyrë, kushtet e dënimit do të ishin më të përballueshme për të miturit dhe rehabilitimi i tyre në shoqëri do të lehtësohej ndjeshëm.

Krijimi i institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur, vendosja e treguesve të matshëm për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve në këto I EVP si dhe sigurimi i arsimit dhe edukimit të fëmijëve në institucionet e paraburgimit dhe në burgje janë disa masa të tjera të parashikuara në planin e veprimit.

Objektivi strategjik 2, “Sigurimi i mbrojtjes së duhur për fëmijët nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin”, ka të bëjë me një shqetësim të vazhdueshëm. Përfshirja në aktivitetet kriminale e të miturve nën 14 vjeç, të cilët për shkak të moshës nuk trajtohen nga sistemi i drejtësisë, mbetet një problem. Me qëllim mbrojtjen sa më efikase të fëmijëve të kësaj kategorie si dhe arsimimin e tyre do të hartohet një projektligj “Për masat edukative për fëmijët nën 14 vjeç në konflikt me ligjin”.

Arritja e këtij rezultati kërkon: 1. Plotësimin e kuadrit ligjor për fëmijët në konflikt me ligjin nën moshën e përgjegjësisë penale (14 vjeç); 2. Ndikimin e drejtpërdrejtë në rehabilitimin e tyre në shoqëri. Plani i veprimit parashikon se hartimi i një projektligji për masat edukative për fëmijët nën 14 vjeç në konflikt me ligjin, ngritja e shërbimeve të reja që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve të nevojshme, sigurimi i përkujdesjes së duhur psikologjike për fëmijët e kësaj kategorie dhe vendosja e treguesve për matjen e rrezikut të përhapjes së aktiviteteve kriminale për fëmijët e kësaj kategorie do të mundësojnë arritjen e objektivave të mësipërm.

Objektivi strategjik 3, “Mbrojtja e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të krimit”, kushtëzohet nga objektivat: 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me mbrojtjen e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të krimit; 2. Përmirësimi i trajtimit të të miturve si viktime dhe dëshmitarë. Në planin e veprimit parashikohen masa për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale lidhur me trajtimin e të miturve si viktime dhe dëshmitarë të krimit, hartimin e protokolleve të trajtimit të të miturve si viktime dhe dëshmitarë, përshtatjen e ambienteve të policisë kur intervistohen dhe mbahen të miturit dhe trajnimin e gjykatësve, prokurorëve, policisë gjyqësore, avokatëve dhe punonjësve socialë.

Diskutim:

1. Diskutoni me kolegët hapat që ndiqen në rastin e një shkeljeje penale nga një i mitur. Cilët janë aktorët që përfshihen dhe çfarë marrëdhëniesh ka ndërmjet tyre. Cilat janë parimet themelore që duhet të gjejnë zbatim gjatë shqyrtimit të çështjes nga të gjithë aktorët.
2. Duke u mbështetur në udhëzimet e Manualit për matjen e treguesve për drejtësinë për të mitur, hartoni bashkë me grupin një statistikë mbi afatet e paraburgimit (periudha e procedimit penal deri në dhënien e vendimit të formës së prerë) dhe nxirrni një mesatare të kohëzgjatjes së procedimit penal për të miturit. Bëjeni këtë për të nxjerrë mesataren e kohëzgjatjes së periudhës së dënimit. Nxirrni përfundime mbi numrin e të miturve të dënuar për çdo 100 mijë fëmijë.
3. Nga statistikat shihet se ka një rritje të kriminalitetit tek të miturit. Diskutoni cilat janë arsyet. Sa nga të miturit e dënuar janë përsëritës. Si mendoni se është menaxhuar koha e dënimit për të miturin dhe cili ka qenë impakti që ky dënim ka sjellë?

## **MODULI 2**

### **INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE TË LIDHURA ME ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR**

#### **PËRMBAJTJA**

##### **HYRJE**

2.1 Instrumentet kryesore ndërkombëtare

2.2 Konventa për të Drejtat e Fëmijës

2.2.1 Karakteristika të përgjithshme të Konventës

2.2.2 Parimet kryesore

2.2.3 Komente mbi përmbajtjen e Konventës

2.2.4 Diskutime dhe ushtrime mbi zbatimin

#### **OBJEKTIVAT**

Në fund të këtij moduli pjesëmarrësit:

- Do të kuptojnë vlerat e drejtësisë për të mitur dhe dispozitat e Konventës për të Drejtat e Fëmijës.
- Do të kuptojnë instrumentet e tjerë ndërkombëtarë dhe rajonalë dhe dispozitat e rregullave dhe udhëzimeve ndërkombëtare që lidhen me drejtësinë për të mitur.
- Do të shkëmbejnë ide lidhur me si mund të zbatohen instrumentet në praktikë në nivel kombëtar.

**METODOLOGJIA:** *Brainstorming*, Ushtrime në grup, Prezantime në PowerPoint

**MJETET:** Manual i trajnimit, Video-Projektor, Lap top, *Flipchart*, mjete individuale



## Hyrje

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i Kombeve të Bashkuara ka rekomanduar vazhdimisht që personat e përfshirë në punën me fëmijët në sistemin e drejtësisë për të mitur, në administrimin dhe planifikimin e tij si dhe në institucionet dhe programet e tij, duhet të kenë një trajnim të mirë të fokusuar në parimet dhe kushtet e Konventës dhe në rregullat dhe udhëzimet e Kombeve të Bashkuara. Komiteti ka sugjeruar se një pjesë e madhe e edukimit dhe trajnimit të personelit të rendit publik, gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë që merren me administrimin e drejtësisë duhet të përqendrohet tek një standard i drejtësisë për të mitur të pranuar në nivel ndërkombëtar.

### 2.1 Instrumentet kryesore ndërkombëtare

Sistemi i drejtësisë për të mitur është rregulluar nga ligjet, normat dhe referencat ndërkombëtare. Instrumentet ndërkombëtare formojnë një pikë referimi të përgjithshëm ligjor për vendosjen e një sistemi efikas të drejtësisë për të mitur. Aktet ndërkombëtare që lidhen me drejtësinë për të miturit klasifikohen në instrumente të Kombeve të Bashkuara, të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian. Ndër instrumentet më të rëndësishme të Kombeve të Bashkuara, **specifike** vetëm për fëmijët, renditen:

- Konventa e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (1989) ratifikuar më 27 shkurt 1992.
- Rregullat Minimale Standard të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit 1985).
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është Hequr Liria (Rregullat e Havanës 1990).
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të rinjve. (Udhëzimet e Riadit).
- Rregullat Minimale Standard lidhur me Masat Alternative të Burgimit (Rregullat e Tokios).

Ndër instrumentet më të rëndësishme të Këshillit të Evropës do të rendisim:

Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollet nr. 1,2,4,6,5,11,7; Kartën Sociale Evropiane të rishikuar; Konventën Evropiane mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve; Konventën Evropiane për “Parandalimin e torturës dhe dënimeve e trajtimeve çnjerëzore apo degraduese” dhe protokollet nr. 1 dhe 2; Konventën Evropiane mbi të drejtat Sociale; Konventën Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht (ratifikuar me Ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000)

dhe Rekomandimet dhe rezolutat e Këshillit të Evropës për drejtësinë për të miturit:

Rezoluta (78) 62 “Mbi delikuencën e të miturve dhe ndryshimet sociale”; Rekomandimi (85) 7 “Mbi pjesëmarrjen e publikut në politikën penale”; Rekomandimi (85) 4 “Për dhunën në familje”; Rekomandimi (87) 19 “Mbi parandalimin e krimit të organizuar”; Rekomandimi (87) 20 “Mbi reagimin social ndaj delikuencës së të miturve”; Rekomandimi (87) 21 “Për asistencën ndaj viktimave të krimit dhe parandalimin e viktimizimit”; Rekomandimi (91) 11 “Mbi shfrytëzimin seksual, pornografinë, prostitucionin dhe trafikimin e të rinjve dhe të fëmijëve”; Rekomandimi i Këshillit të Evropës “Për ndërhyrjen e hershme psikosociale në parandalimin e kriminalitetit”; Rekomandimi (2006) 2 “Rregullat Evropiane të Burgjeve”; Rekomandimi (2008) 11 “Rregullat mbi shkelësit e mitur subjekt të sanksioneve dhe masave.

Më poshtë do të japim në vija të përgjithshme dhe shkurtimisht përmbajtjen e instrumenteve kryesore specifike që lidhen me drejtësinë për të mitur.

➤ **Rregullat Minimale të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit: "Rregullat e Pekinit" (1985)**

Rregullat e Pekinit ofrojnë udhëzime për shtetet mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, respektimin e nevojave të tyre dhe zhvillimin e sistemeve të veçanta dhe të specializuara të drejtësisë për të mitur. Këto rregulla formuan instrumentin e parë ligjor ndërkombëtar i cili rregullon tërësisht administrimin e drejtësisë për të mitur në kuadër të të drejtave të fëmijëve.

Standardet minimale synojnë krijimin e një sistemi të specializuar të drejtësisë për të miturit dhe krijimin e një legjislacioni të posaçëm. Këtu nënvizojmë:

- Përjashtimin e të miturit nga dënimi kapital dhe nga ndëshkimet trupore
- Trajtimin e paanshëm dhe njerëzor
- Mbajtjen parasysh të mendimeve të të miturit
- Të konsideruarit e burgimit si mundësia e fundit dhe një qëndrim në burg sa më të shkurtër që të jetë e mundur
- Aplikimin e heqjes së lirisë vetëm në raste shumë të rënda
- Dhënien e vendimeve sa më shpejt që të jetë e mundur
- Specializimin e organeve të drejtësisë
- Riintegrimin e të miturit

➤ **Rregullat e OKB-së për Mbrojtjen e të Miturve të privuar nga liria e tyre: "Rregullat e Havanës ose JDL-të" (1990)**

Rregullat e Havanës përcaktojnë standardet e aplikueshme kur një fëmijë është i kufizuar në ndonjë institucion apo strukturë, nëse kjo është penale, korrektuese, arsimore ose mbrojtëse. Parimet më të rëndësishme që nënvizohen në Rregullat e Havanës janë:

Heqja e lirisë është masë e fundit dhe kjo duhet të ketë kohëzgjatje të kufizuar.

Heqja e lirisë për të miturit nuk mund të bëhet pa një motiv juridik objektiv.

Krijimi i institucioneve të hapura duhet të jetë një prioritet.

Përgatitja e të miturve të cilëve u është hequr liria për rikthimin e lirisë dhe rikthimin në komunitet.

Rëndësia e programeve edukuese për ta.

Mbajtja e kontakteve me familjen.

Trajnimi i personelit të institucioneve ose të qendrave rezidenciale për fëmijët.

➤ **Udhëzimet e OKB-së për Parandalimin e delikucencës së të miturve: "Udhëzimet e Riadit" (1990)**

Udhëzimet e Riadit përfaqësojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe aktive në parandalimin dhe riintegrimin social të detajuar nëpërmjet strategjive sociale dhe ekonomike që përfshijnë shoqërinë

në përgjithësi. Parandalimi nuk shihet thjesht si trajtimi i situatave negative por si një mjet për të promovuar mirëqenien e përgjithshme pozitive sociale. Parandalimi i kriminalitetit të të miturve është pjesë esenciale e parandalimit të krimit në shoqëri. Të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jo kriminale nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme e të dobishme për shoqërinë dhe nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi humanist ndaj shoqërisë dhe këndvështrimit mbi jetën.

Parandalimi i suksesshëm i kriminalitetit të të miturve kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria për të siguruar një zhvillim harmonik të adoleshentëve duke respektuar dhe mbrojtur personalitetin e tyre që në fëmijërinë e hershme.

Për interpretimin e këtyre Udhëzimeve duhet të orientohemi nga vendosja e fëmijës në qendër. Të rinjtë duhet të kenë një rol aktiv dhe partneriteti brenda shoqërisë dhe nuk duhen trajtuar thjesht si objekte shfrytëzimi dhe kontrolli.

Në zbatimin e këtyre Udhëzimeve, në përputhje me sistemin ligjor kombëtar, mirëqenia e të rinjve, duke filluar që nga fëmijëria e hershme, duhet të jetë fokusi i të gjitha programeve parandaluese.

Duhet të njihet dhe të vlerësohet nevoja dhe rëndësia e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit dhe e studimit sistematik e përpunimit të masave të nevojshme. Këto duhet të shmangin inkriminimin dhe penalizimin e fëmijës për sjellje që nuk i shkaktojnë dëme të rëndësishme zhvillimit të tij apo që nuk dëmtojnë të tjerët.

➤ **Rregullat minimale standard të Kombeve të Bashkuara për masat e dënimeve alternative (jo me burgim): “Rregullat e Tokios” (1990)**

Rregullat Minimale Standard sigurojnë një sërë parimesh themelore për të promovuar përdorimin e masave alternative të dënimit si dhe garancitë minimale për personat që i nënshtrohen alternativave të dënimit me burgim. Rregullat janë të destinuara për të promovuar përfshirjen më të madhe të komunitetit në menaxhimin e drejtësisë penale, veçanërisht në trajtimin e kryerësve, si dhe për të promovuar ndër shkelësit ndjenjën e përgjegjësisë ndaj shoqërisë.

Rregullat duhet të zbatohen duke marrë parasysh kushtet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të çdo vendi dhe qëllimet dhe objektivat e sistemit të drejtësisë penale të tij.

Në zbatimin e rregullave, Shtetet Anëtare duhet të përpiqen të sigurojnë balancën e duhur mes të drejtave individuale të autorëve, të drejtave të viktimave dhe shqetësimit të shoqërisë për sigurinë publike dhe parandalimin e krimit.

Shtetet anëtare do të zhvillojnë masa alternative brenda sistemeve të tyre ligjore për të ofruar opsione të tjera duke reduktuar përdorimin e burgimit dhe për të racionalizuar politikat e drejtësisë penale duke marrë parasysh respektimin e të drejtave të njeriut, kërkesat e drejtësisë sociale dhe nevojat e rehabilitimit të kryerësit të veprës penale.

Dispozitat përkatëse të kësaj Rregulloreje do të zbatohen për të gjithë personat që i nënshtrohen gjyqimit, prokurorisë apo ekzekutimit të dënimit, në të gjitha fazat e administrimit të drejtësisë penale. Në këto Rregulla këta persona janë quajtur në mënyrë konvencionale "shkelës", pavarësisht nëse janë të dyshuar, të akuzuar apo të dënuar.

Rregullat do të aplikohen pa asnjë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër.

Në mënyrë që të sigurojë fleksibilitet më të madh, në përputhje me natyrën dhe seriozitetin e veprës, me personalitetin dhe përkatësinë veprës dhe me mbrojtjen e shoqërisë, si dhe për të shmangur përdorimin e panevojshëm të burgimit, sistemi i drejtësisë penale duhet të ofrojë një gamë të gjerë masash alternative.

Hartimi i masave alternative duhet të inkurajohet dhe monitorohet nga afër dhe përdorimi i tyre duhet të vlerësohet në mënyrë sistematike.

Duhet të merret në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme shmangia nga procedurat formale apo gjykimi nga një gjykatë, në përputhje me garancitë ligjore.

Masat alternative duhet të përdoren në përputhje me parimin e ndërhyrjes minimale.

- **Rekomandimi CM/Rec 2008 (11)** i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi Rregullat Evropiane, **për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave.**

Qëllimi i rekomandimit është të rrisë unitetin midis shteteve anëtare duke harmonizuar ligjet mbi çështje të përbashkëta për një bashkëveprim në nivel evropian për të mbrojtur më mirë të drejtat dhe mirëqenien e të miturve që hyjnë në konflikt me ligjin si dhe për të zhvilluar sistemet e drejtësisë për të mitur në interes të të miturve.

Shkelësit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave do të trajtohen duke respektuar të drejtat e tyre njerëzore.

Sanksionet dhe masat që do të imponohen mbi të miturit si dhe mënyra e implementimit duhet të jenë të specifikuar në ligj dhe të bazohen në parimet e integritit social, arsimimit dhe parandalimit të shkeljeve.

Sanksionet dhe masat do të caktohen nga gjykata ose një autoritet tjetër i ligjshëm dhe do t'i nënshtrohen një gjykimi të shpejtë si dhe do të imponohen për periudha minimale dhe vetëm për qëllime legjitime.

Vendosja dhe zbatimi i sanksioneve ose masave do të bazohet në interesin më të lartë të fëmijëve, duke marrë parasysh veprën e kryer (*proporcionaliteti*) si dhe moshën e tyre, mirëqenien fizike dhe mendore, zhvillimin, kapacitetet dhe rrethanat personale (*parimi i individualizmit*), mbështetur në raporte psikologjike, psikiatrike dhe sociale.

Sanksionet dhe masat nuk do të jenë të tilla që të fyejnë ose të degradojnë të miturin subjekt të tyre.

Sanksionet ose masat nuk do të zbatohen në mënyrë që të përkeqësojnë karakterin apo të vënë në rrezik shëndetin mendor e fizik të fëmijës.

Sanksionet ose masat do të zbatohen pa vonesë dhe deri në masën dhe periudhën e nevojshme (*parimi i ndërhyrjes minimale*).

Privimi nga liria i të miturit do të jetë një masë e shkallës së fundit dhe do të imponohet dhe zbatohet për një periudhë sa më të shkurtër që të jetë e mundur. Përpjekje të mëdha duhen bërë për të shmangur paraburgimin.

Sanksionet ose masat do të caktohen dhe zbatohen pa diskriminim të asnjë lloji për arsye gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, orientimi seksual, mendimi politik apo ndonjë statusi tjetër (*parimi i mosdiskriminimit*).

Ndërmjetësimi apo masat e tjera duhen inkurajuar në të gjitha fazat e procesit që kanë të bëjnë me të miturin si shkelës i ligjit.

Çdo sistem drejtësie që ka të bëjë me të miturit duhet të sigurojë pjesëmarrjen e tyre efektive për sa i përket imponimit të masave ose sanksioneve. Të vegjlit nuk do të kenë më pak të drejta se të rriturit për mbrojtje ligjore, sipas Kodit të Procedurës Penale.

Çdo sistem drejtësie që ka të bëjë me të miturit duhet të marrë parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve ose kujdestarëve ligjorë dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'i përfshijë ata në procedurën e ekzekutimit të masave ose sanksioneve, përveç kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

Çdo sistem drejtësie për të miturit duhet të ndjekë një qasje shumëdisiplinore dhe të integrohet me iniciativat e shumta për vazhdimësinë e kujdesit për të miturit (*Parimi i përfshirjes së komunitetit dhe i kujdesit të vazhdueshëm*).

E drejta e intimitetit do të respektohet plotësisht në të gjitha fazat e procedurës. Identiteti i të miturit dhe informacionet për të nuk do të publikohen.

## **2.2 Konventa për të Drejtat e Fëmijës**

### **2.2.1 Karakteristika të përgjithshme të Konventës**

Administrimi i drejtësisë për të miturit është subjekt i standardeve të detajuara ndërkombëtare. Këto standarde mbulojnë një numër të gjerë dhe kompleks çështjesh si parandalimi nëpërmjet ndërhyrjes së hershme, procesi gjyqësor, kushtet e burgosjes dhe riintegrimi social, duke përfshirë gjithashtu një numër të gjerë aktorësh.

Instrumenti parësor që udhëheq zhvillimin e drejtësisë për të miturit është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Në vitin 1989, në 20 Nëntor, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së unanimisht vendosi adoptimin e konventës “Për të drejtat e fëmijës”. Më 2 Shtator të vitit 1990 Konventa hyri në fuqi si ligj ndërkombëtar. Konventa u miratua nga Shqipëria në Shkurt të vitit 1992.

Për zbatimin e Konventës është ngritur edhe Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve të cilit të gjitha shtetet nënshkruese duhet t'i paraqesin një raport të specifikuar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në vendet nënshkruese, implementimin e konventës në legjislacionet e brendshme etj.

Aktualisht, KDF është një nga dokumentet kryesore të të Drejtave të Fëmijës në mbarë botën.

Konventën e dallojnë disa karakteristika:

- së pari është instrument universal,
- së dyti është instrument ligjërish i zbatueshëm,
- së treti mbron rolin e familjes në jetën e fëmijëve,
- së katërti ngarkon përgjegjësi të qarta për të gjitha palët,
- së pesti krijon një vizion për fëmijën

Ky instrument shihet si kuadri përfshirës për një qasje për të drejtat e fëmijës. Ai përmban një paketë të përpunuar udhëzimesh për ruajtjen e standardeve të të drejtave të njeriut në sistemet e drejtësisë për të miturit dhe për administrimin e vetë drejtësisë për të miturit.

Shtetet janë të detyruara të vënë në funksionim dispozitat e Konventës nëpërmjet ligjeve, politikave dhe praktikave të hartuara, për të realizuar qëllimet e saj. Zbatimi i Konventës mbikëqyret nga Komiteti i të Drejtave të Fëmijës, një organ prej 18 ekspertësh ndërkombëtarë, të përzgjedhur në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë një shumëllojshmëri komunitetesh gjeografike, gjuhësore dhe fetare.

Çështjet që lidhen me drejtësinë për të mitur përfshihen në nenet 37, 39 dhe 40 të KDF por këto nuk mund të merren të shprehura nga gjithë konteksti i konventës, pasi të gjitha dispozitat e saj janë të varura njëra nga tjetra dhe formojnë një të tërë. Neni 40 duhet parë i lidhur me parimet e përgjithshme të parashtruara lidhur me fëmijët, përkatësisht me nenin 2 të KDF ku nënvizohet parimi i barazisë dhe **mosdiskriminimit**, nenin 3(1) **mbi interesin më të lartë të fëmijës si konsiderata më e lartë**; nenin 6 mbi **të drejtën e jetës** dhe nenin 12 mbi **respektimin e të drejtës për të shprehur lirisht pikëpamjet**, dhe duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë.

Të lidhur ngushtë me zbatimin e nenit 40 të KDF janë neni 16, e drejta e privatësisë; neni 19, mbrojtja nga çdo lloj dhune; neni 20, përkujdesi alternativ; neni 25, rishikimi periodik i trajtimit dhe neni 39, përkujdesja për rehabilitimin e viktimave. Sa më sipër dhe të tjera japin formatin e disa standardeve kryesore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Neni 37 i KDF ka në përmbajtjen e vet ndalimin e torturës dhe të trajtimit mizor, degradues e çnjerëzor. Arrestimi, ndalimi ose burgimi duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe të përdoren si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore, duhet të jetë i veçuar nga të rriturit dhe duhet të jetë gjithnjë në kontakt me familjen e tij. Fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për asistencë juridike dhe të drejtë për të kundërshtuar privimin e lirisë si dhe të drejtën për marrjen e një vendimi sa më të shpejtë në lidhje me çështjen.

### 2.2.2 Parimet kryesore

Për të siguruar një qasje të përbashkët në përmbajtjen e fushave të trajtuara nga Konventa, Komiteti i të Drejtave të Fëmijës ka identifikuar katër parime të përgjithshme që janë një referencë udhëzuese për interpretimin e Konventës. Ato janë:

## **Interesi më i lartë**

Konventa e OKB-së është bazuar në parimin e “interesave më të larta të fëmijës” si një konsideratë parësore në të gjithë çështjet që lidhen me fëmijët. Ky parim udhëheq zbatimin e të gjithë parimeve të tjera të Konventës, përfshirë ato që lidhen me drejtësinë për të miturit. Zbatimi i tij nuk kufizohet vetëm te vendimet e marra nga gjykatat: interesat më të larta të fëmijës duhet të zbatohen gjerësisht në vendimet administrative, në formulimin e politikave dhe në masat e diversionit.

Neni 3 Interesi më i lartë i fëmijës (KDF)

*1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*

*2. Shtetet Palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ata marrin të gjitha masat legislative dhe administrative përkatëse.*

*3. Shtetet Palë marrin masa që institucionet, shërbimet dhe qendrat që përgjigjen për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe aftësive të personelit të tyre si dhe të kontrollit të duhur.*

Konventa për të Drejtat e Fëmijës garanton shumë të drejta për fëmijët të cilat garantojnë gjithashtu në një sërë aktesh të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës është sanksionuar vetëm në KDF. Për këtë mund të lindë pyetja: perse për fëmijën, përveç të drejtave të përcaktuara, kemi edhe një parim që i mbivendoset të drejtave? Kjo është bërë sepse fëmija është një subjekt të cilit shteti duhet t'i garantojë mbrojtje të posaçme për shkak të moshës së mitur; gjithashtu, ky është një mekanizëm me të cilin shoqëria do të balancojë veprimtarinë e institucioneve vendimmarrëse shtetërore dhe private në favor të fëmijëve, duke u orientuar nga parimi i marrjes në konsideratë të interesit më të lartë të fëmijës. Konventa parashikon mjaft raste në të cilat parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë konsideratë kryesore. Ndër to mund të përmendim ndarjen nga prindërit, përgjegjësinë prindërore, largimin nga ambienti familjar, adoptimin, kufizimin e lirisë dhe seancat gjyqësore. Në të gjitha këto raste dhe në të tjera parimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë filtri kryesor i një vendimi të drejtë. Për sa i përket marrjes në konsideratë të parimit të interesit më të lartë të fëmijës në kushtet e vuajtjes së dënimit në institucione penale apo në shërbimin e provës, rastet në të cilat duhet të fokusohemi tek ky parim janë: vendimi administrativ ndaj një fëmije, akomodimi i tij, implementimi i një programi trajnues, arsimor apo argëtues, vizita shëndetësore, procedura disiplinore, procedura të ankesave dhe kërkesave etj.

## **Mosdiskriminimi**

Sipas këtij parimi, fëmijët nuk duhet të diskriminohen mbi bazën e gjinisë, origjinës etnike ose sociale, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër, përfshirë statusin e prindërve të tyre, dhe një sërë arsyesh të tjera.

## Neni 2 Mosdiskriminimi

- 1. Shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre pa asnjë dallim, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinion politik ose çdo lloj opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve të tij ose e përfaqësuesve të tij ligjorë.*
- 2. Shtetet palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, prindërve të tij, përfaqësuesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij.*

Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim apo preferencë e cila bazohet në elemente të tilla si ngjyra, gjinia, gjuha, besimi fetar, opinionet politike apo të çdo lloji tjetër, origjina kombëtare, origjina sociale, prona, lindja ose ndonjë status tjetër që ka si qëllim apo efekt anulimin apo kufizimin e njohjes, gëzimit ose ushtrimit nga të gjithë personat në mënyrë të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut.

Elementët e diskriminimit që rendit neni 2 i Konventës janë të njëjtë me ato të renditura në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Konventa i jep një hapësirë të gjerë mosdiskriminimit duke përdorur termin “*çdo status tjetër*”. Neni 2 thekson të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur nga diskriminimi për shkak të statusit të prindërve ose kujdestarëve të tij (Kujdesi që duhet të bëjmë për parandalimin e diskriminimit të fëmijëve të shtetasve që ndodhen të burgosur).

Koncepti i veprimit pohues/diskriminimit pozitiv apo trajtimi i disa njerëzve ndryshe nga të tjerët me qëllimin për t'u siguruar atyre mbështetje të veçantë për të korrigjuar diskriminime të mëparshme apo aktuale është pranuar nga Konventa. Kërkohen masa për mbështetjen e grupeve të veçanta si romët, egjiptianët, fëmijët me aftësi të kufizuara etj. Në vendin tonë është hartuar një ligj i posaçëm për parandalimin e diskriminimit dhe është krijuar komisioneri për parandalimin e diskriminimit. Këta janë hapa shumë pozitivë por të vetëm, pa u shoqëruar nga masa konkrete praktike të të gjitha institucioneve të shtetit dhe shoqërisë civile, nuk mjaftojnë.

Parimi i mosdiskriminimit gjen pasqyrim të plotë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 18; në Strategjitë kombëtare lidhur me fëmijët (strategjitë për luftën kundër trafikut të fëmijëve, për fëmijët me aftësi të kufizuara, për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom dhe në Strategjinë Kombëtare për fëmijët 2005-2010) si dhe në akte të tjera ligjore, në Kodin e Punës, Kodin Civil, Kodin Penal etj.

## **Pjesëmarrja e fëmijës**

E drejta e fëmijëve për të marrë pjesë në çështjet që prekin interesat e tyre konsiderohet si një mënyrë novatore e njohjes së faktit që fëmijët janë bartës individualë të të drejtave të njeriut dhe jo thjesht objekte të kujdesit ose marrës të mbrojtjes sociale. Dispozita përkatëse (neni 12) ka lidhje të dukshme me drejtësinë për të miturit në atë që, për sa i përket procedurave gjyqësore, fëmijët duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në të gjitha vendimet dhe, në kohën e gjyqit, duhet të kenë përfaqësim ligjor kompetent.

## Neni 12 Respektimi i mendimit të fëmijës

- 1. Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.*



2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.

Me qëllim që të përcaktohet se cili është interesi më i lartë i fëmijës është e nevojshme që fëmija të dëgjohet dhe pikëpamjet e tij të merren në konsideratë. Respektimi i pikëpamjeve të fëmijës është një nga parimet thelbësore të Konventës interpretimi dhe zbatimi i të cilit është i lidhur me zbatimin e të gjitha parimeve dhe të drejtave të tjera në konventë.

## **E drejta për mbijetesë dhe zhvillim**

Ky parim ka të bëjë me mirëqenien e një fëmije, përfshirë të drejtat e tij/saj për shëndet, mbrojtje sociale dhe shërbime sociale, argëtim dhe çlodhje, mbrojtje nga dhuna dhe dëmi. Është një parim me zbatim të gjerë në sferën e drejtësisë për të mitur, veçanërisht kur flitet për fëmijë të cilëve u është hequr liria meqenëse ata janë të prekshëm nga kërcënimet për mirëqenien e tyre fizike dhe psikologjike.

*Neni 6 – E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit*

1. Shtetet Palë njohin se çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.

2. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

Paragrafi i parë i nenit 6 është i rëndësishëm pasi garanton të drejtën për të jetuar për të gjithë fëmijët. Paragrafi i dytë i këtij neni shkon më tej duke detyruar shtetet palë që të sigurojnë “në maksimumin e mundshëm mbijetesën e fëmijëve dhe zhvillimin e tyre”. E drejta e zhvillimit ka një kuptim më të gjerë nga ajo çfarë duket se garanton neni 6. Liria politike, garantimi i të drejtave njerëzore, zgjedhjet sociale, respektimi personal për veten dhe përmirësimi i mundësive njerëzore, sociale dhe ekonomike konsiderohen si mjete shumë të rëndësishme dhe objektiva të zhvillimit.

### **2.2.3 Komente mbi përmbajtjen e Konventës (KDF)**

- *Përkufizimi i fëmijës*

Fëmijë është një person nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur në bazë të legjislacionit kombëtar moshë madhore arrihet më shpejt.

- *Mosdiskriminimi*

Të gjitha të drejtat i gëzojnë të gjithë fëmijët pa përjashtim. Shteti ka për detyrë t'i mbrojë fëmijët nga çdo formë diskriminimi dhe të ndërmarrë veprime pozitive për përkrahjen e këtyre të drejtave.

- *Interesi më i lartë i fëmijës*

Çdo vendim lidhur me fëmijën duhet të mbajë plotësisht parasysh interesat e tij më të larta. Shteti i siguron fëmijës gjithë kujdesin e duhur kur prindërit ose personat e ngarkuar me këtë përgjegjësi nuk e bëjnë këtë.

- *Zbatimi i të drejtave*

Shteti duhet të bëjë gjithçka për zbatimin e të drejtave që përmban kjo Konventë.

- *Udhëheqja prindërore dhe zhvillimi i aftësive të fëmijëve.*

Shteti duhet të respektojë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve dhe të familjes së zgjedhur për të drejtuar dhe udhëhequr fëmijën në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij.

- *Mbijetesa dhe zhvillimi*

Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar dhe shteti është i detyruar të sigurojë mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës.

- *Emri dhe shtetësia*

Fëmija ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

- *Ndarja nga prindërit*

Fëmija ka të drejtë të jetojë me prindërit e tij, përveç rastit kur ndarja prej tyre është e domosdoshme bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Fëmija ka gjithashtu të drejtë të mbajë lidhje me të dy prindërit kur është ndarë nga njëri ose dy prej tyre.

- *Ribashkimi i familjes*

Fëmijët dhe prindërit e tyre kanë të drejtë të largohen nga çdo vend dhe të rikthehen në vendin e tyre me qëllim ribashkimit ose mbajtjen e lidhjeve fëmijë-prind.

- *Zhvendosja dhe moskthimi i paligjshëm*

Shteti duhet të parandalojë dhe të luftojë rrëmbimin dhe mbajtjen e fëmijëve jashtë vendit nga njëri prej prindërve ose nga një palë e tretë.

- *Mundësitë e fëmijës*

Fëmija ka të drejtë të shprehë mendimin e tij lirisht dhe ky mendim duhet t'i dëgjohet në çdo çështje ose procedurë që ka të bëjë me të.

- *Liria e shprehjes*

Fëmija ka të drejtë të shprehë pikëpamjet e tij, të marrë informacion, t'i bëjë të njohura mendimet apo informacionin, pavarësisht nga kufijtë.

- *Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.*

Shteti respekton të drejtën e fëmijës për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe fesë, me kusht që të ketë udhëheqjen e duhur prindërore.

- *Liria e grumbullimit*

Fëmijët kanë të drejtë të takohen me të tjerë dhe të hyjnë në organizata apo të krijojnë organizata.

- *Mbrojtja e jetës private*

Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen kundër ndërhyrjes në jetën e tyre private, në familje, në shtëpi apo në korrespondencën e tyre, kundër cenimeve të nderit dhe shpifjeve.

- *Mundësitë për të pasur informacionin e nevojshëm*

Shteti garanton që fëmija të marrë informacione dhe material që vijnë nga burime të ndryshme dhe inkurajon mjetet e komunikimit masiv për të përhapur një informacion me dobi shoqërore dhe kulturore për fëmijën si dhe merr masa për ta mbrojtur atë nga materialet e dëmshme.

- *Mbrojtja nga keqtrajtimi dhe mospërfillja*

Shteti mbron fëmijën nga çdo formë keqtrajtimi nga ana e prindërve ose atyre që kujdesen për fëmijën dhe ndërton programet e nevojshme shoqërore për parandalimin e keqtrajtimit dhe kujdesin për viktimat.

- *Mbrojtja e fëmijës në familje*

Shteti është i detyruar të sigurojë një mbrojtje të veçantë për fëmijën të cilit i mungon mjedisi familjar si dhe të sigurojë në raste të tilla një kujdesje familjare alternative ose vendosjen në institucione. Në përpjekjet për plotësimin e këtij detyrimi duhet t'i kushtohet vëmendja e duhur formimit kulturor të fëmijës.

- *Birësimi*

Në vendet ku pranohet dhe /ose lejohet birësimi, ai do të bëhet vetëm duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe vetëm me autorizimin e autoriteteve kompetente, duke pasur garanci për fëmijën.

- *Fëmijët refugjatë*

Fëmijës refugjat ose fëmijës që kërkon status refugjati i sigurohet mbrojtje e veçantë. Shteti ka për detyrë të bashkëpunojë me organizatat kompetente që sigurojnë një mbrojtje dhe ndihmë të tillë.

- *Fëmijët me aftësi të kufizuara*

Një fëmijë me aftësi të kufizuara ka të drejtën për një kujdes të posaçëm, për arsimim dhe për kualifikim, në mënyrë që të gëzojë plotësisht një jetë me dinjitet dhe të arrijë një zhvillim dhe integrim shoqëror sa më të plotë.

- *Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore*

Fëmija ka të drejtë të gëzojë një gjendje shëndetësore dhe të ketë një kujdes shëndetësor sa më të mirë. Shtetet duhet t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë dispozitave të kujdesit shëndetësor parësor dhe parandalues, të edukimit të shëndetit publik dhe të uljes së vdekshmërisë foshnjore. Ato nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë drejtim dhe përipiqen që asnjë fëmije të mos i mohohet mundësia për shërbime shëndetësore të efektshme.

- *Shqyrtimi periodik i vendosjes nën kujdesje*

Fëmija që është vendosur nga shteti nën kujdesje, mbrojtje ose trajtim ka të drejtën që kësaj vendosjeje t'i bëhet një ekzaminim periodik.

- *Përkrahja shoqërore*

Fëmija ka të drejtë të përfitojë përkrahje shoqërore, përfshirë sigurimet shoqërore.

- *Niveli i jetesës*

Çdo fëmijë ka të drejtën për një nivel jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor e shpirtëror. Përgjegjësinë për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës e kanë në radhë të parë prindërit. Detyra e shtetit është të sigurojë që kjo përgjegjësi të realizohet. Në përgjegjësinë e shtetit mund të përfshihet ndihma materiale për prindërit dhe fëmijët e tyre.

- *Arsimimi*

Fëmija ka të drejtë të arsimohet dhe është detyra e shtetit të sigurojë arsimin fillor falas dhe të detyrueshëm dhe të inkurajojë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm të mundshme për çdo fëmijë në bazë të aftësive. Disiplina shkollore duhet të jetë në përputhje me të drejtat dhe dinjitetin e fëmijës. Shteti angazhohet në bashkëpunimin ndërkombëtar për realizimin e kësaj të drejte.

- *Qëllimi i arsimit*

Arsimi duhet të synojë të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës. Arsimi duhet ta përgatisë fëmijën për një jetë aktive si i rritur, në një shoqëri të lirë, dhe të ushqejë respektin për prindërit e fëmijës, për identitetin e tij kulturor, gjuhën dhe vlerat, për formimin kulturor dhe vlerat e të tjerëve.

- *Fëmijët e pakicave etnike dhe popullsive autoktone*

Fëmijët që u përkasin minoriteteve dhe popullsive autoktone kanë të drejtën të gëzojnë kulturën e vet, të praktikojnë fenë e vet dhe të përdorin gjuhën e vet.

- *Koha e lirë, argëtimi dhe veprimtaritë kulturore*

Fëmija ka të drejtën për të pasur kohë të lirë, për të luajtur dhe për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe artistike.

- *Puna e fëmijës*

Fëmija ka të drejtën për t'u mbrojtur nga puna që paraqet rreziqe për shëndetin, edukimin apo zhvillimin e tij. Shteti përcakton moshën minimale për t'u pranuar në punë dhe rregullon kushtet e punës.

- *Përdorimi i drogës*

Fëmijët kanë të drejtën për t'u mbrojtur nga përdorimi i drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope dhe për të mos u përdorur për prodhimin e tyre.

- *Shfrytëzimi seksual*

Shteti mbron fëmijën nga shfrytëzimi dhe keqtrajtimi seksual, përfshirë prostitucionin dhe pornografinë. Shteti ka për detyrë të marrë të gjitha masat për të mos lejuar shitjen, trafikimin dhe rrëmbimin e fëmijëve.

- *Format e tjera të shfrytëzimit*

Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga çdo formë shfrytëzimi që dëmton, në çfarëdo aspekti, mirëqenien e tyre dhe nuk përmendet në nenet 32, 33, 34 dhe 35.

- *Tortura dhe mohimi i lirisë*

Asnjë fëmijë nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, arrestimit apo heqjes së paligjshme të lirisë. As dënimi me vdekje as burgimi i përjetshëm nuk duhet të jepen për shkelje të ligjit të kryera nga persona nën 18 vjeç. Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të veçohet nga të rriturit, me përjashtim të rastit kur mendohet se është në interesin më të lartë të fëmijës që kjo të shmanget. Një fëmijë i ndaluar duhet të ketë ndihmë juridike apo ndihmë tjetër si dhe të mbajë lidhje me familjen e tij.

- *Konfliktet e armatosura*

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat të cilët nuk kanë mbushur moshën 15 vjeç të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në veprime luftarake. Asnjë fëmijë që nuk ka mbushur moshën 15 vjeç nuk rekrutohet në forcat e tyre të armatosura. Shtetet palë sigurojnë gjithashtu mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur, sikundër parashikohet në të drejtën ndërkombëtare përkatëse.

- *Kujdesi për riaftësim*

Shteti ka për detyrë të sigurojë që viktimat e konflikteve të armatosura, torturës, mospërfilljes, keqtrajtimit apo shfrytëzimit të kenë trajtimin e duhur për riaftësimin dhe integrimin e tyre shoqëror.

- *Administrimi i drejtësisë për të mitur*

Një fëmijë që është në konflikt me ligjin ka të drejtën e një trajtimi të tillë që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që merr parasysh moshën e fëmijës dhe që synon riintegrimin e tij në shoqëri. Fëmija ka të drejtën që t'i jepen garancitë bazë dhe të ketë ndihmën juridike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij. Kur është e mundur, duhet të shmangen seancat gjyqësore dhe vendosja në institucione.

- *Respektimi i standardeve më të larta*

Kur normat e vendosura në legjislacionin e zbatueshëm kombëtar apo ndërkombëtar, që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës, janë më të favorshme se normat e kësaj Konvente, zbatohen normat që janë më të favorshme.

#### 2.2.4 Diskutime dhe ushtrime mbi zbatimin

1. Në tabelën e mëposhtme janë shënuar në krahun e majtë disa nga parimet dhe të drejtat që duhen marrë parasysh në ndërhyrjet gjatë punës me fëmijët. Në anën e djathtë të tabelës janë shënuar nenet e KDF dhe shpjegimet, por ato janë vendosur në mënyrë jo relevante. Lidhni me shigjetë parimet me shpjegimet e tyre përkatëse.

Parimi	Shpjegimi i mbështetur në KDF
○ Mosdiskriminimi	○ Në të gjitha çështjet e lidhura me fëmijën, interesi më i lartë i tij duhet të jetë konsiderata më e lartë (Neni 3).
○ Heqja e lirisë si masë e fundit	○ Të gjithë fëmijët duhet të kenë akses të barabartë në shërbime pavarësisht nga raca, gjinia, gjuha ose ndonjë status tjetër (Neni 2).
○ Diversioni	○ Fëmijët duhet të thonë mendimin e tyre në të gjitha çështjet që i prekin ata (Neni 12).
○ Interesi më i lartë	○ Duhet bërë përpjekje për shmangien e fëmijëve nga sistemi formal të drejtësisë aty ku është e mundur (Neni 40).
○ Pjesëmarrja e fëmijës	○ Zgjidhjet alternative duhen kërkuar përpara arrestimit apo burgosjes së fëmijës (Neni 37).
○ Riintegrimi	○ Duhet bërë përpjekje për të riintegruar fëmijët në komunitet... (Neni 40)

2. Ditët e fundit shtypi ka botuar në mënyrë të vazhdueshme artikuj për një vajzë e cila ka kryer një krim, duke publikuar të dhëna mbi gjendjen e saj shëndetësore në lidhje me shtatzëninë, plagë dhe dëmtime në organet gjenitale etj. Vajza është diku mbi 18 vjeç. Si i vlerësoni, të drejtë apo të gabuar, publikimet rreth gjendjes shëndetësore të vajzës?

## **MODULI 3**

### **STANDARDET E KUJDESIT NË KUSHTET E BURGIMIT, PASKUJDESJA DHE INTEGRIMI SHOQËROR I FËMIJËVE QË KRYEJNË KRIME**

#### **PËRMBAJTJA**

##### **HYRJE**

- 3.1 Parimet bazë të burgimit dhe mbikëqyrjes
- 3.2 Menaxhimi i institucioneve për të mitur
- 3.3 Ushtrime

#### **OBJEKTIVAT**

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit do të:

- do të njohin standardet ndërkombëtare që lidhen me burgimin e fëmijëve;
- do të jenë në gjendje të identifikojnë veprimet që duhet të ndërmarrin për të përmirësuar situatën e të drejtave të fëmijëve të burgosur;
- do të dinë të vendosin fëmijët e burgosur në situata të drejta;
- do të kenë mësuar rreth programeve të paskujdesit dhe riintegritit shoqëror.

**METODOLOGJIA:** *Brainstorming*, Ushtrime në grup, Prezantime në PowerPoint

**MJETET:** Manual i trajnimit, Video-Projektor, Lap top, *Flipchart*, mjete individuale

## Hyrje

Numri i fëmijëve të burgosur, duke përfshirë këtu si arrestin ashtu edhe dënimin me burgim, zë një përqindje të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të të burgosurve. Po t'u referohemi shifrave të vitit 2010, rezulton se mesatarisht 0.8% të të gjithë të burgosurve në Evropë e përbëjnë fëmijët, me një diferencë midis vendeve të ndryshme nga 0-7.1%. Në vendin tonë, gjatë këtij viti, numri i të miturve të burgosur arrin në 2.5% të numrit total të të burgosurve ose në 119 të mitur, prej të cilëve rreth 15 kanë qenë të dënuar dhe pjesa tjetër nën arrest. Me gjithë prirjen e përgjithshme të sistemit të drejtësisë për të mitur për të aplikuar vetëm në raste tepër të rralla masën e arrestimit apo të dënimit me burg për të miturit, është e pamundur që të shmangen disa shkelje të rënda dhe recidiviste nga dënimi me burgim. Instrumentet ndërkombëtare dhe ligjet e aktet nënligjore vendore parashikojnë për të miturit shërbime dhe mbrojtje të veçantë nga të rriturit si dhe obligime më të mëdha të stafit që punon me të mitur.

### 3.1 Parimet bazë të burgimit dhe mbikëqyrjes

- Aplikimi i masave kufizuese në shkallën më të lehtë është i mundur

Është në interesin e fëmijës që institucioni penal të ofrojë një klimë sociale të mirorganizuar, ku fëmijët të rriten duke u aftësuar për të funksionuar në mënyrë sa më të pavarur, pa qenë të influencuar apo kufizuar nga punonjësit. Fëmija nuk duhet të jetë subjekt i një ndërhyrjeje më të fuqishme dhe më agresive sesa minimumi i nevojshëm. Dispozitat tona ligjore parashikojnë procedura të veçanta për t'u ndjekur gjatë kontrolleve që u bëhen të miturve për sigurinë gjatë shoqërimeve, aktiviteteve, kohës së lirë, kohës së ajrimit, procedurave disiplinore, komunikimit etj. Le të diskutojmë për praktikën në institucione të ndryshme!

- Fëmija që vuan dënimin në kushte burgimi duhet të mbahet i veçuar nga të rriturit

Fëmijët duhet të ndahen nga të rriturit, përveç rasteve kur bëhet fjalë për anëtarë të familjes së tij. Përrjashtim bëhet në rastin kur kjo masë merret në interesin më të lartë të fëmijës dhe kur mosndarja është nën kontroll të plotë si pjesë e programit të veçantë.

Përvoja ka treguar se kontakti me të burgosurit e rritur është i rrezikshëm për fëmijët. Fëmijët që ndodhen në të njëjtin vend me të rriturit kanë mundësi më të mëdha të përdhunohen, të rrihen dhe të shfrytëzohen. Në vendin tonë është ngritur një institucion i veçantë për të miturit i cili është në Kavajë dhe kemi katër seksione të veçanta për fëmijët e arrestuar në Tiranë, Lezhë, Korçë dhe Vlorë. Por, mbajtja e fëmijëve në institucione për të rritur, edhe pse ata janë të veçuar, sjell pasoja negative në personalitetin e tyre. Kështu, në Planin e veprimit të Qeverisë për vitin 2012-2015, është parashikuar të ngrihen institucione të veçanta për të mitur që të ofrojnë një infrastrukturë më sociale dhe një atmosferë më të sigurt.

- Fëmijët e burgosur kanë të gjitha të drejtat e fëmijëve të tjerë

Fëmijët kanë të drejta dhe këto të drejta nuk hiqen ose kufizohen për fëmijët e burgosur ose nën mbikëqyrje, përveç masës së nevojshme të zbatimit të vendimit të gjykatës. Kështu, kur fëmija është në kushte burgimi, ajo që kufizohet është e drejta e tij e lirisë, por jo të drejtat e tjera. Ai

vazhdon të ruajë të drejtën për këshillim ligjor, të drejtën e fjalës dhe të drejtat e tjera. Të drejtat e tij mund të kufizohen vetëm si pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit. Të drejtat e fëmijës për dhënien e pëlqimit për trajtim ose kujdes mjekësor nuk preken.

- Duhet të lehtësohet përfshirja e familjeve të fëmijëve dhe e anëtarëve të komunitetit

Është e rëndësishme të njihet fakti se fëmija, pasi të kryejë dënimin e tij, do të kthehet një ditë në komunitet dhe mënyra më e mirë për një riintegrim të suksesshëm dhe shmangien e përsëritjes së veprës penale është krijimi i mundësive për përfshirjen dhe kontaktet e vazhdueshme me familjet, individët e tjerë që kanë ndikim te fëmija dhe anëtarët e komunitetit.

Ndërsa përfshirja e familjes mund të mos jetë gjithmonë e mundur ose e përshtatshme, në varësi të rrethanave, është e rëndësishme të ruhen lidhjet e nevojshme me ata persona që do të përfshihen në riintegrimin e fëmijës dhe do t'i japin atij mbështetje. Kjo mund të arrihet nëpërmjet programeve të vizitave, programeve të riintegrit, konferencave që synojnë riintegrimin, këshillimit dhe programeve të tjera që bëjnë të mundur që fëmija të mos izolohet ndërkohë që vuan dënimin, por të ndërtojë marrëdhënie që do ta ndihmojnë në riintegrimin e tij. Në praktikën e punës me të mitur në institucionet penale në vendin tonë janë krijuar lehtësi në aplikimin e lejeve, komunikimin në telefon deri në 16 herë në muaj, pra çdo dy ditë, dhe vizitat me familjarët dhe të afërmit.

- Vendimet duhet të merren në mënyrë të ndershme dhe në kohën e duhur

Ky parim rrjedh nga nevoja që vendimet që lidhen me fëmijët në kushte burgimi ose mbikëqyrjeje të jenë të ndershme, të hapura dhe të merren në kohën e duhur. Fëmijët duhet të dëgjohen dhe të marrin pjesë në shkallën më të gjerë të mundshme gjatë procesit të tyre dhe kur merren vendime që kanë lidhje me ta dhe njëkohësisht u duhet krijuar atyre mundësia për të pasur akses tek informacioni në të cilin mbështetet vendimi. Një shembull i rëndësishëm i kësaj mund të jetë përfshirja në zhvillimin e një plani riintegrimi. Një praktikë shumë e mirë pune për trajtimin e të miturve është metoda “You Turn” e cila është bërë e njohur për stafin e Institutit të Kavajës falë vizitave studimore në Holandë si dhe trajnimeve që janë kryer në këtë institucion. Kjo metodë synon të zhvillojë te të miturit aftësi e t’u mësojë atyre shkathtësi për të kryer detyrat e përditshme si dhe të zhvillojë tek ata vetëdije morale dhe sjellje me përgjegjësi. (Diskuto me pjesëmarrësit për mënyrën se si po zbatohet kjo metodë në Institutin e Kavajës)

- Krijimi i një klime të sigurt.

Të miturit e vendosur në institucione penale duhet të ndihen të sigurt për jetën e tyre. Ata duhet të mbrohen nga dhuna e grupit, arbitrariteti i stafit dhe çdo rrezik tjetër për jetën.

### **3.2 Menaxhimi i institucioneve për të mitur**

- Pranimi, regjistrimi, zhvendosja dhe transferimi

Pranimi i të miturve në Institucionet Penale bëhet vetëm mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe urdhrin të ekzekutimit të prokurorit mbi vendimin e dhënë “arrest me burg” apo dënim me burg.



Të gjitha informacionet për fëmijët duhet të mbahen në dosje konfidenciale, të hapura vetëm për një numër të kufizuar personash të autorizuar. Informacionet duhet të klasifikohen në mënyrë të tillë që të jenë lehtësisht të kuptueshme. Institucionet ku mbahen fëmijë në kushte burgimi duhet të krijojnë dosje të sigurta të cilat duhet të përmbajnë informacion për identitetin e fëmijës, fakte, arsyet e kryerjes së krimit, ditën dhe orën e pranimit, transferimin dhe lirimin, detaje të njoftimit të prindërve dhe stafit. Aty duhet të përfshihet edhe çdo detaj i njohur i problemeve fizike dhe mendore.

Me qëllim që të njihet me të drejtat e tij, fëmija duhet të pajiset me një kopje të rregullores së institucionit dhe përshkrimin e të drejtave dhe detyrimeve në një gjuhë të kuptueshme nga ai. Aty duhet të përfshihet adresa e autoritetit kompetent që pranon ankesat dhe emrat e adresat e organeve publike dhe private që ofrojnë asistencë ligjore. Në rastet kur fëmijët lëvizin ose zhvendosen nga institucionet, kjo duhet të bëhet në kushte ajrimi dhe drite të përshtatshme. Në asnjë mënyrë ata nuk duhet t'u nënshtrohen vuajtjeve dhe vështirësive.

*Këshillohet të ndiqet kjo radhë veprimesh gjatë pranimit të të dënuarit ose të të paraburgosurit:*

- Bëhet përcaktimi i saktë i identitetit të të miturit të dënuar ose të paraburgosur si dhe verifikimi i detajuar i të gjithë dokumentacionit përkatës: vendimit të gjykatës për dënimin me burg ose masën e sigurisë “arrest në burg”; dokumenteve të identifikimit me foto; vendimit të ekzekutimit të dënimit, lëshuar nga prokuroria; urdhër-arrestit; procesverbalit të kontrollit; kartelës mjekësore dhe të dhënave daktiloskopike.
- Identifikohen dhe plotësohen nevojat imediate të të miturit (ka rëndësi njoftimi i familjes ose i të afërmeve të tij; i jepen numrat e kontaktit që ai dëshiron të ketë gjatë kohës së qëndrimit në burg; si rregull, i mituri jep edhe emrat e personave me të cilët dëshiron të ketë kontakt). Identifikohen nevojat shëndetësore dhe problemet e sigurisë.
- Organizohet kontroll mjekësor, fizik dhe mendor i të miturit. Hapet kartelë mjekësore.
- Mbahet raport i saktë për treguesit jonormalë fizikë e mendorë dhe përgatitet informacioni për drejtorin e institucionit.
- Krijohen mundësi për higjienizimin e menjëhershëm të tij, larjen, qethjen dhe pajisjen me bazën materiale të nevojshme. Është shumë e rëndësishme për një person që të flejë në rroba të lara dhe higjienike.
- I mituri vendoset në një dhomë të veçantë për observimin e tij për jo më pak se tri ditë, kohë e cila shfrytëzohet për ta informuar atë për jetën e brendshme të institucionit, për mënyrën e funksionimit, kërkesat dhe kontaktet , mundësitë që i ofron institucioni etj.
- Komunikimi bëhet në mënyrë të sjellshme, me takt, dhe duhet të jetë i përshtatur me nevojat e të miturit. (Kurrë mos jepni këshilla dhe mos i kërkonti llogari në lidhje me çfarë ka bërë të tilla si “pse e kërke këtë apo atë”. Informacionin për veprën penale duhet ta merrni nga dosjet).
- Kryhen procedurat e kontrollit të imët të trupit dhe pajisjeve personale, pa cenuar dinjitetin e tij, për t'u siguruar se nuk posedon sende të ndaluara, në praninë e psikologut ose të punonjësës sociale të institucionit.
- Kryhen procedurat lidhur me identifikimin dhe magazinimin e pajisjeve personale dhe llogaritë e tyre.
- Në rastin e identifikimit të sendeve të ndaluara, ndiqen procedurat përkatëse.

Të gjitha të dhënat kryesore, si konkluzionet nga vëzhgimet e bëra ashtu edhe planifikimi i dënimit, aktivitetëve e programeve që do të zbatohen do të shkruhen në dosjen psikosociale. Një variant të dosjes e keni në këtë manual. Ju mund ta diskutoni dhe ta krahasoni me dosjen aktuale e cila është për të gjitha kategoritë e të dënuarve dhe paraburgosurve.

## SKEDA TEKNIKE<sup>8</sup>

### Të dhëna të përgjithshme

Emri dhe Mbiemri .....

Lindur në ..... më dt. ....banues në .....

Rruga .....

Lagja .....

Shtetësia ..... statusi civil .....

### Gjendja juridike

Pozicioni ligjor aktual .....

Titulli i veprës .....

.....

Data e hyrjes ..... data e arrestimit .....

Data e lirimit ..... arsyeja.....

Të bashkëndaluar .....

Prejardhja .....

Avokati.....

Punonjësi social.....

Edukatori.....

Shënime.....

.....

Në dispozicion të .....

.....

Kontaktet me shërbimet lokale para procedurës gjyqësore aktuale .....

.....

---

<sup>8</sup> Skeda Teknike, Instituti Penal për të Miturit, Bari Itali

Procedura të mëparshme gjyqësore .....

.....

### **Gjendja Familjare**

Prindërit:

Bashkëjetojnë: Po..... Jo.....

Mbiemri dhe emri                  Mosha                  Shkollimi                  Përvoja e punës:

.....

.....

Vëllezër dhe motra:

Emri                  Mosha                  Shkollimi                  Përvoja e punës:

.....

.....

Të afërm të tjerë:

Mbiemri dhe emri    Brezi i të afërmeve    Mosha    Shkollimi    Përvoja e punës:

.....

.....

Përndjekje penale në rrethin familjar: PO ..... JO .....

.....

Lidhje të rëndësishme:

Në rrethin e ngushtë familjar: PO ..... JO .....

.....

Në grupet formale: PO ..... JO ..... / joformale: PO ..... JO .....

.....

Me seksin e kundërt PO ..... JO .....

.....

#### AKTIVITETI SHKOLLOR DHE PËRVOJA E PUNËS SI DHE KOHA E LIRË

Shkollimi .....

.....

Shkalla e shkrim-leximit .....

Përvoja e punës.....

Veprimtari e kohës së lirë.....

#### KARAKTERISTIKAT PSIKOLOGJIKE - SJELLJET E DUKSHME QË NË MOMENTIN E HYRJES - GJENDJA EMOCIONALE

.....

.....

.....

.....

#### GJENDJA SHËNDETËSORE

Përdorues droge:

Përdorues i rastësishëm.....

Përdorues i përhershëm .....

Përdorues i pijeve alkoolike:

Pirës rasti.....

Pirës i përhershëm.....

Varësi ndaj alkoolit.....

Varësi të tjera .....

.....

Sëmundje të kaluara:

.....

.....

Sëmundje aktuale:

.....

.....

Vëzhgime:

.....

.....

Ndërhyrja e zbatuar nga operatorët:.....

.....

.....

Propozime nga ekupe

.....

.....

VENDIMET GJYQËSORE: (leje shpërblimi, autorizim për takime, thirrje telefonike etj.).....

.....  
.....

VËZHGIME TË PËRDITSHME

Sjellja gjatë paraburgimit:

.....  
Ndaj ambientit .....

.....  
.....

Ndaj stafit.....

.....  
.....

Marrëdhënia me operatorët.....

.....  
Tipologjia mbizotëruese e marrëdhënieve .....

.....  
Marrëdhëniet me shokët dhe pozicioni në grup.....

.....  
Reagimet në situatat e konfliktit me stafin .....

.....  
.....

Reagimet në situatat e konfliktit me grupin.....

.....

.....

Mënyra e reagimit ndaj ankthit .....

.....

Qëndrimi ndaj punës - formimit profesional - aktiviteteve të kohës së lirë

.....

**Pjesëmarrja në aktivitetet brenda institucionit**

Në cilat aktivitete merr pjesë.....

.....

Vazhdimësia.....

.....

Rezultati .....

.....

Lidhja me familjen gjatë periudhës së paraburgimit ose dënimit

.....

**VËZHGIME TË TJERA**

.....

**RAPORTET DISIPLINORE:**

.....

.....

- Klasifikimi, vendosja dhe ndërtimi i programit të rehabilitimit

Pas pranimit, fëmija duhet të intervistohet për të përcaktuar mënyrën më të përshtatshme të kujdesit social që do t'i rezervohet atij. Rastet që kërkojnë trajtim rehabilitues shoqërohen me një plan trajtimi individual, të përgatitur me shkrim nga ana e personelit të trajnuar, ku specifikohen objektivat e trajtimit. Bisedoni rreth metodologjisë You Turn, fazave dhe hapave që do të ndiqen për riintegrimin e fëmijës dhe kohës që nevojitet për afërsisht për çdo fazë.

- Edukim, trajnim profesional dhe punë

Qëllimi i edukimit është ta përgatisë fëmijën për lirin e tij. Kur e lejojnë rrethanat, edukimi i fëmijës së privuar nga liria duhet të bëhet në një mjedis jashtë institucionit, me programe që integrojnë sistemin edukativ kombëtar. Fëmijët kanë, gjithashtu, të drejtë të trajnohen profesionalisht për t'u përgatitur për një punësim të përshtatshëm.

Modeli më i mirë i trajtimit të fëmijës është modeli përkrahës i cili bazohet tek mundësitë dhe jo tek kufizimet e tij. Ky model synon t'i ofrojë të miturit mundësi për t'u përfshirë aktivisht në mënyrë që t'i japë fund të jetuarit me çrregullime dhe për të zhvilluar aftësitë bazë të jetës të tilla si ritmi i ditës dhe natës dhe përkujdesja ndaj vetes, të ngrënit bashkë me të tjerët, pastrimi i dhomës etj. (Shih më gjerë Manual Trajnimi për trajtimin e grave dhe të miturve, publikuar nga KShH dhe UNICEF, 2004)

Në përzgjedhjen e llojit të punës, fëmijët kanë të drejtë të zgjedhin natyrën e punës që ata dëshirojnë të bëjnë. Kur e lejojnë rrethanat, atyre duhet t'u jepet mundësia për të punuar në komunitetin vendor. Në asnjë rast, puna që bëjnë fëmijët nuk duhet të bjerë në kundërshtim me normat dhe standardet ndërkombëtare.

Komente mbi punësimin e të miturve në Institutin e Kavajës, të mbështetur nga Konkorsiumi Meridia.

- Koha e lirë

Institucionet ku vuajnë dënimin fëmijët duhet të sigurojnë kushte të përshtatshme për ushtrime ditore në ajër të pastër sa herë që e lejon koha. Veç kësaj, mund të zhvillohen edhe veprimtari të tjera rekreative.

- Feja



Nëse dëshirojnë, fëmijët mund të marrin pjesë ose të organizojnë vetë shërbime fetare. Atyre u njihet, gjithashtu, e drejta për të zotëruar dhe mbajtur libra fetarë dhe objekte të një natyre fetare. Në të njëjtën kohë, ata mund të refuzojnë çdo formë organizimi fetar ose pjesëmarrje në shërbime dhe edukim fetar.

- Kujdesi mjekësor

Në momentin e mbërritjes në institucion, fëmijët i nënshtrohen ekzaminimit mjekësor për të evidentuar trajtimet e mëparshme mjekësore ose për të identifikuar kushtet e shëndetit fizik dhe mendor që kërkojnë kujdes mjekësor.

Gjatë gjithë periudhës së heqjes së lirisë, fëmijët kanë të drejtë të kenë kujdes mjekësor parandalues ose mjekues, nëse është e mundur nëpërmjet shërbimeve të specializuara të shëndetit, në mënyrë që të mos ndihen të lënë pas dore. Ilaçet duhen dhënë vetëm për trajtime të domosdoshme mjekësore dhe, kur është e mundur, pas pëlqimit të vetë fëmijës. Përdorimi i ilaçeve si mjet për të marrë informacion prej të miturve ose për t'i bërë ata të pranojnë fajësinë apo si formë ndëshkimi është i ndaluar në të gjitha këto institucione. Gjithashtu, ndalohet edhe përdorimi eksperimental i ilaçeve dhe trajtimeve.

Institucionet duhet të miratojnë programe rehabilitimi dhe parandalimi nga abuzimi me substancat e ndryshme. Fëmijët që janë mendërisht të sëmurë duhet të trajtohen në institucione të pavarura të specializuara.

- Kontaktet me komunitetin

Kontaktet me komunitetin jashtë institucionit janë pjesë integrale e të drejtës për trajtim të ndershëm dhe njerëzor dhe thelbësore për përgatitjen e fëmijës për lirinë e tij.

Fëmijët duhet të lejohen të komunikojnë me familjet e tyre, shoqërinë dhe përfaqësuesit e organizatave. Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë takime të rregullta dhe të shpeshta. Të gjitha vizitat duhet të respektojnë të drejtën e fëmijës për fshehtësi. Ata duhet të lejohen, gjithashtu, të largohen nga institucionet për të vizituar familjet dhe leje të veçanta duhet t'u jepen për t'u larguar nga institucionet për qëllime edukimi, profesionale ose arsye të tjera të rëndësishme.

Çdo fëmijë ka gjithashtu të drejtën për të komunikuar, me shkrim ose, kur është rasti, me telefon, të paktën dy herë në javë, me një person që e zgjedh vetë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.

- Kufizimi i ndëshkimit fizik dhe i përdorimit të forcës

Mbajtja dhe përdorimi i armëve nga personeli i institucioneve ku mbahen fëmijët është e ndaluar. Instrumentet e ndëshkimit dhe të forcës mund të përdoren vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe vetëm kur kjo autorizohet në mënyrë specifike nga ligji ose rregullorja. Instrumente të tilla nuk duhet të shkaktojnë poshtërim ose degradim.

- Procedurat disiplinore

Të gjitha masat disiplinore duhet të merren në përputhje me ruajtjen e dinjitetit dhe të drejtave të fëmijëve. Puna duhet të konsiderohet si mjet edukimi dhe nuk duhet të imponohet si sanksion disiplinor.

Trajtimet mizore, çnjerëzore dhe degraduese, përfshirë ndëshkimet trupore; mbyllja në një qeli të errët, të mbyllur ose në izolim; pakësimi i ushqimit dhe kufizimi i kontakteve me familjen janë të ndaluara. Dënimet kolektive janë, gjithashtu, të ndaluara dhe asnjë fëmijë nuk duhet dënuar më shumë se një herë për të njëjtin gabim.

Asnjë fëmijë nuk duhet dënuar me sanksione disiplinore, përveçse kur parashikohet dhe është në përputhje me dispozitat e ligjit dhe rregulloreve në fuqi dhe vetëm pasi të jenë marrë informacione të sakta të shkeljes. Për masat disiplinore duhet të mbahen procesverbale të plota.

- Kontrolli dhe ankesat

Inspektorë të pavarur e të kualifikuar duhet të autorizohen të kryejnë kontrolle të rregullta si dhe të ndërmarin kontrolle të papritura me nismën e tyre. Fëmijëve duhet t'u njihet e drejta për të folur në kushte konfidencialiteti me çdonjërin nga ata. Çdo shkelje duhet t'u komunikohet autoriteteve kompetente për hetime të mëtejshme.

Fëmijët duhet të kenë mundësi të bëjnë kërkesa dhe ankesa pa u censuruar dhe duhet të informohen për përgjigjen pa vonesë. Për më gjerë, referoju Manualit të Trajnimit për nivelin e mesëm të menaxhimit, protokolleve të procedurave disiplinore dhe të ankesave e kërkesave si dhe protokolleve të përdorimit të forcës.

- Personeli

I gjithë personeli duhet të silltet në çdo kohë në mënyrë të tillë që të fitojë respektin e fëmijëve. Ky personel duhet, gjithashtu, të bëjë përpjekje maksimale për të minimizuar ndryshimin ndërmjet jetës brenda dhe jashtë institucionit. Për të qenë efektiv, personeli duhet t'i nënshtrohet trajnimeve për psikologjinë e fëmijëve, mirëqenien e tyre, të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve. Personeli është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo lloj abuzimi ose shfrytëzimi.

### **3.3 Ushtrime:**

1. Gjukata ka vendosur masën e sigurisë arrest me burg pa afat për një të mitur 16 vjeç, i ndaluar në kushte flagrante duke shpërndarë lëndë narkotike. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që e shoqëron, shihet se të miturit i mungon dokumenti i identifikimit, kështu që ju nuk jeni të sigurt nëse ai është i mitur, pra nën 18 vjeç, apo mbi këtë moshë dhe nuk jeni të qartë se ku do ta akomodoni, me të rriturit apo në seksionin e të miturve. Si do të veproni?

2. Gjatë pranimit të një të mituri, konstatooni se eskorta nuk ka në dosje vendimin e gjykatës dhe as urdhrin e ekzekutimit të prokurorit. Drejtuesi i eskortës këmbëngul të pranohet i mituri pasi është ndaluar në flagrancë duke vjedhur në një market. Si do të veproni?
3. Një i mitur 17-vjeçar, i cili frekuenton shkollën e mesme të përgjithshme dhe ka rezultatet të mira në mësim, pas një grindjeje me gjyshen e tij të cilës i kërkonte para, e vret atë pasi kundërshtoi t'ia plotësonte kërkesat. Gjykata ka dhënë masën e sigurisë arrest me burg. Prezantoni planin që do të ndiqni me të miturin gjatë kohës së dënimit.

## **KAPITULLI: PUNA ME FËMIJËT DHE ADOLESHETËT NË SISTEMIN PENITENCIAR**

Punonjësit e sistemit të burgjeve duhet të kenë njohuri dhe shprehi për të ndihmuar, mbështetur dhe trajtuar të dënuarit e mitur që i përkasin moshës 14-18 vjeç.

Ky manual adreson çështje të tilla si: trajtimi i të miturve, komunikimi, parimet e punës me grupet, teknikat e pjesëmarrjes, teknikat e punës me individin etj. Manuali synon të bëjë një prezantim teorik për këto çështje si dhe të ofrojë mundësi për krijimin e shprehive të nevojshme në praktikë nëpërmjet ushtrimeve, diskutimit të rasteve dhe diskutimeve në grup.

### **MODULI 1**

#### **PARIMET E PUNËS ME FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT BRENDË SISTEMIT PENITENCIAR**

Hyrje

- 1.1 Psikologjia e fëmijëve & adoleshentëve.
- 1.2 Promovimi i modelit të “resilience” (rezistencës)
- 1.3 Aftësitë për të promovuar mirëqenien psikosociale të fëmijëve.

### **MODULI 2**

#### **PRAKTIKA E PUNËS NË GRUP ME FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN**

Hyrje

- 2.1 Parimet filozofike të punës në grup me fëmijët dhe vlerat që duhen respektuar në punën me fëmijët
- 2.2 Praktika e punës në grup me fëmijët, qëllimet e punës dhe shembuj ilustrues

### **MODULI 3**

#### **PUNA INDIVIDUALE - TEKNIKA DHE METODA TË PUNËS ME FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN**

Hyrje

- 3.1 Procesi i këshillimit
- 3.2 Identifikimi i pikave të forta dhe mbështetja te pikat e forta në punën me fëmijët
- 3.3 Puna drejt zgjidhjes së mospërputhjeve dhe mesazheve mikse

## **MODULI 4**

### **TEKNIKA TË PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE**

Hyrje

4.1 Proçedurat miqësore të përfshirjes së fëmijëve

4.2 Roli i punonjësve të institucioneve penitenciare

4.3 Fëmijët me nevoja të veçanta

## **MODULI 5**

### **KOMUNIKIMI I PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE PENITENCIARE ME FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN, KOMUNIKIMI MIDIS KOLEGËVE NË SEKTORË TË NDRYSHËM**

Hyrje

5.1 Rëndësia e Komunikimi Efektiv

5.2 Llojet e Komunikimit Efektiv

5.3 Analiza e Komunikimit Efektiv

## **MODULI 6**

### **KONSUMIMI PROFESIONAL**

Hyrje

6.1 Konsumimi profesional në përgjithësi dhe në veçanti në stafet e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

6.2 Simptomat e konsumimit profesional.

6.3 Strategjitë personale dhe organizative për të parandaluar dhe trajtuar konsumimin profesional.

## **MODULI 1**

### **PARIMET E PUNËS ME FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT BRENDA SISTEMIT PENITENCIAR**

#### **PËRMBAJTJA**

##### **HYRJE**

1.4 Psikologjia e fëmijëve & adoleshentëve.

1.5 Promovimi i modelit të “resilience” (rezistencës)

1.6 Aftësitë për të promovuar mirëqenien psikosociale të fëmijëve.

##### Objektivat:

- Të kuptojmë aspektet e zhvillimit të fëmijëve ( fizik, emocional, social etj.)
- Të njohim psikologjinë e fëmijëve & adoleshentëve.
- Të kuptojmë modelin e “resilience” (rezistencës) dhe të identifikojmë mundësi në praktikë për ta integruar këtë model në punën me adoleshentët.

##### Rezultatet e pritura:

- Të përshkruajmë aspektet e zhvillimit të fëmijëve dhe të analizojmë se si ndikojnë ato në sjelljen e tyre.
- Të përshkruajmë elementë të psikologjisë së fëmijëve dhe adoleshentëve.
- Të përkufizojmë modelin “resilience” dhe të renditim elementët e këtij modeli.
- Të identifikojmë nëpërmjet diskutimit në grupe programe apo aktivitete ku mund të integrojmë modelin “resilience” në punën me fëmijët dhe adoleshentët në sistemin penitenciar.

Metodologjia : Prezantim në PP, diskutim rasti, diskutim në grup.

##### Përshkrimi i modulit

Ky modul do t’i pajisë pjesëmarrësit me njohuri për punonjësit e sistemit të burgjeve dhe paraburgimeve, për psikologjinë e fëmijëve dhe zhvillimin e tyre si dhe rëndësinë që kanë këto njohuri në kuptimin e sjelljes së tyre. Në këtë modul do të përshkruhet modeli “resilience” dhe elementët e tij. Pjesëmarrësve do t’u jepet mundësia të aplikojnë njohuritë e mara në një diskutim rasti dhe në diskutim në grup. Gjithashtu, do t’u kërkohet të identifikojnë mënyra të integritit të njohurive të mara në mjedisin ku punojnë.

##### Shtjellimi i modulit:

1. Trajneri/ja e hap seancën duke shpjeguar rëndësinë e njohjes së aspekteve të zhvillimit të fëmijëve. Shpjegohen aspektet e ndryshme të zhvillimit. Fokusi i trajnerit/es duhet të jetë qartësi i koncepteve dhe theksimi i aspekteve konkrete të përdorimit të këtyre njohurive në punën me fëmijët.
2. Pas shpjegimit të elementëve të psikologjisë të adoleshentëve ,trajneri/ja organizon diskutimin e rastit të përfshirë në sesion.

3. Trajneri do të përshkruajë modelin “resilience” dhe elementët e tij. Pjesëmarrësve do t’u kërkohet të identifikojnë mënyra të integritit të njohurive të mara në mjedisin ku punojnë.

*Mjetet:* Prezantim në PP; material për t’u shpërndarë.

## Hyrje

Zhvillimi i fëmijëve përfshin aspektet biologjike, aspektet psikologjike, aspektet sociale dhe ato të mjedisit social. Është shumë e rëndësishme që këto aspekte të zhvillohen tek fëmijët në mënyrë që ata të bëhen të rritur të shëndetshëm dhe të përgjegjshëm. Çdo aspekt zhvillimi ka faza të veçanta në jetën e qenieve njerëzore dhe, për këtë arsye, fëmijët janë shumë të ndryshëm nga të rriturit.

Kërkimet për zhvillimin e trurit kanë treguar se truri i adoleshentëve<sup>9</sup> është shumë i ndryshëm nga truri i të rriturve nga pikëpamja anatomike. Ky ndryshim bën që adoleshentët të jenë më pak në gjendje të vlerësojnë rrezikun, të kontrollojnë sjelljen impulsive dhe të analizojnë se ç’është e mira dhe e keqja në një shoqëri. Studimi i trurit nëpërmjet teknologjisë imazherike ka treguar se truri i adoleshentëve është i paformuar në këtë moshë dhe kjo lidhet me përfshirjen e tyre në sjellje antisociale apo vepra penale. Studiuesit kanë zbuluar se korteksi frontal, pjesa e trurit përgjegjëse për kontrollin e impulseve, vlerësimin e rrezikut dhe arsyetimin moral, zhvillohet në adoleshencën e vonë. Për shkak të këtij zhvillimi të vonë, adoleshentët përdorin amigdalën, pjesën e trurit që është përgjegjëse për emocionet, gjë që shpjegon sjelljen agresive dhe impulsive që vërehet tek ata. Përdorimi i amigdalës bën që sjellja e tyre të bazohet më shumë te emocionet sesa te aftësitë konjitive<sup>10</sup> që përfshijnë marrjen e vendimeve, vlerësimin e rrezikut, aftësinë për të gjykuar për pasojat në të ardhmen, vlerësimin e shpërblimit dhe ndëshkimit, ndalimin e disa sjelljeve, kontrollin e impulseve, reagimet e duhura ndaj përgjigjeve pozitive dhe negative si dhe gjykimin moral. Të gjithë këta elementë duhet të mbahen parasysh kur merren në shqyrtim veprimet e adoleshentëve. Edhe adoleshentët më të rritur janë më pak të aftë se të rriturit që të vlerësojnë rrezikun, të kontrollojnë sjelljen e tyre dhe të bëjnë arsyetime morale. Adoleshentët që kanë probleme të zhvillimit, probleme të shëndetit mendor, probleme familjare apo sociale kanë më shumë vështirësi se të tjerët në kontrollin e emocioneve dhe sjelljes së tyre.

*“Papjekuria e sjelljes së adoleshentëve pasqyron papjekurinë anatomike të trurit të tyre. Shkencëtarët tashmë e kanë provuar këtë”<sup>11</sup>.*

- **Psikologjia e fëmijëve & adoleshentëve.**

Psikologjia është shkenca që merret me proceset konjitive<sup>12</sup> dhe sjelljen e qenieve njerëzore. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i zhvillimit sidomos të adoleshentëve janë proceset biologjike ose fiziologjike që shoqërojnë sjelljen dhe proceset konjitive. Ne do të përmendim vetëm në vija të përgjithshme se cilat janë ndryshimet fiziologjike gjatë adoleshencës dhe si këto ndryshime ndikojnë tek sjellja, të menduarit dhe zgjidhja e problemeve.

---

<sup>9</sup>Nuk ka një kohë të përcaktuar saktë se kur fillon dhe mbaron adoleshenca. Në këtë manual do të konsiderojmë adoleshencë moshën 12-18 vjeç.

<sup>10</sup> Të menduarit

<sup>11</sup> Thënë nga ekspertët psikiatër në seancën dëgjimore në Gjykatën e Lartë të SHBA, Rasti Roper kundër Simmons

<sup>12</sup>Proceset konjitive përfshijnë të gjitha proceset mendore si p.sh. të menduarit, të ëndërruarit, kujtesën ose zgjidhjen e problemeve. Shih Psikologjia, T.F.Pettijohn, Botimi II, Shtëpia Botuese LILO,Tiranë,1996

Në këtë pjesë të manualit do të flasim për proceset konjitive të të menduarit dhe zgjidhjen e problemeve, për sjelljen tek adoleshentët dhe për proceset fiziologjike që ndodhin tek ata dhe ndikimin e tyre te të menduarit dhe sjellja.

**Të menduarit** është një aktivitet konjitiv ose mendor i manipulimit të simboleve. Për njerëzit, të menduarit nënkupton gjuhën dhe përfytyrimet mendore që krijohen nga përdorimi i gjuhës dhe lidhet me mënyrën e formimit të koncepteve. Gjuha është gjuha që ne përdorim (gjuha shqipe në rastin tonë) dhe ajo kushtëzon formimin e koncepteve duke filluar nga ato më të thjeshtat si p.sh. fruta, makina, televizori deri tek ato më të vështirat si p.sh. “nëse është veprim në kundërshtim me ligjin atëherë ndalohej dhe nëse ndalohej atëherë duhet të jetë në kundërshtim me ligjin”. Formimi i konceptit është një formë e të menduarit që na ndihmon të kuptojmë më mirë botën në të cilën jetojmë dhe vetveten.

Teoritë që shpjegojnë zhvillimin e koncepteve janë të ndryshme. Ndër më kryesoret janë:

- **Teoria asociative ngacmim-reagim** (Clark Hull 1920) që thotë se ne e krijojmë konceptin duke lidhur një reagim të veçantë (koncept) me shumë ngacmime që përkufizojnë konceptin. P.sh. konceptin “pulë” e lidhim me gjithë karakteristikat e pulave (dy këmbë, e mbuluar me pupla) dhe kështu bëhemi të aftë ta përgjithësojmë konceptin për të gjithë pulat.
- **Teoria e testimit të hipotezës** (Jerome Bruner *et al* 1956) që thotë se ne përpunojmë strategji të veçanta për testimin e hipotezave tona rreth një koncepti duke marrë me mend se cilat cilësi janë themelore për të përkufizuar konceptin. P.sh. “vjedhje” është një koncept që mund të ekzistojë i ndryshëm në individë të ndryshëm në varësi të testimit të hipotezës që ata kanë bërë mbi këtë koncept.
- **Teoria ekzemplare** (Eleanor Rosch 1978) që thotë se konceptet tona mësohen më tepër nëpërmjet shembujve sesa nëpërmjet rregullave abstrakte. Sipas saj, ne e mësojmë konceptin e “qenit” duke parë lloj-lloj qensh dhe përpunojmë një prototip të qenit tipik. E njëjta gjë aplikohet edhe në rastin e konceptit “vjedhje”, pra koncepti varet nga shembujt me të cilët ne jemi ekspozuar.

Shumë nga konceptet e gabuara që mund të kenë fëmijët apo adoleshentët në lidhje me konceptet konvencionale vijnë për shkak të aplikimeve të gabuara apo dhe shembujve të gabuar në jetën e tyre.

**Zgjidhja e problemeve** shihet si një proces konjitiv që e kanë të gjitha qeniet, si njerëzit ashtu edhe kafshët. Kemi një problem kur kërkojmë të zgjidhim një situatë të caktuar dhe, gjatë zgjidhjes, na dalin vështirësi. Gjatë gjithë jetës ne përballemi me probleme të cilat duhet t'i zgjidhim. Adoleshentët përballen me probleme “të vogla”, si p.sh. zgjedhja e veshjes për të shkuar në një mbrëmje, dhe me probleme më “të mëdha”, si p.sh. marrja e vendimit për të qenë pjesë e një grupi dhe kryerja e një veprimi në kundërshtim me ligjin.

Teoritë që shpjegojnë zgjidhjen e situatave problematike janë:

- **Teoria e të mësuarit** e cila bazohet në rolin e provës dhe të gabimit. Autori kryesor i saj, Edward Thorndike, thotë se njerëzit mësojnë t'i zgjidhin problemet nëpërmjet provë-gabimit. Nëse duam të arrijmë diçka, ne përpiqemi me disa mënyra dhe mënyrën me të cilën arrijmë ta zgjidhim atë vazhdojmë ta përsërisim si mënyrë për zgjidhjen e problemeve të ngjashme.
- **Teoria e kthjellimit psikik** (Wolfgang Kohler 1925) që është teoria që shpjegon zgjidhjen e situatave problematike duke përdorur kthjellimin psikik si një mënyrë të dobishme për zgjidhjen e problemeve. Kthjellimi psikik ndodh atëherë kur ne kuptojmë situatën ku ndodhemi dhe vlerësojmë mjetet që kemi në dispozicion për zgjidhjen e saj.



- **Teoria e procesimit të informacionit** e cila thotë se ne e zgjidhim problemin duke qenë aktivë në zgjidhjen e tij. Kjo teori e vë theksin në aftësitë e individit që përballet me problemin. Këto aftësi shfaqen në disa faza të zgjidhjes së problemit të cilat janë:

1. Formulimi i problemit
2. Transformimi i tij në trajta që lehtësojnë zgjidhjen
3. Përpilimi i një strategjie për zgjidhjen e tij
4. Përdorimi i informacionit gjatë kalimit hap pas hapi drejt zgjidhjes

Efikasiteti i zgjidhjes së problemit

Suksesi në zgjidhjen e problemeve ndikohet nga disa faktorë, ndër të cilët më të rëndësishëm janë: perceptimi i problemit (pa e perceptuar si problem nuk mund të fillosh ta zgjidhësh), motivacioni për ta zgjidhur (kur është shumë i lartë mund të pengojë, sidomos te adoleshentët, sepse prodhon shumë stres) dhe gjuha (përdorimi i gjuhës për të organizuar mendimet që çojnë drejt një zgjidhjeje). Adoleshentët duhen ndihmuar t'i zhvillojnë këta faktorë me qëllim që të mund të zgjidhin problemet në mënyrë efektive.

Sipas teorisë së kthjellimit psikik hapat për zgjidhjen e problemit janë: përgatitja, inkubacioni, ndriçimi dhe verifikimi.

Në fazën e përgatitjes adoleshenti ndihmohet të fitojë sa më shumë informacion që mund të përdoret për zgjidhjen e problemit dhe të shqyrtojë disa zgjidhje.

Në fazën e inkubacionit adoleshenti ndihmohet të shkëputet nga problemi dhe ta lërë trurin të procesojë mundësitë. Gjumi, pushimet midis seancave të këshillimit ose aktivitete të tjera mund të shërbejnë si aktivitete inkubative.

Në stadin e ndriçimit ne kthjellohemi psikikisht për një zgjidhje të problemit. Në këtë stad, është mirë që adoleshenti të takohet pa humbur kohë.

Stadi i fundit është verifikimi, ku tentohet të vihet në zbatim zgjidhja më e mundshme. Nëse problemi zgjidhet, atëherë ky është fundi i procesit; nëse jo, kthehemi në stadin përgatitor dhe grumbullojmë informacion dhe fakte që mund të na çojnë drejt zgjidhjeve të reja.

Punonjësit që punojnë me fëmijët duhet t'i familjarizojnë adoleshentët me statet e zgjidhjes së problemit dhe të provojnë së bashku me ta shembuj të zgjidhjes së problemeve specifike. Në këtë mënyrë, adoleshentët brendësojnë skemën e zgjidhjes së problemeve të cilën do ta aplikojnë në të ardhmen.

**Sjellja** përkufizohet si gjithçka që bëjmë, qoftë kur jemi vetëm qoftë kur jemi të vëzhguar nga të tjerët. Sjelljet ne i mësojmë dhe të mësuarit përkufizohet si një ndryshim relativisht i përhershëm në sjellje apo në aftësinë e individit për të kryer një sjellje të caktuar që ndodh si rezultat i përvojës.

Procesi i të mësuarit lidhet shumë me sjelljen apo reagimin në situata konkrete. Ka shumë teori që shpjegojnë të mësuarit dhe sjelljen. Teoritë për sjelljen mund të grupohen në teori biologjike, teori të të mësuarit konjitiv dhe teori të të mësuarit social.

### **Sjellja dhe teoritë biologjike**

Kështu, teoria e kushtëzimit klasik (Pavlov, 1904) thotë se ne mësojmë nëpërmjet lidhjes ngacmues-reagim. Teoria e kushtëzimit veprues (Thorndike 1911) thotë se ne tentojmë të përsërisim ato sjellje që na japin kënaqësi në situata të caktuara dhe, përkundrazi, priremi të mos përsërisim një sjellje që nuk na sjell kënaqësi.

### **Sjellja dhe teoritë e të mësuarit konjitiv**

Teoria e kthjellimit psikologjik (shih më sipër) është një nga teoritë që shpjegon të mësuarit e sjelljeve të caktuara. Teoria e të mësuarit latent (Edward Tolman, 1932) thotë se të mësuarit latent ndodh kur individi ka dije për diçka, por nuk i manifeston ato deri sa të jetë i motivuar për ta bërë këtë. Teoria e të mësuarit nëpërmjet vëzhgimit (Albert Bandura, 1977) thotë se në mësojmë sjellje të caktuara nëpërmjet vëzhgimit, duke sjellë shembullin e eksperimentit në një kopsht për fëmijë, ku agresiviteti i fëmijëve u shfaq duke vëzhguar të rritur që silleshin në mënyrë agresive ndaj kukullave. Imitimi i të rriturve është koncept kryesor i kësaj teorie.

### **Sjellja dhe teoritë e të mësuarit social**

Biheviorizmi dhe Personaliteti (B.E. Skinner) thotë se personaliteti përkufizohet si mënyrat e mësuarat të të sjellit. P.sh. nëse një individ godet një tjetër, shpjegimi që jep kjo teori është që ky individ mund të ketë mësuar që po të godasë individë të një tipi të caktuar nuk do të ndëshkohet. Nëse do të godiste njerëz të tjerë, ai e di që do të kishte pasoja negative prandaj ai e kryen një sjellje të caktuar vetëm me njerëz të veçantë që ai i percepton si “të dobët”.

Teoria e të mësuarit social ose e modelimit (Albert Bandura) thekson rolin e vëzhgimit dhe modelimit, pra individi kryen sjellje të vëzhguara më parë dhe i shfaq ato në varësi të përforcimit.

Teoria e lokusit të kontrollit (Rotter, 1954) thotë se potenciali i sjelljes është mundësia e një sjelljeje të caktuar për t'u shfaqur në një situatë të caktuar. Ai thotë se sjellja varet nga dy faktorë: pritshmëria dhe përforcimi. Kjo teori thotë se sjellja e njerëzve varet shumë nga të pasurit e një lokusi të brendshëm apo lokusi të jashtëm kontrolli. Njerëzit me lokus të brendshëm kontrolli mendojnë se përforcimi varet nga sjellja dhe vetitë e tyre, p.sh. ata besojnë se, në qoftë se punojnë shumë, do të shpërblehen. Njerëzit me lokus të jashtëm ndiejnë se përforcimi nuk varet nga sjellja e tyre, por nga forca të jashtme. Njerëzit me lokus të jashtëm nuk mund të parashikojnë pasojat e sjelljeve të tyre sepse ata mendojnë se nuk mund t'i ndryshojnë dot gjërat.

### **Ndikimi i faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve**

Zhvillimi emocional, konjitiv (të menduarit) dhe social i fëmijëve dhe adoleshentëve ndikohet nga shumë faktorë biologjikë, psikologjikë dhe socialë, të cilët mund të përmbliidhen si më poshtë:

Faktorët biologjikë që ndikojnë zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve janë:

- Trashëgimia gjenetike (përcakton nëse jemi të turpshëm apo jo, të irrituar apo të qetë, optimistë apo pesimistë, të përmbajtur apo aventurierë)
- Fiziologjia (prodhimi i hormoneve në tru, balancimi i tyre në tru etj.)
- Dëmtime të ndryshme (aksidente, goditje etj.)

Faktorët psikologjikë që ndikojnë zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve janë:

- Atashimi (lidhja e fëmijës me njerëz të afërm për t'i pasur pranë në situata nevojë dhe stresi)
- Modelimi
- Ndërveprimi social

Faktorët socialë që ndikojnë zhvillimin e fëmijëve dhe adoleshentëve janë:

- Mjedisi ku rriten (shkolla, komuniteti, shoqëria)

- Varfëria
- Strehimi i keq ose mospasja e strehimit
- 

### **Ndërtimi i trurit të adoleshentëve, proceset konjitive dhe sjellja e tyre**

Truri i fëmijës është ndërtuar në mënyrë të tillë që të nxjerrë një kuptim nga çdo eksperiencë. Por, që të zhvillojë kuptim për këto eksperiencë, duhet të ekspozohet ndaj tyre. Kjo vlen për të mësuar për të folur, por edhe për të njohur dhe kuptuar veten dhe të tjerët<sup>13</sup>.

Burimi kryesor i eksperiencave psikologjike të fëmijëve është ndërveprimi me prindërit apo kujdestarët e tyre. Në rastet kur fëmijët apo adoleshentët kanë mungesë ndërveprimi apo ndërveprim negativ me prindërit dhe kujdestarët, këto eksperiencë nuk krijohen ose krijohen të deformuara duke e lënë fëmijën vetëm dhe pa mjetet e duhura për të përballuar frikën, ankthin dhe stresin që mund të përjetojë si të gjitha qeniet njerëzore. Cilësia e prindërimit dhe marrëdhënia me prindërit apo kujdestarët ndikon jo vetëm në krijimin e ndjenjës së sigurisë të fëmija, por edhe në cilësinë e karakterit dhe vetes që fëmija formon. Mënyra me të cilën fëmijët janë rritur ndikon në mendjen e tyre dhe në karakterin e vetes së tyre si të rritur.

### **Rehabilitimi dhe ndryshimet në zhvillimin e trurit të adoleshentëve**

Studimet sugjerojnë se adoleshentët kanë më shumë mundësi për t'u rehabilituar se të rriturit sepse personaliteti i tyre vazhdon të krijohet ndërsa truri i tyre vazhdon të ndryshojë. Shumë adoleshentë i kapërcejnë gabimet e tyre gjatë adoleshencës dhe kalojnë në jetën e rritur si njerëz të përgjegjshëm.

#### *Rast<sup>14</sup>*

*Në vitin 2005, Gjykata e Lartë e SHBA-së njohu dhe pranoi lidhjen midis zhvillimit të trurit të adoleshentëve dhe aspekteve psikologjike dhe sjelljes kriminale në rastin Roper kundër Simmons. Në këtë vendim, u pranua që ka tre ndryshime midis adoleshentëve dhe të rriturve. Së pari, Gjykata njohu faktin që adoleshentët janë më pak të pjekur se të rriturit dhe kjo papjekuri mund të çojë në sjellje apo veprime në kundërshtim me ligjin. Së dyti, Gjykata pranoi se adoleshentët janë më shumë nën ndikimin negativ të bashkëmoshatarëve sesa të rriturit. Së treti, Gjykata pranoi se personaliteti i adoleshentëve është në ndryshim e sipër dhe ka akoma kohë për formimin e personalitetit. Këto tre parime ndikuan në vendimet për fëmijët dhe adoleshentët nga gjykatat më të ulëta.*

### **Adoleshenca si një fazë e zhvillimit njerëzor dhe problematikat e saj**

Bihet dakord që adoleshenca fillon në kohën e pubertetit. Për djemtë, puberteti arrihet në moshën 13-vjeçare ndërsa për vajzat rreth moshës 11-vjeçare. Adoleshenca është një periudhë në të cilën ndodhin shumë ndryshime fizike të cilat përshkojnë dhe ndikojnë fazën e transicionit nga varësia në pavarësi. Emocionet janë shumë të pranishme në këtë moshë dhe vihen re kalime nga një emocion te i kundërti i tij.

<sup>13</sup>Fonagy *et al.* Affect regulation, mentalization and the development of the self. 2002, New York:Other Press

<sup>14</sup> Marrë nga "A Reexamination of Youth Involvement in the Adult Criminal Justice System in Washington", Janar 2009

Gjatë adoleshencës, fëmijët ndeshen me probleme të tilla si seksi, vetëdija, kontrolli prindëror, normat morale dhe konformizmi ndaj normave sociale.

### **Identiteti i adoleshentëve**

Adoleshentët janë në kërkim të përgjigjes së pyetjes “Kush jam unë?”. Konfuzioni në të cilin ndodhen lidhet me kërkesat që u vë përpara kalimi nga fëmijëria në moshën e rritur. Identiteti<sup>15</sup> përkufizohet si një organizim i brendshëm i motiveve, aftësive dhe besimeve të një njeriu. Marcia thotë se kriza dhe përkushtimi janë pjesë të rëndësishme të formimit të identitetit. Gjatë krizës, adoleshentët marrin parasysh alternativat dhe gjatë përkushtimit vendosin të bëjnë një veprim të caktuar. Ndiham e prindërve, mësuesve dhe profesionistëve duhet të konsistojë në të kuptuarit e tyre, lehtësimin dhe mbështetjen gjatë këtij procesi.

### **Marrëdhëniet familjare/të rriturit me autoritet**

Formimi i identitetit shoqërohet me dëshirën për pavarësi. Në familje krizat shpesh vijnë nga këto lloj konfliktesh. Aftësitë komunikuese, kontrolli i moderuar, respektimi i dinjitetit të adoleshentit, autoriteti prindëror i duhur dhe bashkëveprimi janë disa mënyra për të reduktuar konfliktet me adoleshentët.

### **Marrëdhëniet me shokët/shoqet**

Adoleshentëve u pëlqen të shoqërohen me individë që kanë interesa dhe personalitete të ngjashme. Hays (1985) doli në përfundimin se shoqëria midis djemve zhvillohet nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta, ndërsa shoqëria midis vajzave zhvillohet përmes komunikimeve verbale. Këto karakteristika duhet të “shfrytëzohen” për të ndërtuar marrëdhëniet me adoleshentët në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Programe të tilla si sporti apo arti janë shumë të mira për të mësuar respektin për rregullat për djemtë dhe poezia apo reflektimi janë programe të mira për vajzat. Gjithsesi, nuk ka studime të cilat tregojnë për dallime gjinore në efektivitetin e programeve të veçanta.

### **Marrëdhëniet seksuale**

Adoleshenca nxit dëshirat seksuale dhe adoleshentët kërkojnë të kenë marrëdhënie me partnerë intimë. Këto dëshira janë normale për adoleshentët dhe duhen trajtuar si të tilla nga punonjësit e institucioneve.

### **Probleme të veçanta të adoleshentëve**

Adoleshenca shoqërohet me disa probleme të cilat duhet të njihen nga punonjësit e institucioneve. Jo të gjithë adoleshentët përballen me këto probleme por, gjithsesi, ato duhet të kihen parasysh: tentativa për vetëvrasje apo vetëvrasja, abuzimi me substancat, problemet me peshën, presioni nga bashkëmohatarët, agresiviteti etj. Probleme të tjera që mund të evidentohen dhe duhen marrë në konsideratë gjatë punës me adoleshentët janë: çrregullimet e të mësuarit, aftësia e kufizuar, çështje të shëndetit mendor, probleme familjare dhe braktisja nga prindërit.

---

<sup>15</sup> James Marcia, 1980

## Teoria e Zhvillimit Psikosocial dhe Adolehenca

Erik Erikson (1963) solli teorinë e zhvillimit psikosocial nëpërmjet të cilës e trajtoi zhvillimin si një proces që ndodh gjatë gjithë jetës. Ai e ndan zhvillimin në tetë stade nga lindja deri në vdekje. Koncepti kryesor i kësaj teorie është që, në çdo stad, individi përjeton një krizë që shoqërohet me një detyrë zhvillimi dhe, nëse e përballon mirë këtë krizë, kalon në stadin tjetër. Stadet janë si më poshtë:

1. 0-1 vjeç
2. 2-3 vjeç
3. 4-5 vjeç
4. 6-11 vjeç
5. Adolehenca 11-18 vjeç
6. Moshë e rritur e hershme 18-45 vjeç
7. Moshë e rritur e mesme 46-65 vjeç
8. Moshë e rritur e vonë 65-vdekje

Stadi i pestë përkon me moshën e adolehencës dhe adolehenti tenton të zbulojë kush është ai si një individ i veçantë i shprehur nga të tjerët. Kriza e këtij stadi njihet si identiteti kundrejt përshtjellimit të roleve. Detyra e zhvillimit gjatë këtij stadi është formimi i konceptit pozitiv për veten. Ata mund të imitojnë njerëzit që u duken të suksesshëm si prindërit, shokët etj. Ata mund të përjetojnë krizë identiteti nëse sjelljet që imitojnë nuk u rezultojnë të suksesshme dhe janë në kërkim të një identiteti të suksesshëm. Në këtë stad, adolehentët duhet të fillojnë të hedhin hapa drejt asaj që dëshirojnë të bëjnë në të ardhmen.

### • Promovimi i modelit të “resilience” (rezistencës)

Reziliencia është një koncept që është zhvilluar për të potencuar kapacitetin e fëmijëve dhe adolehentëve për të përballuar e kapërcyer situatat problematike dhe për t'u zhvilluar në drejtimin e duhur. Ky koncept mbahet parasysh në të gjitha programet për fëmijët dhe adolehentët duke u përfshirë si një parim dhe duke u zhvilluar nëpërmjet teknikave të ndryshme.

Resiliencia bazohet në tre burimet e saj: Unë Kam, Unë Jam dhe Unë Mund. Këto tre burime kanë elementet e tyre të cilat, nëse nuk ekzistojnë apo janë të dobëta tek fëmijët dhe adolehentët, prindërit, kujdestarët dhe punonjësit e institucioneve duhet t'i nxisin.

#### Unë Kam:

- Njerëz rreth meje të cilëve unë i besoj dhe që më duan, pavarësisht nga çdo gjë
- Njerëz që më vënë kufij dhe unë e di kur duhet të ndaloj para se të ketë rrezik për mua
- Njerëz që më tregojnë se si t'i bëj gjërat në mënyrën e duhur përmes sjelljes së tyre
- Njerëz që duan që unë të mësoj t'i bëj gjërat vetë
- Njerëz që më ndihmojnë kur jam sëmurë, në rrezik apo në nevojë për të mësuar

#### Unë Jam:

- Një njeri që të tjerët mund ta pëlqejnë dhe ta duan
- I kënaqur kur bëj gjëra të mira për të tjerët
- I respektueshëm ndaj vetes dhe të tjerëve
- Me dëshirë për të qenë i përgjegjshëm për gjërat që bëj
- I sigurt që gjërat do të rregullohen apo ndryshojnë për mirë

## Unë Mund:

- Të flas me të tjerët për gjërat që më frikësojnë apo shqetësojnë
- Të gjej mënyra për të zgjidhur problemet me të cilat përballem
- Të kontrolloj veten kur duket se jam para një rreziku apo para një sjelljeje “të keqe”
- Të kuptoj se kur është koha për të folur me dikë apo për të vepruar
- Të gjej dikë për të më ndihmuar kur kam nevojë

Listë kontrolli për Resiliencën<sup>16</sup> tek fëmijët (mund të përdoret për çdo fëmijë)

- Fëmija ka dikë që e do atë pavarësisht nga çdo gjë.
- Fëmija ka një person të rritur jashtë shtëpisë/institucionit të cilit mund t'i tregojë për problemet dhe ndjenjat e tij.
- Fëmija shpërblehet për gjërat që bën në mënyrë të pavarur.
- Fëmija është i sigurt që familja/punonjësit e institucionit do të jenë me të kur ai të ketë nevojë.
- Fëmija njih dhe pranon dikë si model të cilit do t'i ngjajë kur të rritet
- Fëmija beson që çdo gjë do të rregullohet/ndryshojë për mirë
- Fëmija i di pritshmëritë që kanë të tjerët për të
- Fëmija beson te fuqia e tij për të ndryshuar situatën
- Fëmija dëshiron të provojë mundësi/rrugë të reja
- Fëmija kërkon të arrijë sukses në atë që bën/ndërmerr
- Fëmija ndien se ai mund të ndikojë në ndryshimin e situatës
- Fëmija e pëlqen veten
- Fëmija mund të fokusohet në një detyrë dhe të përpiqet ta realizojë me sukses
- Fëmija ka sens humori (nuk është i tërhequr, i dëshpëruar)
- Fëmija zhvillon plane për të arritur rezultat

## • Aftësitë për të promovuar mirëqenien psikosociale të fëmijëve

Aftësitë që nevojiten për të promovuar mirëqenien psikosociale të fëmijëve lidhen me besimet dhe qëndrimet; sjelljen profesionale; etikën; informacionin shkencor dhe përgatitjen profesionale.

**Qëndrimet** janë predispozita (ndjenja, mendime dhe sjellje) të mësuara që na udhëheqin drejt sjelljeve specifike. Edhe profesionistët kanë qëndrime ndaj njerëzve të tjerë, sjelljeve/objekteve apo ideve të caktuara. Profesionistët duhet të pranojnë qëndrime të tilla si:

- Sjellja është e ndryshueshme.
- Fëmija duhet të trajtohet me kujdes të veçantë.
- Fëmija mëson nëpërmjet modeleve pozitive, njëri prej të cilëve mund të jem unë.
- Të drejtat e fëmijëve janë të paprekshme.
- Çdo veprim i imi do të bazohet në interesin më të lartë të fëmijës.
- Institucionet për fëmijët duhet të jenë shumë më të kontrolluara nga familjarët/profesionistët/institucionet.

<sup>16</sup> Marrë nga A Guide to Promoting Resilience in Children: Strengthening the Human Spirit, Edith H. Grotberg, The International Resilience Project

**Sjellja** që promovon mirëqenien është ajo sjellje që lehtëson situatën në të cilën ndodhet fëmija dhe ia shpjegon këtë situatë fëmijës me një gjuhë të kuptueshme; ndihmon fëmijën të identifikojë pikat e forta dhe burimet që duhet të përdorë për ta kapërcyer situatën dhe përforcon ose zhvillon burime të reja ku fëmija të mbështetet për të pasur një të ardhme larg krimit.

**Sjellja profesionale** bazohet në legjislacionin ekzistues, të drejtat e fëmijëve, interesin më të lartë të fëmijës, zhvillimin e fëmijës, parimet e punës me fëmijët dhe analizën e pasojave të çdo veprimi/situatë që kryhet nga fëmija apo që fëmija kalon.

## **Etika**

**Etika profesionale** lidhet me detyrimet e punonjësve të institucioneve kundrejt klientëve (fëmijëve), profesionistëve të tjerë (brenda ose jashtë institucioneve) dhe publikut. Etika formohet nga një sërë detyrimesh që punonjësit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale i pranojnë si pjesë e statusit të tyre profesional, në varësi të pozicioneve që marrin.

Ndër parimet etike që mund të përmenden janë:

- Respekti për veçantinë, individualitetin dhe dinjitetin e individit
- Respekti për mendimin e fëmijës dhe vetëvendosjen e tij gjatë procesit të trajtimit
- Konfidencialiteti
- Pragmatizmi (Bëni çdo gjë që është etike dhe që funksionon; zhvilloni mundësi për klientët që të mund të marrin pjesë në vendime të cilat rritin pjesëmarrjen e tyre në ndihmën e ofruar; bëni (vetëm) atë që është e nevojshme për të dhënë ndihmë”<sup>17</sup>).

## **Informacioni dhe përgatitja profesionale**

Punonjësit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, veçanërisht ata që punojnë me fëmijët, kanë nevojë të përgatiten në mënyrë profesionale, të freskojnë njohuritë dhe të rrisin aftësitë si dhe të bazojnë ndërhyrjet e tyre në studime apo programe të suksesshme.

---

<sup>17</sup> Egan, 1990, fq. 61

## MODULI 2

### PUNA NË GRUP ME FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

#### PËRMBAJTJA

**2.1 Parimet filozofike të punës në grup me fëmijët dhe vlerat që duhen respektuar në punën me fëmijët**

**2.2 Praktika e punës në grup me fëmijët, qëllimet e punës dhe shembuj ilustrues**

#### Objektivat:

- Të njohim parimet filozofike të punës në grup me fëmijët.
- Të njohim vlerat, njohuritë dhe aftësitë që duhet të kenë punonjësit e institucioneve penitenciare.
- Të njohim dhe kuptojmë perspektivat e punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët.
- Të njohim qëllimet e punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët dhe të zhvillojmë qëllime të punës me grupe të veçanta.
- Të njohim praktika të punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët.
- Të njohim dhe analizojmë në kontekstin tonë shembuj ilustrues të praktikës së punës në grup.

#### Rezultatet e pritura:

- Të përshkruajmë parimet filozofike të punës në grup me fëmijët.
- Të përshkruajmë vlerat, njohuritë dhe aftësitë që duhet të kenë punonjësit e institucioneve penitenciare.
- Të përshkruajmë perspektivën e punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët.
- Të përkufizojmë qëllimin e punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët dhe të zhvillojmë qëllimin e punës në grup në raste të veçanta.
- Të analizojmë praktika të punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët dhe të renditim avantazhet dhe disavantazhet e tyre.
- Të identifikojmë, nëpërmjet diskutimit në grupe, shembuj ilustrues të praktikës së punës në grup, të dhënë në literaturë dhe të sjellë nga praktika e punës së pjesëmarrësve në sistemin penitenciar.

Metodologjia: Prezantim në PP, diskutim rasti, diskutime në grupe.

#### Përshkrimi i modulit

*Sesioni 1* do t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri mbi parimet filozofike të punës në grup dhe vlerat, njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten punonjësve të institucioneve penitenciare. Në këtë sesion pjesëmarrësit do të njihen me perspektivat e punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët.

*Sesioni 2* do të japë shembuj të qëllimeve të punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët. Gjithashtu, gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të nxiten të përpilojnë qëllime të punës në situata të ndryshme. Në këtë sesion do të përshkruhen praktika të punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët.



Pjesëmarrësve do t'u jepet mundësia të aplikojnë njohuritë e mara në një diskutim në grup mbi shembuj ilustrues të praktikës së punës në grup që gjenden në literaturën e këtij sesioni dhe shembuj që ata i sjellin nga praktika. Pjesëmarrësve do t'u kërkohet të identifikojnë mënyra të integritit të njohurive të mara në mjedisin ku punojnë.

### Shtjellimi i modulit:

1. Trajneri/ja e hap sesionin 1 duke shpjeguar rëndësinë e njohjes së parimeve filozofike, vlerave, njohurive dhe aftësive që duhet të kenë punonjësit e institucioneve penitenciare.
2. Në vijim, trajneri/ja shpjegon dhe analizon perspektivat e punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët.
3. Pjesëmarrësit punojnë në grupe duke analizuar perspektivat e ndërhyrjes për rastin 1.
4. Në fillim të sesionit 2 trajneri/ja shpjegon qëllimet e punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët dhe nxit pjesëmarrësit në punën në grupe që të zhvillojnë qëllime të punës me grupe të veçanta (Punë në grupe lidhur me rastin 1 për analizën e rezultateve të punës në grup).
5. Shpjegohen nga trajneri baza teorike të praktikës së punës në grup me fëmijët dhe adoleshentët.
6. U kërkohet pjesëmarrësve të analizojnë në kontekstin tonë shembuj ilustrues të praktikës së punës në grup.

Mjetet: Prezantim në PP; rasti 1 në kopje për t'u shpërndarë, diskutime për rastin 2.

## *Sesioni 1*

### *Parimet filozofike të punës në grup me fëmijët dhe vlerat që duhen respektuar në punën me fëmijët*

#### **Parimet filozofike të punës në grup me fëmijët**

Parimet e mbrojtjes së fëmijëve përbëjnë bazën filozofike për ngritjen e shërbimeve të mbrojtjes dhe përcaktojnë qëllimin e punës të çdo profesionisti. Parimet e punës me fëmijët gjenden në Ligjin “Për Mbrojtjen e Fëmijëve”<sup>18</sup> si dhe në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët<sup>19</sup>. Parimet për punën me fëmijët janë:

**1. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve bëhet duke garantuar Interesin më të lartë të fëmijës, si konsideratë mbizotëruese, në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat dhe autoritetet administrative ose legjislativë.**

“Të kuptuarit dhe të zbatuarit e parimit të interesit më të lartë të fëmijëve është kryesisht detyrë e prindërve sepse, në jetën e përditshme, janë ata aktorët/faktorët kryesorë në përmbushjen e detyrimeve në raport me fëmijët dhe në realizimin me përkushtim të të drejtave të fëmijëve. Asnjë

<sup>18</sup>Ligji “Për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës”, Nr. 10 347, datë 4.11.2010, miratuar nga Kuvendi i RSH

<sup>19</sup> VKM “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët 2005-2010” Nr. 368, dt. 31.05.2005

autoritet nuk mund të zëvendësojë prindërit në këtë çështje”<sup>20</sup>. Nëse fëmija ndodhet në një institucion paraburgimi, burgimi apo edukimi, detyrimin për respektimin e këtij parimi e kanë të gjithë punonjësit e këtyre institucioneve duke filluar që nga drejtuesit deri te punonjësit e seksioneve në kontakt me fëmijët. Prindërit apo kujdestarët e fëmijës duhen të përfshihen sa më shumë që të jetë e mundur në vendimmarrje dhe në trajtim në kushtet e reja të krijuara. Edhe fëmijët duhet të kenë ndikimin e tyre në të gjitha vendimmarrjet, duke u pyetur dhe dëgjuar në vendimet administrative që ndikojnë në jetën e tyre siç janë përfshirja në arsim brenda institucionit, zgjedhja e shokëve të dhomës apo çdo zgjedhje tjetër.

**2. Barazia dhe asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, aftësia e kufizuar, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij.**

Institucionet penitenciare si dhe punonjësit e tyre duhet të jenë të përgjegjshëm për dallimet dhe t'i respektojnë ato. Punonjësit e këtyre institucioneve duhet të punojnë duke u bazuar mbi potencialet dhe faktorët mbrojtës që ekzistojnë brenda çdo familjeje dhe komuniteti.

**3. Eliminimi i të gjithave formave të diskriminimit ose ndëshkimit të fëmijës për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinionëve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.**

Institucionet penitenciare zbatojnë vendimet e gjykatës. Është e drejta e këtyre shërbimeve që të veprojnë në përputhje me ligjin dhe vendimin e gjykatës. Në rastet kur fëmija është diskriminuar apo ndëshkuar, çdo punonjës i këtyre institucioneve duhet t'i drejtohet eprorit dhe institucioneve përkatëse.

**4. Respektimi i përgjegjësive, të drejtave dhe detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë ndaj fëmijës.**

Çdo fëmijë ka të drejtë të rritet nën kujdesin e prindërve, në mjedis familjar dhe të sigurt, si dhe të mos i nënshtrohet abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Plotësimi i nevojave fizike, mendore, emocionale, arsimore dhe mjekësore të fëmijëve është përgjegjësi e prindërve. Në rastet kur fëmijët kryejnë vepra penale, institucionet penitenciare zhvillojnë të gjitha veprimet ndaj fëmijëve duke respektuar përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat e prindërve apo përfaqësuesve ligjorë ndaj fëmijës.

**5. Krijimi i kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim.**

Është përgjegjësi e institucioneve penitenciare të sigurojnë kushte maksimale për mbijetesë maksimale dhe zhvillim. Këto institucione kanë detyrimin t'i sigurojnë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në Ligjin “Për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës”. Institucionet penitenciare kanë të drejtë t'u kërkojnë autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar për mirërritjen, edukimin, arsimimin dhe përfaqësimin ligjor të

---

<sup>20</sup>Mandro. A, “Parimi i interesit më të lartë të fëmijës-rëndësia dhe sfidat e zbatimit të tij” Revista Jeta Juridike, 2008.

fëmijës. Ato duhet t'i inkurajojnë prindërit dhe fëmijët të marrin pjesë në vlerësimin e rastit, planifikimin e ndërhyrjes apo trajtimit si dhe në çdo vendim tjetër të rëndësishëm.

## **6. Parimi i respektimit të mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.**

E drejta e çdo fëmije për t'u dëgjuar sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve është një e drejtë që duhet të respektohet në çdo procedurë. E drejta e respektimit të mendimit të fëmijës lidhet me të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në procedurat administrative dhe ato gjyqësore. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar duhet të jetë në balancë me moshën dhe me aftësinë e tij për të kuptuar atë që po ndodh dhe atë që do të vendoset, në mënyrë që ai të japë pëlqimin ose mospëlqimin e tij.

### **Perspektivat teorike**

Kjo pjesë shpjegon sesi prakticienët i aplikojnë parimet filozofike të mësipërme në praktikë. Studiuesit e çështjeve të fëmijëve bien dakord që një qasje teorike e orientuar nga vendosja e fëmijës në qendër, e cila merr në konsideratë familjen dhe kulturën e vendit, është më e përshtatshme për të arritur rezultatet më të mira për fëmijën. Kjo qasje e integruar bazohet në pesë perspektiva teorike: perspektiva ekologjike; perspektiva e bazuar tek potencialet; perspektiva e zhvillimit; orientimi i planifikuar i vendosjes së qëndrueshme; perspektiva e kompetencave kulturore.

**Perspektiva ekologjike** Kjo perspektivë e koncepton sjelljen njerëzore dhe funksionimin social brenda një konteksti mjedisor. Faktorët personalë, faktorët familjarë dhe faktorët e mjedisit ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe e ndikojnë familjen. Përfshirja e fëmijëve në kryerjen e veprave penale shihet nga kjo perspektivë si pasojë e “lojës” së një grupi faktorësh risku dhe mbrojtjeje të cilët veprojnë në nivel individual, familjar, komunitar dhe shoqëror.

**Perspektiva e bazuar tek potencialet** Kjo perspektivë i referohet metodologjive dhe strategjive që ndërtohen bazuar në potencialet apo pikat e forta të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve. Praktika e bazuar në këtë perspektivë lëviz nga një qasje teorike që tenton të theksojë problemet dhe patologjinë tek një qasje tjetër që i jep rëndësi partneritetit pozitiv me fëmijën dhe familjen. Vlerësimet që bëhen bazuar në këtë perspektivë fokusohen në ndërveprimin e risqeve dhe potencialeve të çdo individi në familje, të familjes si një njësi e tërë dhe, më gjerë, të komunitetit dhe mjedisit.

**Perspektiva e zhvillimit** Kjo perspektivë i referohet rritjes dhe zhvillimit individual nga perspektiva e jetës njerëzore dhe i vlerëson individët në ndërveprim me mjedisin rreth tyre gjatë gjithë ciklit të jetës. Planifikimi efektiv i rastit kërkon marrjen në konsideratë të atyre ndërhyrjeve tek një fëmijë që janë efektive në një mjedis specifik dhe në një fazë specifike të zhvillimit.

**Orientimi i planifikuar i vendosjes së qëndrueshme** Kjo perspektivë teorike ka në qendër të saj paradigmen që të gjithë fëmijët kanë të drejtën për të pasur një “shtëpi” në mënyrë të qëndrueshme. Institucionet penitenciare duhet të fokusohen në krijimin e kushteve të sigurta për fëmijët në këto institucione në një mënyrë të qëndrueshme, pa lëvizje të shpeshta dhe të panevojshme. Ndërhyrjet duhet të përfshijnë një grup aktivitete të orientuara drejt qëllimit për të ndihmuar fëmijët të

jetojnë të sigurt në këto institucione, në mjedise miqësore për fëmijët të cilat u ofrojnë një ndjenjë përkatësie dhe lidhje të qëndrueshme.

**Perspektiva e kompetencave kulturore** Kjo perspektivë kërkon që punonjësit e institucioneve penitenciare të kuptojnë fëmijët që vijnë nga kultura të ndryshme dhe të përshtatin praktikën e tyre. Kompetenca kulturore arrihet kur institucionet dhe punonjësit e tyre i pranojnë dhe i respektojnë dallimet kulturore, përfshihen në vetëvlerësime në lidhje me marrëdhënien e tyre me kultura të ndryshme dhe i zgjerojnë njohuritë dhe shprehjet e tyre për të punuar me grupe që vijnë nga kultura, situata dhe nevoja të ndryshme.

### **Rast 1**

*Fëmija N.K. është duke vuajtur dënimin me 4 vjet burgim në Institucionin e Edukimit në Kavajë. Ai u përfshi në një grindje me shokët e dhomës për programin që duhej të ndiqnin në televizor dhe grindja përfundoi me 3 djem të lënduar fizikisht, përfshirë edhe fëmijën N. Fëmijëve iu dha ndihma e shpejtë dhe pastaj u dëgjuan nga komisioni disiplinor. Fëmija N. tha që punonjësi i sigurisë kishte qenë i pranishëm në ngjarje dhe nuk i kishte ndihmuar ta zgjidhnin konfliktin para se të grindeshin. Ai tha se ata edhe më parë ishin zënë për televizorin dhe asnjë nuk kishte ndërhyrë. Televizori qëndronte i hapur gjatë gjithë kohës dhe nuk kishte asnjë rregull. Ai gjithashtu tha se i kishte thënë punonjëses së edukimit që “nuk përmbahej dot kur e kundërshtonin” dhe ajo nuk e kishte ndihmuar. Komisioni i disiplinimit vendosi që fëmija N. të dënohej me veçim. Prindërit erdhën pas 2 ditësh për ta vizituar dhe u habitën kur u vunë në dijeni se fëmija i tyre ishte në veçim.*

**Punë në grupe:** Shpjegoni rastin sipas perspektivave të mësipërme teorike dhe projektioni ndërhyrjen e mundshme në nivelin e fëmijës bazuar në secilën perspektivë. Ndahen pjesëmarrësit në pesë grupe.

**Punonjësit e institucioneve penitenciare.** Punonjësit e këtyre institucioneve janë faktorët më të rëndësishëm në arritjen e qëllimeve që lidhen me fëmijët. Ata ndajnë së bashku **vlera, njohuri dhe shprehi** që krijohen nëpërmjet arsimimit, trajnimeve, eksperiencës dhe supervizimit.

### **Vlerat bazë të punonjësve të institucioneve penitenciare që punojnë me fëmijët:**

#### **Besim që:**

- Të gjithë njerëzit kanë një rezervuar të madh aftësish (mendore, fizike, emocionale, sociale dhe shpirtërore) që mund të përdoren për të lehtësuar ndryshimin.
- Çdo fëmijë ka të drejtë për një vendosje të qëndrueshme.
- Çdo fëmijë duhet të fuqizohet që të punojë për të plotësuar nevojat dhe arritur qëllimet e tij/saj.

#### **Përkushtim ndaj:**

- Përdorimit të një praktike të bazuar tek potencialet, me fëmijën në qendër dhe të fokusuar te rikthimi në familje.

- Krijimit të ndjenjës së sigurisë së fëmijës në kontekstin e institucionit.
- Ushtrimin të konfidencialitetit të plotë

#### **Respekt për:**

- Individët me prejardhje të ndryshme raciale, fetare, etnike, kulturore dhe besim se fuqia është te ndryshimi.
- Dinjitetin e çdo individi, individualitetin e tij dhe të drejtën për vetëvendosje

#### **Njohuritë bazë të punonjësve të institucioneve penitenciare:**

##### **Të kuptuarit e:**

- Rëndësisë së sistemit familjar, mjedisit familjar, familjes në një kontekst historik, strukturave të ndryshme të familjes dhe koncepteve të fuqizimit të familjes.
- Rritjes dhe zhvillimit individual me vëmendje të veçantë ndaj atashimit dhe kufijve, ndarjes, humbjes dhe zhvillimit të identitetit.
- Abuzimit të fëmijëve në institucione.
- Diversitetit kulturor, karakteristikave të popullatave të veçanta dhe implikimeve që ato sjellin në procesin e vlerësimit dhe të ndërhyrjes.
- Vazhdimësisë së shërbimeve duke përfshirë sistemin e kujdestarisë, sistemin e kujdesit rezidencial, mbajtjen e lidhjeve familjare dhe rikthimin në familje dhe komunitet.
- Shërbimeve ku përfshihen zgjidhja e konflikteve dhe këshillimi individual apo në grup.

##### **Njohuri mbi:**

- Çështjet e menaxhimit të rastit dhe përgjegjësi
- Programet dhe modelet për mirëqenien e fëmijës
- Parimin e planifikimit të qëndrueshëm për fëmijët dhe rolin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

##### **Familjaritet me:**

- Problemet e veçanta të varfërisë, shtypjes dhe mohimit.
- Çështje të abuzimit me substancat dhe pasojat e tyre te fëmijët.
- Dinamikat e dhunës në familje dhe në komunitet, përfshirë pasojën e traumës.
- Shërbimet për fëmijët lidhur me shëndetin mendor, kujdesin shëndetësor, abuzimin me substancat, arsimin dhe sistemet komunitare.

- Shërbime të tjera për fëmijët dhe familjet që lidhen me aspektin ekonomik, strehimin, transportin dhe kualifikimin profesional.
- Aspektet ligjore që lidhen me praktikën për mirëqenien e fëmijës.
- Proceset politike dhe advokuese dhe mënyrën me të cilën ato lidhen me financimin dhe sigurimin e shërbimeve.

### **Aftësitë bazë të punonjësve të institucioneve penitenciare:**

#### **Aftësi për të:**

- Evidentuar pikat e forta dhe nevojat si dhe për përfshirjen e familjes në një proces vlerësimi të bazuar te potencialet.
- Ndërmarrë veprime të përshtatshme dhe të shpejta kur një fëmijë ka nevojë për mbrojtje apo trajtim të veçantë.
- Analizuar informacionin kompleks.
- Përdorur shërbimet dhe strategjitë e ndërhyrjes gjatë krizës dhe ndërhyrjes parandaluese.
- Vlerësuar gatishmërinë e fëmijës për të ndryshuar dhe përdorur strategjitë e duhura për rritjen e motivimit dhe ngritjen e një marrëdhënieje ndihmuese me familjen.
- Funkcionuar si një menaxher rasti por edhe si një anëtar skuadre, duke bashkëpunuar me shërbimet e tjera.
- Aksesuar shërbime për abuzimin me substancat, dhunën në familje, abuzimin seksual dhe problemet e shëndetit mendor.

#### **Gatishmëri për të:**

- Zhvilluar dhe mbajtur marrëdhënie profesionale me fëmijët dhe familjet.
- Dëgjuar.
- Qenë fleksibël.
- Punuar me klientë që nuk kanë vullnet për të bashkëpunuar, përfshirë klientët armiqësorë apo rezistentë.
- Punuar me sistemet ligjore, përfshirë dokumentimin dhe dëshmitë në gjykatë.
- Fuqizuar fëmijën dhe familjen në konservimin e asaj që fëmija ka arritur gjatë trajtimit dhe përdorimin e mbështetjes brenda familjes dhe asaj të komunitetit.

#### **Ekspertizë në:**

- Vlerësimin për abuzim dhe për sigurinë e fëmijës.
- Negocimin, zbatimin dhe vlerësimin e planit të rastit me fëmijën.

- Punën me familjen dhe aktorët e tjerë mbështetës për të arritur qëllimet e institucioneve penitenciare
- Aplikimin e njohurive për sjelljen njerëzore dhe metodat e ndërhyrjeve të suksesshme me fëmijët dhe adoleshentët në faza të ndryshme të zhvillimit

### **Çështjet etike dhe dilemat në praktikën e institucioneve penitenciare**

1. **Përkushtimi për fëmijët** Përgjegjësia parësore e çdo punonjësi është të kujdeset për sigurinë e fëmijës, qëndrueshmërinë e fëmijës, mirëqenien e fëmijës.
2. **Vetëvendosja** Punonjësit e institucioneve penitenciare respektojnë dhe promovojnë të drejtën e fëmijëve për vetëvendosje dhe i ndihmojnë fëmijët të identifikojnë qëllimet e tyre.
3. **Pranimi i informuar** Punonjësit e institucioneve penitenciare duhet të ofrojnë shërbime për fëmijët vetëm brenda një marrëdhënieje profesionale, bazuar, sipas rastit, në një pranim të informuar. Në rastet kur fëmijët marrin trajtim jo të vullnetshëm, punonjësit duhet të sigurojnë informacion për natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve si dhe për të drejtën e fëmijës/prindit/kujdestarit ligjor për të refuzuar shërbimet.
4. **Aftësitë** Punonjësit e institucioneve penitenciare duhet të ofrojnë shërbime dhe ta prezantojnë veten si ekspertë vetëm brenda kufijve të arsimimit të tyre, të trajnimeve, licencave apo certifikimit.
5. **Kompetencat kulturore dhe diversiteti social** Punonjësit e institucioneve penitenciare duhet të kuptojnë kulturën dhe ndikimin e saj në sjelljen njerëzore duke vlerësuar pikat e forta në të gjitha kulturat.
6. **Konflikti i interesit** Punonjësit e institucioneve penitenciare duhet të jenë vigjilentë dhe të shmangin çdo lloj konflikti interesi që mund të ndërhyjë në ushtrimin e diskrecionit profesional dhe gjykimit të paanshëm.
7. **Privatësia dhe konfidencialiteti** Punonjësit e institucioneve penitenciare duhet të respektojnë të drejtën e fëmijës për privatësi. Ata nuk duhet të nxjerrin informacion nga familja/përfaqësuesi ligjor/kujdestari ligjor nëse nuk është i rëndësishëm për sigurinë e fëmijës, për t'i dhënë fëmijës shërbimet e duhura ose për të arritur qëndrueshmërinë e fëmijës. Punonjësit mund të japin informacion me pranimin e prindit ose të kujdestarit ligjor. Punonjësit duhet të diskutojnë me prindërit dhe palët e tjera të interesuara për natyrën e konfidencialitetit si dhe kufijtë dhe të drejtat për konfidencialitet. Punonjësit duhet ta mbrojnë konfidencialitetin e informacionit përveçse në rastet kur ndarja e informacionit shërben për të parandaluar dëmtime të rënda të fëmijës.
8. **Aksesi ndaj shënimeve** Punonjësit duhet t'u sigurojnë fëmijëve/prindërve/kujdestarëve ligjorë akses të arsyeshëm të shënimeve të tyre. Punonjësit duhet të kufizojnë aksesin e palëve të përmendura të shënimeve të tyre nëse kanë fakte që ky akses do të dëmtojte fëmijën ose familjen.
9. **Marrëdhëniet seksuale dhe ngacmimet seksuale** Punonjësit e institucioneve penitenciare nuk duhet të përfshihen në marrëdhënie seksuale ose kontakte seksuale me të afërm të fëmijëve apo me të tjerë njerëz me të cilët fëmijët kanë marrëdhënie të ngushta.

10. **Kontakti fizik** Punonjësit e institucioneve penitenciare nuk duhet të përfshihen në kontakte fizike me fëmijët apo prindërit e tyre nëse ka rrezik të ndonjë lëndimi psikologjik.
11. **Gjuha e punës** Punonjësit e institucioneve penitenciare nuk duhet të përdorin kurrë gjuhë vulgare në komunikimin e tyre verbal ose të shkruar me fëmijët, prindërit apo kujdestarët ligjorë. Gjuha duhet të jetë e respektueshme, e ndjeshme, në komunikimin me fëmijët dhe familjet e tyre.
12. **Fëmijët që kanë aftësi të kufizuar** Në këto raste punonjësit duhet të tregohen të kujdesshëm që të hedhin hapa të arsyeshëm për të mbrojtur interesat e këtyre fëmijëve.
13. **Përfundimi i shërbimeve** Punonjësit e institucioneve penitenciare duhet t'i përfundojnë shërbimet kur fëmija të jetë larguar nga institucioni.

## Rast 2

*Fëmija L.H. është një fëmijë nga Komuniteti Rom. Atij i kanë ardhur në vizitë në institucionin e paraburgimit prindërit e tij. Punonjësi i shërbimit u kërkon që të mos flasim në gjuhën romë sepse ai nuk kupton se çfarë janë duke folur.*

**Diskutim në grup:** Me cilin parim etik lidhet më shumë rasti? Çfarë duhet bërë në këtë rast?

## Sesioni 2

### *Praktika e punës në grup me fëmijët, qëllimet e punës dhe shembuj ilustrues*

Studiuesit kanë pranuar se, për të qenë të suksesshëm, programet për të dënuarit e mitur duhet të kenë disa elementë të përbashkët<sup>21</sup>:

1. Të kenë një kuadër të qartë teorik që mbështetet në mënyrë empirike.
2. Të përfshijnë vlerësimin e nivelit të rrezikut të recidivizmit dhe shpërndarjen përkatëse në nivelet e shërbimit.
3. Të synojnë faktorët dinamikë të rrezikut (nevojat kriminogjene).
4. Të marrin në konsideratë reagimin dhe të zbatojnë një ndërhyrje të strukturuar duke përdorur një metodë më të drejtpërdrejtë në përputhje me mënyrën e të mësuarit të individëve të përfshirë në program.
5. Të jenë multimodele, të orientuar drejt aftësive dhe të bazuar në një sjellje njohëse.
6. Të jenë me bazë në komunitet.
7. Të kenë integritet të lartë në mënyrën e trajtimit.

Chapman dhe Hough<sup>22</sup> (1998) e shohin punën në grup të përshtatshme për:

- Marrjen e roleve dhe sjelljeve
- Mësimin nga të tjerët
- Trajnimin për aftësitë njohëse dhe sociale
- Reflektimin për çështjet dhe vështirësitë e përbashkëta

<sup>21</sup>Manual për Punonjësin e Shërbimit të provës, 2009, OSCE, fq. 145

<sup>22</sup>Po aty, fq 145



Kushti paraprak i çdo programi apo pune në grup është vendosja e një qëllimi. Ky qëllim nuk mund të arrihet pa pasur parasysh parimin e reagimit, parimin e nevojës dhe parimin e rrezikut. Gjithashtu, përpara vendosjes së fëmijës në një program grupi, duhet bërë analiza “personi i duhur-programi i duhur-koha e duhur”.

**Parimi i reagimit** lidhet me mënyrën e ndërhyrjes. Studimet tregojnë se individët me nivel jo të lartë rreziku për recidivizëm reagojnë më mirë kur metodat janë aktive dhe përfshirëse dhe jo kur janë të pastrukturuara apo shumë didaktike. Parimi i reagimit lidhet edhe me përshtatshmërinë e individit me programin si dhe me bashkëpunimin e fëmijës.

**Parimi i nevojës** lidhet me analizën e nevojës kriminogjene dhe faktorët personalë apo mjedisorë që lidhen me kryerjen e veprës penale. p.sh. abuzimi me drogën/alkoolin, zemërimi i pakontrolluar, aftësi të dobëta për të zgjidhur problemet etj. Niveli i nevojës në këto fusha duhet të drejtojë zgjedhjen ose moszgjedhjen e tyre në një lloj të caktuar ndërhyrjeje.

**Parimi i rrezikut** lidhet me vlerësimin e rrezikshmërisë që përbën fëmija në lidhje me recidivizmin. Ndërhyrja duhet të jetë bazuar sipas këtij niveli, nëse ndërhyrja është më intensive se ç’duhet ka studime që tregojnë se rreziku mund të rritet.

Puna me fëmijët është sfiduese dhe ka disa faktorë që përcaktojnë suksesin e punës me ta. Ata janë: përdorimi i duhur i autoritetit efektiv, modelimi i duhur, zgjidhja e problemeve dhe marrëdhënia e hapur.

Trotter (1999) studioi elementët e modelimit të duhur sipas një modeli prosocial dhe tha se ky modelim përfshinte parime dhe praktika të tilla si:

- Identifikimi i komenteve pozitive (prosociale) dhe sjelljeve (prosociale) të fëmijët
- Shpërblimi i këtyre komenteve dhe sjelljeve sa më shpesh, kryesisht në formën e lavdërimit.
- Paraqitja e vetes si një model prosocial
- Sfida ndaj komenteve apo sjelljeve prokriminale apo antisociale

Programet e trajtimit Konjitiv dhe të Sjelljes të fëmijëve duhet të fokusohen te Mendimet, Ndjenjat dhe Sjellja. Këto programe përdoren për të ndryshuar mendimet e gabuara morale, për të analizuar ndjenjat që shoqërojnë sjelljet e caktuara si dhe për ndryshimin e sjelljeve.

Programet e trajtimit të bazuara në “Paradigmën e Ndërprerjes” fokusohen në procesin e ndërprerjes dhe nuk konsiderohen si praktika korigjuese. Në rastet kur fëmija ka gjëra me vlerë për të fituar, pra jeta e tij ndryshon në mënyrë domethënëse, ai e ndërpret veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjin. Studiuesit kanë vërejtur se identiteti dhe imazhi për veten janë shumë të rëndësishëm për fëmijën. Nëse ai e sheh veten si një individ që është në dorë të forcave të jashtme dhe si të paaftë për ta përballuar jetën, ka shumë mundësi të përfshihet përsëri në karrierë kriminale. Në të kundërt, nëse fëmija e sheh veten si një njeri që mund ta ndryshojë jetën e vet, rriten mundësitë që ky fëmijë të mos i dorëzohet përsëri krimit. Studiuesit theksojnë se në punën me fëmijët duhen vënë në pah faktorët që lidhen me heqjen dorë nga krimi dhe jo faktorët që lidhen me krimin.

## **Marrëdhënia me punonjësit e programeve**

Ky është një faktor sukse si i padiskutueshëm që po studiohet gjithmonë e më shumë. Studimet tregojnë se ekzistenca e një marrëdhënieje të ngrohtë, krijimi i aleancës me fëmijën në kuadër terapeutik apo në kuadër studimi dhe zbatimi i një qasjeje bashkëpunuese janë thelbësore në suksesin me fëmijët.

### ***Diskutim në grup:***

*Si do t'i vlerësonit fëmijët që kanë mungesë aftësish për të menduar në një situatë presioni, perspektivë jo të mirë dhe vetëkontroll jo të mjaftueshëm? Si do t'i ndihmonit të përftonin këto aftësi? Me çfarë programi?*

## **Vendosja e qëllimeve të punës në grup**

Vendosja e qëllimit të punës në grup varet nga grupi specifik dhe nga përmbajtja e programit. Qëllimi është i përbashkët për të gjithë anëtarët e grupit ndërsa objektivat mund të jenë të ndryshme për fëmijë të veçantë.

### **Qëllimi i përbashkët i çdo programi për fëmijët në institucionet penitenciare është:**

- Të mbështesë dhe zhvillojë kapitalin individual dhe social të fëmijës duke mbështetur pikat e tij të forta, duke adresuar nevojat e tij dhe faktorët e rrezikut si dhe duke ndihmuar në plotësimin e nevojave të tij imediate.
- Të promovojë dhe mbështesë sigurinë, zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës.
- Të mbështesë familjen dhe komunitetin më të gjerë për të ndihmuar fëmijën në riintegrim dhe në qëndrimin larg krimit.

Programe të ndryshme kanë formate të ndryshme të cilat, me gjithë ndryshimet, përfshijnë disa çështje të përbashkëta: nevojat e paplotësuara të fëmijës që lidhen me ndërprerjen; sjelljet, qëndrimet apo faktorët e rrezikut; veprimet që duhet të ndërmerren për të ndryshuar; afati i kryerjes së këtyre veprimeve; ofruesit e shërbimeve për fëmijën; treguesit e progresit dhe veprimet monitoruese të nevojshme. Në figurën e mëposhtme jepet një model:

**Programi.....**

Periudha Nga:

Deri në:

Qëllimi i Programit është:

Nevoja e paplotësuar	Faktori i rrezikut	Veprimi	Afati i fundit	Ofruesit e shërbimit

Data e takimit të rishqyrtimit për monitorimin e rezultateve:

Ndërhyrjet që përcaktohen në program kanë elementë që lidhen dhe ndërvaren por, për nga prioriteti, ato mund të renditen si më poshtë:

- Veprime që synojnë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin penitenciar
- Veprime që promovojnë shëndetin e fëmijës dhe zhvillimin e tij në mjedisin penitenciar
- Veprime për të lehtësuar dhe ndihmuar marrëdhënien e fëmijës me familjen
- Programe edukimi/rehabilitimi/trajtimi për fëmijën
- Programe për prindërit

Planifikimi efektiv lidhet me përcaktimin e rezultateve të qarta që duhet të arrihen nga profesionistët dhe fëmija/familja. Rezultatet përbëjnë qëllimin final. Sa më të qarta të jenë rezultatet e dëshiruara aq më të qartë janë aktorët e përfshirë në zbatimin e planit për qëllimin dhe objektivat për t'u arritur. P.sh. “të mbrohet fëmija nga përfshirja në krim në të ardhmen” është një rezultat i paqartë që nuk jep informacion as për nevojat dhe as për shërbimet dhe veprimet e duhura për të arritur mospërfshirjen e fëmijës në krim. Punonjësi i institucionit penitenciar dhe fëmija hartojnë së bashku tregues afatshkurtër dhe afatgjatë që ndihmojnë për një vlerësim efektiv të ndërhyrjeve dhe të ecurisë drejt qëllimit bazuar në fakte. Ky vlerësim bëhet rregullisht në takimet për rishikimin e planit. Në një plan për arritjen e qëllimit përcaktohen rezultatet e dëshiruara, qëllimi, detyrat për fëmijën/familjen dhe aktorët e tjerë si dhe koha e realizimit të çdo detyre.

Përcaktimi i rezultatit, qëllimit dhe detyrave është i nevojshëm në planifikimin për të ulur rrezikshmërinë për përfshirjen e fëmijës në krim në të ardhmen.

## **Rezultatet e dëshiruara u përkasin disa niveleve:**

- Rezultatet në nivel fëmije
- Rezultatet në nivel familjeje
- Rezultatet në nivel mjedisi

**Rezultatet në nivel fëmije** fokusohen te sjellja, zhvillimi, shëndeti mendor, shëndeti fizik, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët dhe arsimi. Rezultatet e dëshiruara në lidhje me sjelljen janë p.sh. përmirësimi i kontrollit ndaj sjelljes (p.sh. menaxhimi i zemërimit) ose përmirësimi i nivelit të shkrimit, leximit dhe matematikës.

**Rezultatet në nivel familjeje** fokusohen në çështje të tilla si rolet dhe kufijtë, komunikimi në familje dhe mbështetja sociale. Një rezultat i dëshiruar në këtë nivel është përmirësimi i komunikimit apo mbikëqyrjes së fëmijës pas daljes nga institucioni.

**Rezultatet në nivel mjedisi** fokusohen në faktorët mjedisorë që ndikojnë te përfshirja e fëmijës në krim si p.sh. çështje të strehimit ose të sigurisë në komunitet. Një rezultat i tillë është përdorimi i mbështetjes sociale (që evidentohet nëse një fëmijë pranohet nga një institucion që ofron kualifikim profesional dhe aktivitete sportive për fëmijët).

**Punë në grupe:** Referojuni rastit 1 dhe kuptoni punën që bëhet për matjen dhe vlerësimin e ndryshimeve në nivel fëmije, familjeje dhe mjedisi. Identifikoni rezultatet në nivel fëmije, në nivel familjeje dhe në nivel mjedisi dhe treguesit e mundshëm të këtyre rezultateve.

*Sjelljet dhe kushtet që kontribuonin si faktorë rreziku në rastin 1 ishin:*

- *Kontrolli i pakët i zemërimit i fëmijës*
- *Mungesa e strukturës, rregullave*
- *Mungesa e ndërhyrjes parandaluese*
- *Disiplinimi jo i përshtatshëm dhe jo i vazhdueshëm*
- *Sjellja agresive dhe e rrezikshme e fëmijës*
- *Mosnjoftimi i prindërve*

### ***Përgjigja e ushtrimit:***

*Rezultatet në nivelin e mjedisit do të ishin vendosja e strukturës dhe rregullave në institucion, dhënia e precedencës për ndërhyrjet parandaluese dhe promovimi i ndërhyrjes së punonjësve për të zgjidhur problemet midis fëmijëve.*

*Rezultatet në nivelin e familjes përfshijnë përmirësimin e komunikimit me familjet e fëmijëve.*

*Rezultatet në nivelin e fëmijës përfshijnë përmirësimin e kontrollit të sjelljes në përputhje me moshën.*

## **MODULI 3**

### **PUNA INDIVIDUALE - TEKNIKA DHE METODA TË PUNËS ME FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN**

#### **PËRMBAJTJA**

3.1 Procesi i këshillimit

3.2 Identifikimi i pikave të forta dhe mbështetja te pikat e forta në punën me fëmijët

3.3 Puna drejt zgjidhjes së mospërputhjeve dhe mesazheve mikse

#### Objektivat:

- Të njohim proceset e rëndësishme në këshillimin e fëmijëve
- Të njohim dhe kuptojmë rëndësinë e empatisë në punën me fëmijët dhe adoleshentët
- Të njohim qëllimin e inkurajimit në punën me fëmijët si dhe disa teknika të këshillimit inkurajues.
- Të njohim qëllimin e identifikimit të pikave të forta në punën me fëmijët si dhe disa teknika.
- Të njohim qëllimin e përballjes dhe dhënies së direktivave si dhe disa teknika për t'i përdorur.

#### Rezultatet e pritura:

- Të identifikojmë fazat e procesit të këshillimit të fëmijëve.
- Të evidentojmë rëndësinë e empatisë në punën me fëmijët dhe adoleshentët dhe të aftësohemi ta aplikojmë në praktikë.
- Të evidentojmë rëndësinë e inkurajimit në punën me fëmijët dhe të aftësohemi ta aplikojmë në raste specifike.
- Të evidentojmë rëndësinë e identifikimit të pikave të forta në punën me fëmijët dhe të njohim disa teknika.
- Të evidentojmë qëllimin e përdorimit të përballjes dhe dhënies së direktivave dhe të njohim disa teknika.

Metodologjia : Prezantim në PP, ushtrime, diskutime në grup.

#### Përshkrimi i modulit

Ky modul do t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri për procesin e këshillimit të fëmijëve. Në këtë modul do të theksohet rëndësia e përdorimit të empatisë në punën me fëmijët dhe do të jepen disa teknika të punës si dhe do të nxiten pjesëmarrësit që t'i aplikojnë këto teknika. Gjithashtu, në këtë modul do të përshkruhet rëndësia e përdorimit të inkurajimit dhe identifikimit të pikave të forta të fëmijëve dhe do të krijohet mundësia që pjesëmarrësit t'i aplikojnë këto teknika. Në punën me fëmijët është e nevojshme shpeshherë që të përdoret përballja dhe dhënia e direktivave dhe, në këtë modul, do të jepet informacion për këto procese dhe teknikat për t'i aplikuar ato.

### Shtjellimi i modulit:

1. Trajneri/ja e hap seancën duke shpjeguar proceset e rëndësishme në këshillimin e fëmijëve.
2. Shpjegohet empatia dhe rëndësia e saj në punën me fëmijët dhe adoleshentët dhe bëhen ushtrimet e sugjeruara në tekst.
3. Shpjegohet inkurajimi dhe rëndësia e tij në punën me fëmijët dhe bëhen ushtrime për aplikimin e teknikave të këshillimit inkurajues.
4. Shpjegohet procesi i identifikimit të pikave të forta në punën me fëmijët dhe bëhen ushtrime.
5. Shpjegohet përdorimi i përballjes dhe dhënies së direktivave dhe bëhen ushtrime për aplikimin e teknikave.

Mjetet: Prezantim në PP; material për t'u shpërndarë.

### **Procesi i këshillimit**

Gjatë punës me fëmijët ne kemi mundësi të ndikojmë në jetën e tyre, të nxisim zhvillimin e tyre apo të pengojmë rritjen e tyre, në varësi të njohurive dhe aftësive që kemi për të punuar me këtë kategori. Ky modul nuk synon të shtjellojë gjithë procesin e këshillimit por ta trajtojë këshillimin si një proces që ndodh në institucionet penitenciare dhe që mund të kryhet gjatë gjithë ditës, jo vetëm nga figura profesionale të tilla si psikologët apo punonjësit socialë, por edhe nga punonjësit e tjerë të edukimit, punonjësit e sigurisë, mësuesit etj.

Qëllimi kryesor i këshillimit është zhvillimi i fëmijës duke njohur dhe pranuar faktin që fëmijët kanë mundësi dhe aftësi të pafundme për t'u rritur dhe për të ndryshuar. Në procesin e këshillimit është shumë e rëndësishme marrëdhënia ndihmëse që krijohet midis fëmijës dhe punonjësit të institucionit penitenciar. Në të vërtetë, studimet kanë treguar se vetëm 15% e suksesit të programeve të ndryshme në ndihmë të të dënuarve i detyrohet përmbajtjes së programit; pjesa tjetër i atribuohet profesionalizmit dhe cilësive të veçanta të drejtuesit të programit në marrëdhënie me të dënuarit si dhe cilësive të veçanta të procesit si: tërheqja, interesi, realizmi, sfida, stimulimi dhe kënaqësia.

Qëllimi i këshillimit është identifikimi i disa përgjigjeve potenciale që mund të jenë të dobishme për fëmijën dhe arritja e mbështetjes/ndryshimit duke e nxitur fëmijën të përballojë problemin/situatën.

Në këtë manual nuk do të fokusohemi te teoritë e këshillimit sepse ato janë shumë (rreth 400) por në faza shumë të rëndësishme të këshillimit dhe në shprehitë që na ndihmojnë në punën me fëmijët.

### **Fazat e këshillimit janë:**

- Vendosja e raportit
- Përcaktimi i problemit/Identifikimi i pikave të forta
- Përcaktimi i qëllimit/rezultateve
- Eksplorimi i alternativave dhe përballja me mospërputhjet
- Përgjithësimi dhe transferimi i të mësuarit

## **Empatia**

Empatia është një nga shprehjet më të rëndësishme në punën me fëmijët. Empatia është përjetimi i botës së fëmijës sikur të ishim vetë fëmija.

Empatia përforcuese është kur punonjësi mund t'u shtojë kuptim dhe ide mendimeve të shprehura nga fëmija. Nëse nuk aplikohet siç duhet, ajo mund të shkaktojë rezistencën (distancimin) e fëmijës. Empatia mund të vlerësohet nëpërmjet reagimit të fëmijës ndaj një pohimi që ka bërë punonjësi.

Aftësia për të ndjekur me vëmendje, në mënyrë të veçantë perifraximi, reflektimi ndaj ndjenjave të fëmijës dhe përmbledhja, ndihmon në zhvillimin e empatisë.

Mungesa e empatisë redukon procesin e të ndihmuarit. Reagime të cilat e largojnë fëmijën nga një proces i tillë mund të shkaktohen nga mungesa e aftësive ose përdorimi i tyre në mënyrë joefektive.

Empatia ka pesë nivele:

1. Empati e formës së prerë (Kjo nuk është e drejtë. Unë mendoj se ti duhet të marrësh në konsideratë edhe ndjenjat e tij).
2. Empati e moderuar (Ti duket se ke hequr dorë nga ai. Nuk dëshiron të përqipesh më).
3. Empati bazë ose reagim ndërveprues (Ti ndihesh i dekurajuar dhe konfuz. Je përpjekur ta bisedosh me babanë por duket se ai nuk e kupton këndvështrimin tënd).
4. Empati pak sugjeruese (Ti je përpjekur shumë për të biseduar. Çfarë do të thotë një gjë e tillë për ty?)
5. Empati sugjeruese (Unë arrij ta shoh lëndimin tënd dhe duket se për momentin ti nuk do të përqipesh më. Mendimet dhe ndjenjat e tua kanë shumë rëndësi për mua. Ti ke pasur arsye që je përpjekur kaq shumë për të folur me të. Më ke folur për ndjenjat e tua për babanë. Çfarë mendon për të shkuarën dhe ndjenjat që po përjeton tani?)

Empatia shfaqet në mënyrë profesionale kur punonjësi e vendos veten në pozita të cilat e bëjnë klientin të ndihet i sigurt dhe rehat me qëndrimin e tij. Për të arritur empatinë në punën me fëmijët dhe për të krijuar një marrëdhënie cilësore e pozitive është e rekomandueshme të ofrohet mbështetje, respekt dhe ngrohtësi, qartësi, qëndrim joparagjykses dhe empati e vërtetë.

**Qëndrimi pozitiv** ka të bëjë me identifikimin e aspekteve pozitive të përvojës së fëmijës dhe dëgjimin me kujdes të aspekteve pozitive duke e trajtuar fëmijën si një individ me vlera dhe potenciale.

**Respekti dhe ngrohtësia** përcillen gjatë komunikimit verbal dhe atij joverbal nëpërmjet mënyrës së qëndrimit, shprehjes së fytyrës dhe cilësive vokale. Fjalët e përdorura si dhe aspekte të ndryshme të komunikimit joverbal janë tregues kryesorë të respektit dhe ngrohtësisë së transmetuar.

**Konkretësia** lidhet me përdorimin e fakteve konkrete dhe mospërdorimin e përgjithësimeve të paqarta. Nëpërmjet saj biseda bëhet konkrete dhe reale. Për të konkretizuar një bisedë mund të përdoren shprehje të tilla si “a mund të më japësh një shembull specifik për...”.

**Prania** përshkruhet si përputhja me fëmijën në një moment të caktuar pra përputhja mes asaj që përjetohet nga punonjësi dhe asaj që përjetohet nga fëmija gjatë takimit/seancës. Sa më e fortë të

jetë marrëdhënia aq më e fortë do të jetë prania e njërës palë për tjetrën. Cilësia e pranisë ndikon shumë marrëdhënien ndihmuese dhe rezultatin e saj për fëmijën.

### **Qëndrimet joparagjyuese**

Qëndrimi joparagjyues kërkon që ju të hiqni dorë nga opinionet dhe besimet tuaja dhe të merrni pozicione neutrale në lidhje me fëmijën. Fëmijët mund të jenë përballur me vështirësi dhe çështje të komplikuar; ata nuk duhet të gjykohen apo vlerësohen, ata kanë nevojë të pranohen ashtu siç janë.

### **Inkurajimi**

Inkurajimi komunikon tek fëmija idenë që është dëgjuar. Inkurajimi mund të jetë verbal ose joverbal dhe përdoret për të nxitur fëmijët që të vazhdojnë të flasin apo të veprojnë në mënyrën e duhur. Inkurajimi që bëhet për të nxitur bisedën mund të konsistojë në fraza të shkurtra të tilla si “Po”, “E kuptoj”, “Ehë..” “Më thuaj” etj. por edhe me perifrazime të shkurtra si “Ti u zemërove”, “E pyete veten pse”.

Nga ana tjetër, inkurajimi për të vepruar bëhet gjithashtu nëpërmjet mjeteve të mësipërme, por sidomos bëhet duke u fokusuar në:

- Procesin e ndryshimit dhe riparimit
- Mbështetjen e fëmijës në përpjekjet për të “bërë mirë”
- Dhënien e mundësive të zgjedhjes fëmijës brenda institucionit
- Përdorimin e masave alternative që çojnë në heqjen dorë nga krimi dhe në ndryshimin pozitiv
- Përfshirjen e bashkëpunimit në marrëdhënien me fëmijën

*Ushtrim: Inkurajimi*

*Qëllimi - Të gjenden alternativa të ndryshme për të inkurajuar fëmijën*

*“Unë e di që jam shumë dobët në matematikë. Presori përpiqet shumë por unë nuk e kam mendjen në mësim sepse Olsi më ngacmon gjatë orës së mësimit duke më treguar se çfarë bënte jashtë kur ishte me shokët. Nuk e di si t’ia bëj me Olsin por e di që duhet patjetër të bëj diçka për shkollën”.*

*Përmendni 3 lloje të ndryshme inkurajimi lidhur me këtë pohim të fëmijës.*

---

---

---

### **Identifikimi i pikave të forta dhe mbështetja te pikat e forta në punën me fëmijët**

Fëmijët rriten për nga aspekti i personalitetit duke u mbështetur në pikat e tyre të forta. Në çdo takim me fëmijët, duhet planifikuar kohë e mjaftueshme për të identifikuar pikat e forta dhe



potencialet e fëmijës, të cilat mund të përdoren për të zgjidhur problemin dhe për të kontribuar në zhvillimin e personalitetit të tij në të ardhmen.

Identifikimi i pikave të forta mund të bëhet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme:

1. Punonjësi mund ta fillojë çdo takim/seancë duke pyetur për ngjarje të kohëve të fundit lidhur me të cilat fëmija ndihet mirë dhe ka ndjenja pozitive. Punonjësi mund të komentojë një pikë të fortë të fëmijës.
2. Gjatë fazës së përcaktimit të problemit, nëse përdoret mirë shprehia e dëgjimit, mund të evidentohen aspekte pozitive të përvojës së fëmijës, p.sh. “ti thua se ndihesh i mërzitur dhe i paafte, por më tregove se ke nota shumë të mira në letërsi dhe edukim fizik. A mund të më thuash një aspekt pozitiv që të bën të ndihesh mirë lidhur me këtë apo me diçka tjetër që mendon se di ta bësh mirë?”
3. Nëse fëmija vazhdon të bëjë komente negative për veten, atëherë mund të vepohet duke i dhënë përgjigje (*feedback*) për atë që thotë në kohën e duhur dhe nga një perspektivë pozitive. “Po, është e vërtetë që prindërit e tu mund të ndihen keq për sjelljen tënde, por unë e shoh se ata të duan shumë dhe ti i do shumë ata. Këto janë gjëra që ndihmojnë shumë për të kaluar vështirësitë”.
4. Një mënyrë tjetër e identifikimit të pikave të forta është gjetja e tyre në dobësitë e fëmijës. Kjo bëhet nëpërmjet ripërkufizimit, p.sh. një fëmijë i shqetësuar mund të ripërkufizohet si shumë i kujdesshëm. Identifikimi i pikave të forta i ndihmon fëmijët të bëhen më tolerantë.

*Ushtrim: Identifikimi i pikave të forta të fëmijës*

*Qëllimi - Të identifikohen pohime që synojnë nxjerrjen në pah të pikave të forta dhe anëve pozitive të fëmijës.*

*Në një bisedë, fëmija ju thotë “Po, jam shumë konfuz për të ardhmen time. Një pjesë e imja më thotë që nuk mund të kem më të ardhme pas dënimit, ndërsa një pjesë tjetër mendon për të ardhmen... dhe do të doja të vazhdoja e të përfundoja vitin e fundit të shkollës së mesme dhe pastaj ndoshta të shkoja në universitet”.*

*Identifikoni 3 pohime që synojnë nxjerrjen në pah të pikave të forta të fëmijës. Mund të përdorni pyetje të hapura, të mbyllura, inkurajim, perifrachim, reflektim ndaj ndjenjës së fëmijës, përmbledhje.*

*Ushtrim: Identifikimi i pikave të forta në jetën e përditshme*

*Qëllimi - Të identifikohen pohime që synojnë nxjerrjen në pah të pikave të forta dhe anët pozitive të një njeriu të afërt.*

*Përdorni rastin e ndonjë anëtari të familjes apo të njohuri tuaj që mund të jetë përballur me një çështje të vështirë apo shqetësim për të identifikuar pikat e tij të forta. Njerëzit mund të mbështeten duke u kujtuar atyre se kanë potenciale e karakteristika pozitive. Shkruajini mendimet tuaja në hapësirën përkatëse në fletën e punës.*

## **Përballja**

Shprehia e përballjes e ndihmon fëmijën të ndryshojë dhe të rritet. Ndërsa shprehitë e tjera e ndihmojnë në lehtësimin e situatës dhe i ofrojnë mbështetje, është përballja e fëmijës me mospërputhjet ajo që vepron si shtytje për aktivizimin e potencialit të tij. Megjithëse mund të duan të ndryshojnë, fëmijët mund t'i bëjnë rezistencë përpjekjes së punonjësve për të ndryshuar jetën e tyre. Detyra e punonjësve të institucioneve penitenciare është t'i ndihmojnë fëmijët të dalin nga gjendja në të cilën ndodhen duke lënë pas problemet që kanë dhe të realizojnë potencialin e tyre. Përballja duhet parë si diçka themelore në këtë proces.

Përballja mund të përkufizohet si vëzhgimi i papajtueshmërive tek fëmija dhe analizimi i tyre me anë të shprehive ndikuese (që do t'i shohim më poshtë). Mospërputhjet e identifikuar te fëmija, mesazhet mikse dhe konfliktet e mundshme konfrontohen me vetë fëmijën dhe fëmija inkurajohet të flasë më në detaje e të zgjidhë problemet e tij.

Përballja është jo “të shkosh kundër” fëmijës, por “të shkosh në një hap” me fëmijën, të kërkohet qartësi dhe mundësi për zgjidhjen e një situatë të vështirë.

Përballja përfshin tre hapa kryesorë:

1. Identifikimi i mesazheve mikse, mospërputhjeve dhe konflikteve
2. Puna drejt zgjidhjes së mospërputhjeve dhe mesazheve mikse
3. Vlerësimi i ndryshimit

### **Identifikimi i mesazheve mikse, mospërputhjeve dhe konflikteve**

Kur një person jep një mesazh të qartë, ai jep informacion të integruar, të kuptueshëm dhe konsekuent, ndërsa, nëse personi jep një mesazh të paqartë, thuhet se ai jep mesazhe të dyfishta (tjetër mesazh verbalisht dhe tjetër jo verbalisht). Si bëhet identifikimi i mesazheve mikse?

### **Mospërputhja mund të shfaqet në format e mëposhtme:**

- Mospërputhja midis dy pohimeve
- Mospërputhja mes asaj që thuhet dhe asaj që bëhet
- Mospërputhja mes pohimeve dhe sjelljes joverbale
- Mospërputhja mes dy sjelljeve joverbale
- Mospërputhja mes thënieve dhe kontekstit
- Mospërputhjet mes dy ose më shumë njerëzve

### **Puna drejt zgjidhjes së mospërputhjeve dhe mesazheve mikse**

Për të zgjidhur mospërputhjet, ndonjëherë mund të mjaftojë edhe evidentimi i mospërputhjes por më shpesh zgjidhja e tyre kërkon një përballje me fëmijën. E rëndësishme është të fokusohemi te mospërputhja dhe jo te fëmija. Përballja e mospërputhjes bëhet nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

1. Identifiko mospërputhjen haptas dhe qartë

2. Skico specifikat e mospërputhjes (verifiko nëse ajo lidhet me një sjellje, nëse janë të përfshirë dy njerëz prit të marrësh dy këndvështrimet)
3. Përmblihdh periodikisht dimensione të ndryshme të mospërputhjes (Modeli i përballjes mund të jetë i tipit “nga një anë... por nga anën tjetër” dhe zakonisht rezulton i suksesshëm. Variante të tjera mund të jenë: “Ti thua se... por vepron...”; “fjalët e tua tregojnë se... por veprimet e tua tregojnë se...”)
4. Ofro *feedback* duke dhënë opinionet e tua mbi vëzhgimet e mospërputhjeve. Sugjerohet përdorimi i shprehive ndikuese si direktivat, pasojat logjike etj. për të lehtësuar zgjidhjen. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje nëpërmjet këtij procesi, atëherë shpreh mendimin tënd: “Ti e sheh problemin në këtë mënyrë, ndërsa unë në fakt e shoh kështu...”

Përballja është një sfidë dhe kjo bëhet më e vështirë kur bëhet fjalë për fëmijët. Procesi i përballjes bëhet i lehtë nëse kemi një marrëdhënie solide besimi dhe duhet kryer gjithmonë me ndjeshmëri, etikë dhe kujdes.

*Ushtrim: Identifikimi i mospërputhjeve*

*Qëllimi - Të identifikohet lloji i mospërputhjes dhe të realizohet një model përballjeje*

*Një djalë vjen me vonesë në takim me punonjësën e edukimit për herën e tretë rresht dhe thotë “Më falni, më vjen shumë keq. Unë nuk vij asnjëherë me vonesë, por sot nuk ia dola dot”.*

*Identifikoni llojin e mospërputhjes dhe shkruani një mesazh përballjeje duke vendosur më parë cili do të jetë modeli i përballjes.*

### **Dhënia e direktivave**

Direktivat janë një nga shprehjet më të rëndësishme të quajtura ndikuese dhe të këshilluara për t’u përdorur me fëmijët. Të japësh direktiva nuk do të thotë t’i tregosh fëmijës se çfarë duhet të bëjë, të thotë apo të mendojë. Ata që punojnë me fëmijët shpesh u thonë fëmijëve si të largojnë një ëndërr, si të provojnë një sjellje të re, si të programojnë kohën etj. Të gjitha këto janë direktiva. Që një direktivë të jetë efektive duhet të respektohen rregullat e mëposhtme:

1. Përdor lëvizje të përshtatshme, tonin e duhur vokal dhe kontakt me sy.
2. Ji i qartë dhe konkret në shprehjet e tua. Krahaso p.sh. shprehjet e mëposhtme:  
I paqartë: Shko dhe përgatitu për një test”  
I qartë: Pasi të ikësh që këtu sot, kontakto me mësuesin dhe merri testin e Gjuhës. Plotësoje që sot, jepja atij dhe ne për takimin tjetër do të kemi rezultatin tënd.  
I paqartë: Relaksohu!  
I qartë: Ulu qetësisht..., ndieje karrigen në shpatulla... mblidhe dorën e djathtë... mbaje mbledhur fort... tani lëre të qetësohet ngadalë...”
3. Kontrolllo nëse direktiva jote është dëgjuar dhe kuptuar. Saktësia ose vetëqartësia shërbejnë për të qenë të sigurt se direktiva e dhënë ka qenë e kuptueshme. P.sh. “A mund ta përsërisësh atë që të thashë të bësh?” “Unë të sugjerova tri detyra për javën tjetër. A mund t’i përmbledhësh ato tani që unë të jem i sigurt se kam qenë i qartë?”

*Ushtrim: Cilat nga direktivat janë të qarta dhe cilat të paqarta*

*Qëllimi - Identifikimi i direktivave të qarta dhe të paqarta për fëmijën duke përdorur shkronjat Q për e qartë dhe P për e paqartë.*

\_\_\_\_ "Unë dua që të imagjinosh sikur je duke i folur mamasë tënde"

\_\_\_\_ "Imagjino sikur mamaja jote është e ulur në atë karrige. Tani fol me të sikur ajo me të vërtetë të ishte aty"

\_\_\_\_ "Unë do t'ju njoh me Znj. Eli, sekretaren tonë, dhe ajo do t'ju japë testin për të cilin folëm"

\_\_\_\_ "Provoje atë ide javën tjetër"

*Ushtrim: Listë me direktiva specifike*

*Direktiva specifike: Unë sugjeroj që ju ta provoni...*

*Direktiva paradoksale: Vazhdo atë që je duke bërë....*

*Imagjinata: Imagjino sikur je në situatën e fundit. Mbylli sytë dhe përshkruaje atë në mënyrë precize. Çfarë je duke bërë, dëgjuar, ndierë?*

*Miratim role - play: Tani kthehu tek ajo situatë dhe le ta luajmë.*

*Teknika e karriges bosh e Gestalt-it: Fol me prindin tënd sikur ai apo ajo të jetë ulur në atë karrige. Tani shko tek karrigia dhe përgjigju ashtu si do të ishte përgjigjur ai/ajo.*

*Joverbali i Gestalt-it: Unë vë re se njëra dorë është grusht dhe tjetra e hapur. Vendosi të dyja duart të flasin me njëra-tjetrën.*

*Rimodelimi pozitiv: identifikoj një eksperiencë, mendim apo ndjenjë negative. Tani identifikoj diçka pozitive në atë eksperiencë dhe fokusohu në atë dimension. Përmbledhi të dyja.*

*Relaksimi: Mbylli sytë dhe qetësohu.*

*Zgjedhja gjuhësore: Ndrysho "duhet" në "dua që..."*

*Meditimi: Qëndro pa lëvizur. Përqendrohu në frymëmarrjen tënde. Lëri të gjitha mendimet të rrëshqasin.*

*Komunikime sipas terapisë familjare: Mos më fol mua tani... foli atij.*

*Detyra: Praktiko këtë ushtrim kësaj jave dhe paraqite në takim tjetër.*

## **MODULI 4**

### **TEKNIKA TË PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE**

#### **PËRMBAJTJA**

4.1 Proçedurat miqësore të përfshirjes së fëmijëve

4.2 Roli i punonjësve të institucioneve penitenciare

4.3 Fëmijët me nevoja të veçanta

#### Objektivat:

- Të njohim dhe kuptojmë rëndësinë e përfshirjes/pjesëmarrjes së fëmijëve.
- Të njohim proçedurat miqësore të përfshirjes së fëmijëve.
- Të njohim elementët e përfshirjes/pjesëmarrjes së fëmijëve dhe ti zbatojmë ato në situata me fëmijët dhe kolegët.

#### Rezultatet e pritura:

- Të aplikojmë përfshirjen/pjesëmarrjen e fëmijëve.
- Të përshkruajmë proçedurat miqësore të përfshirjes së fëmijëve.
- Të njohim procesin e përfshirjes/pjesëmarrjen e fëmijëve dhe faktorët që e ndikojnë këtë proces.
- Të përmendim elementët përfshirjes/pjesëmarrjes së fëmijëve dhe ti zbatojmë ato në situata me fëmijët dhe kolegët.

Metodologjia : Prezantim në PP, ushtrime, diskutim në grup.

#### Përshkrimi i modulit

Ky modul do t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri mbi rëndësinë e përfshirjes/pjesëmarrjen e fëmijëve gjatë punës së tyre të përditëshme në sistemin penitenciar. Ata duhet të jenë të aftë të aplikojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjitha proçeset si në planifikim, zbatim të aktiviteteve etj. Ky modul prezanton një model të përfshirjes/pjesëmarrjes së fëmijëve, proçedurat miqësore të përfshirjes së tyre, elementët përfshirjes/pjesëmarrjes së fëmijëve dhe mënyrën e zbatimit në situata me fëmijët dhe kolegët.

#### Shtjellimi i modulit:

1. Trajneri/ja e hap seancën duke shpjeguar rëndësinë e pjesëmarrjes/përfshirjes së fëmijëve.
2. Shpjegohen proçedurat miqësore të përfshirjes së fëmijëve.
3. Renditen elementët e përfshirjes/pjesëmarrjes së fëmijëve dhe ti zbatojmë ato në situata me fëmijët dhe kolegët.

Mjetet: Prezantim në PP; material i shpërndarë për rastet, flipchart.

## **Përfshirja e fëmijës**

Përfshirja e fëmijës është shumë e rëndësishme në të gjitha fazat e procesit për mbështetjen/trajtimin e fëmijëve në institucionet penitenciare. Ekzistojnë praktika të përfshirjes së fëmijës për të gjitha fazat, pavarësisht nga mosha e tij. Vlerësimi i dëshirave dhe ndjenjave të fëmijës duhet bërë në përputhje me moshën e tij dhe me pjekurinë. Rritja në moshë e fëmijëve i bën mendimet e tyre më të rëndësishme për institucionet penitenciare. Është e rëndësishme të pranojmë se mendimet e fëmijëve nuk janë vendimtare sepse fëmija mund të dëshirojë diçka që është në kundërshtim me mirëqenien dhe interesin e tij.

Respektimi i të drejtës për t'u dëgjuar shprehet në këto alternativa të Kodit të Familjes të cilat zbatohen në të gjitha procedurat apo praktikat administrative dhe gjyqësore:

- Marrja në konsideratë e mendimit të të miturit.
- Marrja në konsideratë e ndjenjave të të miturit.
- Kërkimi i dhënies së pëlqimit prej të miturit.
- Bërja e ndërhyrjeve gjatë një procesi.
- Të qenët i pranishëm i të miturit.
- Ligjërimi i tij si kërkues i drejtpërdrejtë në një proces gjyqësor.

## **Mjedisi mbrojtës**

Mjedisi mbrojtës është shumë i rëndësishëm për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve në çfarëdo aktiviteti në institucionet penitenciare dhe arrihet kur nevojat e zhvillimit të fëmijës, kapacitetet institucionale dhe faktorët institucionalë dhe mjedisorë janë në favor të rritjes dhe zhvillimit të shëndetshëm të fëmijës.

**Procedurat miqësore për fëmijët** janë ato procedura që kryhen prej profesionistëve gjatë procesit të ndihmës për fëmijët të cilat mbajnë parasysh moshën, aspektet e zhvillimit, sigurinë dhe nevojat e veçanta të fëmijës.

### **Qëllimi i procedurave miqësore për fëmijën është:**

- Të garantojnë sigurinë e fëmijës
- Të reduktojnë dhimbjen e fëmijës gjatë procesit
- Të reduktojnë frikën e fëmijës nga procedura të caktuara
- Të rrisin bashkëpunimin fëmijë-profesionist

## Qasja e procedurave miqësore për fëmijët

Koncepti i procedurave miqësore për fëmijët erdhi nga një prokuror, Bud Cramer<sup>23</sup>, i cili i krijoi gjatë intervistimit të fëmijëve të abuzuar seksualisht me qëllim procedimin e suksesshëm të abuzuesve seksualë; por ai dëshironte gjithashtu të krijonte një mjedis sa më njerëzor për fëmijët që i nënshtroheshin intervistave dhe hetimeve në rajonet e policisë. Tashmë kjo është një qasje që përfshin standarde të përcaktuara qartë të cilat janë:

- Grupet multidisiplinare të trajtimit të fëmijëve
- Kompetencat kulturore dhe diversiteti
- Intervistat dhe këshillimi nga profesionistë
- Mbështetja dhe advokacia për viktimat/të dëmtuarit
- Vlerësimi mjekësor
- Vlerësimi i shëndetit mendor dhe trajtimet e nevojshme
- Rishikimi i rastit
- Ndjekja e rastit
- Kapaciteti organizativ
- Mjedise të fokusuara te fëmijët

**Procesi i dhënies së ndihmës** një fëmije ka disa elementë të rëndësishëm që janë: mjedisi, punonjësi i institucionit, përmbajtja e programit, koha e kryerjes së programit.

**Mjedisi** duhet të konsistojë në një dhomë të rehatshme që i siguron fëmijës ndjenjën e privatësisë dhe përmbush nevojat e tij duke e bërë të ndihet fizikisht dhe psikologjikisht i sigurt.

- Dhoma e takimit mund të jetë një dhomë me pasqyrë gjysmëtransparente që krijon mundësinë që takimin ta ndjekin edhe profesionistë të tjerë.
- Dhoma duhet të jetë e pajisur me objekte dhe mjete me të cilat fëmija mund të luajë gjatë pritjes për të bërë intervistën të tilla si: kompjuter, libra, revista, lapsa etj. Në ambientet e dhomës së takimit me fëmijët duhet të ketë materiale informuese apo edukuese për institucionin, institucione të tjera ku fëmija mund të ankohej etj.
- Dhoma duhet të sigurojë intimitetin gjatë takimit nëpërmjet zhurmës së mbylljes, gjë që bën që fëmija të ndihet i sigurt.
- Dhoma duhet të jetë e lyster me ngjyra të buta.
- Dhoma duhet të jetë e mobiluar për të pritur fëmijë të rritur (dy tavolina në përmasa të ndryshme si dhe karriget që i shoqërojnë, një divan ose kolltuk, tapet i butë etj.).
- Dhoma duhet të jetë e pajisur me objekte ndihmuese për të marrë informacionin e nevojshëm (lapsa me ngjyrë, letër).

**Punonjësit e institucioneve penitenciare** që zhvillojnë takimet me fëmijët janë një element i rëndësishëm në krijimin e sigurisë së fëmijës.

- Punonjësit gjatë këshillimit në përgjithësi duhet të jenë vetëm; profesionistë të tjerë mund ta ndjekin takimin nga dhoma tjetër nëpërmjet pasqyrës gjysmëtransparente. Shumë persona

---

<sup>23</sup>Jones, L.M., Cross, T.E., Walsh, W.A. and Simone, M. (2007). "Do children's advocacy centers improve children's experiences of imprisonment?"

njëherësh e frikësojnë fëmijën, prandaj është praktikë e mirë që takimi të kryhet vetëm me një profesionist.

- Punonjësi i institucioneve penitenciare duhet të komunikojnë në mënyrë të ngrohtë me fëmijën, të jetë i veshur në mënyrë etike dhe të tregojë respekt për fëmijën dhe familjen e tij.

**Përmbajtja e programit dhe e takimeve specifike** duhet të marrë në konsideratë moshën, zhvillimin dhe mendimin e fëmijës, dhe mundësisht edhe pëlqimin e fëmijës për pjesëmarrje. Gjuha e përdorur dhe renditja e pyetjeve kanë rëndësi për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijës në këtë proces.

**Koha e kryerjes së takimeve** varet nga moshja, aspektet e zhvillimit, problemi dhe nevojat e veçanta të fëmijës. Takimet me fëmijët nuk duhet të jenë shumë të gjata; në disa praktika ky protokoll zgjat deri në 45 min. Tema të dhimbshme nuk duhet të përsëriten disa herë sepse e riviktimizojnë fëmijën.

### **Fëmijët me nevoja të veçanta**

Këta fëmijë duhet të përfshihen në programe në përputhje me kushtet e tyre fizike, psikologjike dhe mendore. Përmbajtja dhe strukturimi i programit duhet të përshtatet me nivelin e tyre të zhvillimit dhe nuk duhet t'i bëjë fëmijët të ndihen keq. Punonjësit që do të kryejnë takimet duhet të kenë dijeni dhe të jenë të përgatitur më parë për nevojat e veçanta të fëmijës.

**Teknika të veçanta** të cilat ndihmojnë në rritjen e reziliencës së fëmijës dhe në rritjen e pjesëmarrjes së tij në proces janë lojërat dhe arti në grup.

**Lojërat** dhe sporti janë aktivitete në të cilat fëmijët marrin pjesë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin. Disa fëmijë në institucionet penitenciare mund të largohen nga aktivitetet me bashkëmoshatarët dhe të ndiejnë stres dhe në të kundërt, disa të tjerë mund të duan të përfshihen në lojëra të rrezikshme dhe të dhunshme. Por, në përgjithësi, lojërat dhe sporti i ndihmojnë ata të relaksohen dhe të hyjnë në komunikim. Gjatë lojës ose pas lojës fëmijët reflektojnë për ndjenjat dhe mendimet e tyre, gjë që ndihmon në lehtësimin dhe përballimin e situatave problematike. Është e rëndësishme që lojërat dhe sporti të jenë të përshtatura me moshën, aftësitë motorike dhe intelektuale të fëmijës dhe hapësirën.

Pjesëmarrja e fëmijës në aktivitete që lidhen me të është e rëndësishme sepse, nëpërmjet pjesëmarrjes, fëmija njihet dhe vlerëson aftësinë e tij për t'u përballur me situata të vështira. Rezilienca e fëmijës shfaqet më mirë nëse fëmija merr pjesë në të gjitha aktivitetet për të.

**Arti në grup** është një teknikë që përmirëson pjesëmarrjen e fëmijës dhe veprimin e tij në grup. Në aktivitetet në grup, fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin, kuptojnë dhe pranojnë më mirë kushtet në të cilat ndodhen dhe ndikohen pozitivisht nga reagimi i të tjerëve.



## MODULI 5

### **KOMUNIKIMI I PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE PENITENCIARE ME FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN, KOMUNIKIMI MIDIS KOLEGËVE NË SEKTORË TË NDRYSHËM**

#### **PËRMBAJTJA**

5.1 Rëndësia e Komunikimi Efektiv

5.2 Llojet e Komunikimit Efektiv

5.3 Analiza e Komunikimit Efektiv

#### Objektivat:

- Të njohim dhe kuptojmë rëndësinë e komunikimit efektiv.
- Të njohim llojet e komunikimeve dhe avantazhet e disavantazhet e tyre në situata të veçanta.
- Të njohim procesin e perceptimit dhe faktorët që e ndikojnë këtë proces.
- Të njohim dhe analizojmë në kontekstin tonë mekanizmat mbrojtës dhe përdorimin e tyre në kontekstin personal apo profesional.
- Të njohim elementët e komunikimit efektiv dhe ta zbatojmë atë në situata me fëmijët dhe kolegët.

#### Rezultatet e pritura:

- Të evidentojmë rëndësinë e komunikimit efektiv me fëmijët dhe adoleshentët.
- Të përmendim llojet e komunikimeve dhe avantazhet e disavantazhet e tyre në situata të veçanta.
- Të përshkruajmë procesin e perceptimit dhe faktorët që e ndikojnë këtë proces.
- Të identifikojmë mekanizmat mbrojtës dhe përdorimin e tyre në kontekstin personal apo profesional
- Të përmendim elementët e komunikimit efektiv dhe të analizojmë rolin e tyre në komunikimin efektiv në situata të sjella nga praktika e punës së pjesëmarrësve në sistemin penitenciar.

Metodologjia : Prezantim në PP, ushtrime, diskutim në grup.

#### Përshkrimi i modulit

Ky modul do t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri mbi rëndësinë e komunikimit efektiv të punonjësve të institucioneve penitenciare në marrëdhëniet me fëmijët. Ata duhet të jenë të aftë të përcjellin mendimet dhe ndjenjat e tyre me saktësi. Ky modul prezanton një model komunikimi, përshkruan faktorët që ndikojnë në procesin e komunikimit dhe ofron udhëzime mbi si të komunikojmë më me efektivitet me fëmijët. Gjithashtu, ky modul përmban informacion mbi komunikimin joverbal dhe tregon se si komunikimi joverbal mund të përdoret për të kuptuar më mirë fëmijët. Përmes komunikimit, punonjësit e edukimit dhe të sigurisë në këto institucione shpjegojnë kërkesat dhe rregullat e institucionit për fëmijët, shpjegojnë qëllimet e punës me fëmijët, kërkojnë pjesëmarrjen

dhe mendimin e fëmijëve, dëgjojnë nevojat e fëmijëve, marrin përsipër përgjegjësi për plotësimin e tyre, lavdërojnë, nxisin dhe ushtrojnë autoritetin me fëmijët. Komunikimi efektiv ndodh midis dy a më shumë individëve atëherë kur marrësi interpreton mesazhin e dërguesit ashtu si ky i fundit e dërgon atë.

Shtjellimi i modulit:

4. Trajneri/ja e hap seancën duke shpjeguar rëndësinë e komunikimit efektiv me fëmijët dhe adoleshentët.
5. Shpjegohen llojet e komunikimeve dhe avantazhet e disavantazhet e tyre në situata të veçanta.
6. Shpjegohet procesi i perceptimit dhe faktorët që ndikojnë në këtë proces.
7. Renditen dhe analizohen mekanizmat mbrojtës dhe përdorimi i tyre në kontekstin personal apo profesional.
8. Përmbledhen elementët e komunikimit efektiv dhe u kërkohet pjesëmarrësve ta analizojnë dhe ta zbatojnë atë në situata me fëmijët dhe kolegët.

Mjetet: Prezantim në PP; material i shpërndarë për rastet, *flipchart*.

### **Modeli i komunikimit si proces**

Ndonëse pjesa më e madhe e njerëzve mendojnë se e kuptojnë se çfarë është komunikimi, ata nuk janë plotësisht të ndërgjegjshëm për faktin se ky proces vazhdon sa herë që njerëzit ndajnë ide.

Ky paragraf do të përmbledhë shkurtimisht komunikimin si proces. Do të fillojmë duke supozuar që ju, një dërgues, dëshironi të shprehni një mendim apo një ndjenjë. Gjëja e parë që bëni është shndërrimi i mendimeve dhe ndjenjave tuaja në simbole (zakonisht fjalë por edhe sinjale joverbale) të kuptueshme për të tjerët. Ky proces është quajtur *kodim*. Gjetja në mënyrë të saktë e simboleve për të shprehur atë që ndieni ose mendoni në varësi të temës dhe karakteristikave të audiencës (fëmijët, në rastin tonë) mund të jetë e vështirë. Hapi tjetër është *dërgimi i mesazhit*. Ka disa mënyra për të dërguar një mesazh p.sh. fjalë, prekje, qëndrim, gjeste, mimikë. Kur mesazhi arrin te marrësi, ai e dekodifikon (deshifron) atë duke e interpretuar në terma të ndjenjave dhe mendimeve që kanë një domethënie për atë vetë. Ajo që marrësi kupton varet nga shumë faktorë, ndër të cilët mund të përmendim: moshën, zhvillimin mendor, aftësitë konjitive, gjuhën, kulturën etj. Ky proces është komunikimi me një drejtim, në të cilin dërguesi dërgon një mesazh te marrësi. Pjesa më e madhe e komunikimit është një proces me dy drejtime, ku dërguesi dërgon një mesazh te marrësi dhe marrësi përgjigjet.

Në komunikimin efektiv, ajo që marrësi deshifron është ajo që dërguesi dërgon. Megjithatë, mund të ndodhë që diçka të shkojë gabim në komunikim. P.sh. një shaka miqësore mund të merret si tallje. Arsyet për të cilat ndodhin këto keqkuptime janë tre: së pari, dërguesi mund të ketë vështirësi të shprehë me fjalë mendimet dhe ndjenjat që kërkon të shprehë; së dyti, mesazhi mund të haset me vështirësi të tjera në transmetim si p.sh. zhurma të ndryshme përreth; së treti, gjatë dekodimit mund të ndodhë që marrësi të mos kuptojë mesazhin e dërguesit për shkak të disa faktorëve si p.sh. faktorët psikologjikë, vlerat, besimet, stereotipat etj.

## **Komunikimi me një drejtim**

Komunikimi me një drejtim është ai në të cilin dërguesi nuk kërkon përgjigje nga marrësi p.sh. kur jepen udhëzime, urdhra apo njoftime për anëtarët e grupit të cilëve nuk u lejohet të përgjigjen me mendime, ndjenja apo ide. Në këtë lloj komunikimi, roli i dëgjuesit është të marrë mesazhet dhe t'i bindet kështu udhëzimit apo urdhrat që i dërgohet. Avantazhi i komunikimit me një drejtim është se mesazhet dhe udhëzimet përcillen shpejt dhe pa ndërprerje pasi ky komunikim nuk lejon të drejtohen pyetje dhe të shfaqen shqetësime nga ana e atyre që dëgjojnë. Komunikimi me një drejtim nuk këshillohet të përdoret me fëmijët, përveç në rastet kur punonjësi dëshiron t'i komunikojë fëmijës një vendim apo udhëzim për diçka që është diskutuar me të më parë.

## **Komunikimi i udhëhequr ose detyruar**

Një variant i komunikimit me një drejtim i cili përfshin marrjen e *feedback*-ut është emërtuar nga McGregor si komunikimi i udhëhequr ose detyruar. Sipas kësaj qasjeje, drejtuesi i grupit dërgon një mesazh dhe anëtarët e grupit kanë mundësinë të kërkojnë informacion për qartësim. *Feedback-u* kufizohet në verifikimin nëse anëtarët e grupit e kanë kuptuar mirë mesazhin. Kur drejtuesi i grupit gjykon se anëtarët e kanë kuptuar mesazhin, komunikimi ndërpritet. Ky lloj komunikimi bazohet në premisën se këndvështrimi i drejtuesit mbi një çështje është në interesin më të lartë të grupit apo fëmijës. Komunikimi i udhëhequr ka një avantazh në krahasim me komunikimin e thjeshtë me një drejtim që konsiston pikërisht në faktin që në këtë lloj komunikimi ka një proces i cili përcakton nëse anëtarët kanë kuptuar apo jo mesazhin.

## **Gabime në komunikim për shkak të gjuhës së përdorur**

Gjuha është simbolike dhe kuptimet shpesh qëndrojnë më tepër te njerëzit sesa tek fjalët në vetvete. Për më tepër, çdo fjalë, në çdo gjuhë, mund të interpretohet në një sërë mënyrash të cilat shpesh çojnë në keqkuptime. Punonjësit e institucioneve penitenciare duhet të jenë të ndërgjegjshëm për gabimet në komunikim që vijnë për shkak të gjuhës, moshës apo kulturës të cilës i përket fëmija. Fëmijët nuk i kuptojnë mesazhet njësoj me të rriturit dhe fëmijë të ndryshëm mund t'i interpretojnë të njëjtat mesazhe në mënyra të ndryshme.

## **Komunikimi me dy drejtime**

Komunikimi me dy drejtime i lejon të gjithë anëtarët të marrin pjesë në mënyrë të plotë në procesin e komunikimit. Ky lloj komunikimi ka shumë përfitime pasi nxit mendimet e të gjithëve duke përmirësuar kështu kohezionin, moralin e grupit, besimin dhe hapjen. Konfliktet dhe polemikat shuhet përmes zgjidhjeve cilësore që përfshijnë komunikimin efektiv. Disavantazhi i vetëm i komunikimit me dy drejtime është koha, por ky është komunikimi që përdoret në punën me fëmijët.

## **Kujdesi që nevojitet në komunikimin me dy drejtime**

Autoriteti është një faktor që ndikon në komunikimin me dy drejtime pasi individët me status të ngritur kanë tendencën të flasin më shumë dhe pjesa më e madhe e mesazheve janë të drejtuara ndaj fëmijëve duke u lënë atyre shumë pak kohë. Shpesh, anëtarët me pak pushtet nuk duan të përfshihen në komunikimin me dy drejtime pasi kanë frikë nga pasojat. Anëtarët me autoritet shpesh ngurojnë të shfaqin kufizimet e tyre dhe vulnerabilitetin pasi kanë frikë të duken të dobët e të mos meritojnë

statusin e tyre. Kjo tendencë e individëve me autoritet minimizon komunikimin e sinqertë dhe të hapur. Kur ka diferenca të ndjeshme në status dhe autoritet midis palëve në komunikim, duhet të krijohet një atmosferë bashkëpunuese për të inkurajuar pjesëmarrjen e plotë, në rastin e institucioneve penitenciare të fëmijëve. Gjithashtu, që grupi të jetë efektiv, duhet që idetë dhe opinionet e të gjithë anëtarëve të grupit të konsiderohen si të vlefshme dhe të rëndësishme.

*Ushtrim: Pasojat emocionale të komunikimit me një drejtim*

*Qëllim: Ky ushtrim ka për qëllim t'ju ndihmojë të kuptoni impaktin emocional të komunikimit me një drejtim*

1. *Përshkruani një situatë në të cilën dikush (mësues, prind apo epror) ka përdorur me ju komunikimin me një drejtim*
2. *Si jeni ndier kur nuk ju është lejuar të shprehni opinionin tuaj, të ndani mendimet apo të bëni pyetje?*
3. *A kenë qenë të motivuar për të bërë atë që personi që ka përdorur këtë lloj komunikimi ju ka kërkuar të bëni.*

### **Perceptimi (Marrësi)**

Ndër hapësirat në të cilat komunikimi mund të shtrembërohet është perceptimi që ka marrësi për mesazhin e dërguesit. Perceptimi i mesazhit nga ana e marrësit varet jo vetëm nga procesi i kodimit të dërguesit, por edhe nga procesi i dekodifikimit të marrësit. Për shembull, marrësi mund t'i shtojë mesazhit të dërguesit një kuptim të ri. Nëse një person i gjinisë së kundërt ju thotë “Dukesh shumë këndshëm sot” ju mund ta perceptoni sikur po ju thotë “Dua të kem një marrëdhënie romantike me ty”.

Gjithashtu, marrësi mundet të mos kuptojë plotësisht atë që dërguesi i thotë dhe si përfundim të shtrembërojë pjesë të mesazhit pasi mund të mos e dëgjojë qartë atë. Ajo që marrësi percepton, më pas, bëhet mesazhi. Ky mesazh mund të jetë plotësisht i saktë, pjesërisht i saktë ose aspak i saktë.

Perceptimi i çdo mesazhi është i bazuar në eksperiencat e marrësit, nevojat e tij dhe në mesazhin aktual të dërguesit. Për shkak se përgjigjja e marrësit është gjithmonë një kombinim i asaj që është parë, asaj që është dëgjuar dhe asaj që është duke ndodhur në ato momente me të, është e vështirë që dy individë të mund të perceptojnë të njëjtën gjë ekzaktësisht në të njëjtën mënyrë.

### **Procesi perceptiv (Marrësi)**

Hapi i parë i marrësit në këtë proces është përzgjedhja e të dhënave që ai konsideron si të rëndësishme për t'u interpretuar. Faktorë të ndryshëm bëjnë që marrësi të zgjedhë disa mesazhe të caktuara dhe të injorojë disa të tjera. Për shembull, stimujt e fortë (gjëra të mëdha, të ndritshme, të zhurmshme) janë më të dukshëm; një fëmijë që flet me zë të lartë, tërheq vëmendjen e më shumë njerëzve sesa një tjetër që është i qetë. Stimujt e përsëritur gjithashtu tërheqin më shumë vëmendjen dhe përdoren gjerësisht në reklama. Motivet shpesh përcaktojnë informacionin e përzgjedhur në një mjedis që na jep disa mesazhe.

Nëse një njeri është i uritur ndërsa udhëton, ai është më i prirur të vërë re reklamat për ushqime dhe restorante. Nëse një fëmijë ka një hobi apo nëse ka një interes të veçantë në një fushë të caktuar, i

kushton më tepër rëndësi informacioneve që lidhen me këtë fushë. Anëtar i një grupi, i ndjeshëm ndaj një teme të caktuar, ka më shumë të ngjarë t'i kushtojë vëmendje komenteve që lidhen qoftë edhe për së largu me fushën që është në interes të tij.

Hapi i dytë i marrësit në procesin perceptiv është *organizimi* i të dhënave në mënyrë të tillë që ato të kenë kuptim. Për t'i dhënë kuptim një sjelljeje të caktuar, fëmijët do ta interpretojnë atë në termat e mendimeve të tyre për këtë sjellje. Nëse ata mendojnë se “të vjedhësh nuk është turp”, atëherë do ta shpjegojnë këtë sjellje bazuar në kuptimin që ata i japin asaj.

Marrësit e mesazheve zgjedhin atë që është e rëndësishme për t'u mbajtur mend dhe i organizojnë mesazhet në mënyrë të tillë që t'i interpretojnë dhe të reagojnë ndaj tyre. Marrësit kanë tendencën të mbajnë më shumë mend atë informacion që mbështet këndvështrimet e tyre, ndërkohë që informacioni që i bën individët të vënë në pikëpyetje besimet dhe zakonet e tyre shpesh injorohet dhe harrohet. Prandaj komunikimi me fëmijët duhet të jetë i qartë, i përshtatur me moshën dhe zhvillimin e tyre, i fortë (shoqëruar me pamje vizive apo muzikë) dhe i përsëritur.

### **Faktorët që ndikojnë në perceptimin e marrësit**

Ka disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në perceptimin e marrësit. Si të tillë mund të përmendim:

**Faktorët fiziologjikë:** shija, nuhatja, shikimi, temperatura, dëgjimi, niveli i stresit, lodhja fizike apo mendore, cikli menstrual etj.

**Faktorët psikosocialë:** mekanizmat mbrojtës, besimet, zakonet, vlerat dhe stereotipat.

### **Mekanizmat mbrojtës**

Mekanizmi mbrojtës është përpjekja psikologjike për të shmangur kushte apo situata të dhimbshme të tilla si ankthi, frustrimi, lëndimi apo faji. Mekanizmat mbrojtës të një individi zakonisht aktivizohen kur individi përballet me atë informacion që është në konflikt me imazhin që ai individ ka për veten. Edhe pse të gjithë përdorin mekanizma mbrojtjeje për të përballur situata të pakëndshme, mekanizmi mbrojtës mund të bëhet shkatërrues nëse perceptimi i realitetit shtrembërohet rëndë.

### **Mekanizmat mbrojtës më të zakonshëm janë:**

#### **Racionalizimi**

Një nga mekanizmat mbrojtës më të zakonshëm është racionalizimi, zhvillimi i një shpjegimi logjik por fals që mbron konceptin e vetes të një individi. Anëtarët e grupeve që përdorin këtë mekanizëm, në të vërtetë, i besojnë justifikimeve që përfytyrojnë P.sh. një student që mbetet në provim ka më shumë të ngjarë të fajësojë paaftësinë e mësuesit apo të përdorë arsye të tjera se sa të pranojë arsyen e vërtetë që mund të jetë mospërgatitja e tij.

## **Projektimi**

Duke përdorur këtë lloj mekanizmi, individët, në mënyrë të pandërgjegjshme, i atribuojnë idetë dhe impulset e tyre të papranueshme të tjerëve. P.sh. dikush kërkon të duket mirë para të tjerëve duke bërë të tjerët të duken keq. Nga pikëpamja psikologjike ky individ nuk dëshiron t'i pranojë vetes se motivet e tij janë egoiste. Kështu, ai e projekton egoizmin tek të tjerët duke besuar se ata përpiqen që ta bëjnë të duket keq. Kështu ai justifikon sjelljen e tij negative.

## **Mohimi**

Një individ mund të çlirohet nga dhimbja fizike duke mohuar apo refuzuar realitetin. Kur njerëzit përballen me humbje të rënda, ka të ngjarë që fillimisht t'i mohojnë ato, p.sh. kur humbasin një njeri të dashur.

## **Reagimi i formësuar**

Anëtarët e grupeve mund të shmangin përballjen me të vërtetën e pakëndshme duke reaguuar në mënyrë të kundërt me atë që ndiejnë. Individët që janë të nevrikosur dhe nuk ua pranojnë këtë të tjerëve apo vetes, shpesh reagojnë sikur nuk ka ndodhur asgjë. Duke përdorur këtë mekanizëm, personat e trishtuar dhe të vetmuar sillen sikur gjithçka shkon mirë, qeshin dhe bëjnë shokë vazhdimisht. Mekanizmi mbrojtës i mohimit është shpesh i lidhur me këtë mekanizëm, pasi edhe në këtë rast individët përpiqen të mbrojnë veten nga fakte apo ndjenja të dhimbshme.

## **Kompensimi**

Një baba i divorcuar përpiqet të lehtësojë dhimbjen e fëmijëve duke u blerë lodra të shtrenjta. Individë të cilët kanë probleme me jetën personale mund t'i kushtojnë gjithë energjinë shkollës apo sportit.

## **Identifikimi**

Disa individë i fshehin ndjenjat e tyre në disa situata dhe, në vend që të jenë vetvetja, zgjedhin të imitojnë dikë që admirojnë. Në rastin tonë, fëmijët imitojnë heronjtë e tyre. Ata mohojnë ndjenjat e tyre dhe veprojnë ashtu si heroi i tyre do të veponte në situata të ngjashme.

## **Fantazia**

Ky mekanizëm konsiston në përdorimin e fantazisë për të lehtësuar dhimbjen e realitetit. Nuk është e pazakontë që një fëmijë i birësuar që nuk është i lumtur të fantazojë që prindërit e tij biologjikë janë njerëz të veçantë dhe të dashur që një ditë do ta shpëtojnë. Fantazia është mbrojtëse në përballimin e shumë problemeve për fëmijët.

## **Regresioni**

Disa individë të rritur, kur janë të sëmurë apo në telashe, përjetojnë një lloj regresioni që çon deri në një gjendje fëmijërore me qëllimin e pavetëdijshëm për të tërhequr vëmendjen dhe për të marrë përkujdesje. Të njëjtën gjë mund të bëjnë dhe vetë fëmijët duke u kthyer në fëmijërinë e hershme.

## **Izolimi**

Shkëputja (ndarja) e një objekti nga emocioni që i bashkëngjitet këtij objekti bën që individi të mos shfaqë asnjë emocion ndaj objektit. Ky mekanizëm bën të mundur që një individ të shmangë dhimbjen e ankthit, fajit apo turpit. Një person që përdor këtë mekanizëm tregon mbi një akt të dhunshëm që ka kryer pa shfaqur asnjë emocion.

## **Zhvendosja**

Ky mekanizëm aktivizohet atëherë kur ndjenja të huaja dhe agresive drejtohen kundër objekteve apo njerëzve të padëmshëm dhe jo atyre që i kanë shkaktuar këto ndjenja. P.sh. burri i cili ka pasur një ditë të lodhshme dhe stresuese, abuzon verbalisht ose fizikisht me gruan, fëmijët apo kafshët shtëpiake.

## **Zhbërja**

Kur një individ ndihet fajtor për një veprim a dëshirë, ky individ e zhbën fajin e tij duke vepruar në një mënyrë që reflekton të kundërtën e atij veprimi apo dëshire. Shembulli klasik është rasti i bashkëshortëve që tradhtojnë të cilët, kur kjo ndodh, tregojnë më shumë vëmendje ndaj partnerit apo partneres.

*Ushtrim: Përdorimi i mekanizmave mbrojtës*

*Qëllimi - Ky ushtrim ka për qëllim t'ju ndihmojë të kuptoni më mirë mekanizmat mbrojtës.*

*1. Rilexoni listën e mekanizmave mbrojtës të diskutuar më lart. Renditni ato që janë përdorur nga njerëzit që ju njihni. Tregoni për secilin emrin e atij që e ka përdorur dhe përshkruani mënyrën me të cilën e ka përdorur.*

*2. Renditni mekanizma mbrojtës që ju kujtohet të keni përdorur ju vetë. Përshkruani si i keni përdorur.*

## **Komunikimi që nxit mbrojtjen**

Gibb vërejtë se ka më shumë të ngjarë që t'u përgjigjemi duke u mbrojtur disa llojeve të komunikimit dhe se kjo mbrojtje është reciproke. Kështu, kur dërguesi fillon të përgjigjet duke u vendosur në pozicion mbrojtës, atëherë edhe marrësi do të reagojë në të njëjtën mënyrë. Kjo bën që dërguesi ta rrisë akoma më tej mbrojtjen.

**Gibb ka identifikuar gjashtë tipa mesazhesh që rrisin mbrojtjen e marrësit: vlerësuese, kontrolluese, manipuluese, indiferente, superioriteti dhe sigurie.**

Çdo mesazh i parë si gjykues apo vlerësues rrit mbrojtjen e marrësit. Komunikimi që kontrollon sjelljen apo mendimet rrit gjithashtu mbrojtjen. P.sh. kur një shitëse përpiqet në mënyrë agresive të shesë një produkt, shumë klientë reagojnë duke u mbrojtur. Mbrojtja rritet gjithashtu kur njerëzit kuptojnë se dikush po përpiqet t'i manipulojë. Indiferenca e ndjenjave dhe e mendimeve ndaj dikujt tjetër gjithashtu rrit mbrojtjen. Gibb vërejtë se empatia e redukton mbrojtjen dhe se është më efiçese sesa vendosja e kontaktit apo krijimi i marrëdhënieve në superioritet. Nëse një dërgues, gjatë

komunikimit, përdor me ne mesazhe superioriteti, kjo na nevrokos dhe bën që të përdorim mekanizma mbrojtës për të ruajtur vetërespektin. Krijimi i një raporti mbi baza të barabarta është më konstruktiv dhe efektiv. Një pedagog që vendos marrëdhënie barazie me studentët e vet, përdor metoda më të mira edukative dhe komunikuese sesa ata që përpiqen të impresionojnë studentët me superioritetin e pozitës dhe njohurive të tyre.

Ashtu si Gibbs vë në dukje, një lloj tjetër komunikimi që rrit mbrojtjen është shfaqja e sigurisë, p.sh. personat që sillen sikur dinë gjithçka apo sikur i kanë të gjitha përgjigjet. Gibb thotë se individë të tillë, që duan të tregojnë siguri, zakonisht ndihen të pasigurt dhe inferiorë. Mbrojtja është barriera më e madhe për një komunikim efektiv, kështu që duhet të shmanget.

*Ushtrimi: Komunikimi mbrojtës*

*Qëllimi - Ky ushtrim ka si qëllim t'ju ndihmojë të kuptoni tipat e komunikimit që nxit mbrojtja. Për secilin nga tipat e mëposhtëm të komunikimit, përshkruani një rast në të cilin dikush e ka përdorur me ju. Përshkruani gjithashtu edhe reagimin tuaj ndaj kësaj situate.*

- a) komunikimi gjykues dhe vlerësues
- b) komunikimi për t'ju kontrolluar
- c) komunikimi për t'ju manipuluar
- d) komunikimi indiferent
- e) komunikimi superior që ju vë në pozita inferiore
- d) komunikimi i sigurt

### **Besimet, vlerat dhe qëndrimet**

Individët i përdorin besimet, vlerat dhe qëndrimet për të përzgjedhur, interpretuar dhe organizuar informacionin. Nëse anëtari i një grupi është i pëlqyer nga të tjerët, komentet e tij gjejnë më tepër vëmendje dhe mbështetje. Mospëlqimi shkakton të kundërtën. Kur anëtarët e një grupi nuk pëlqejnë një anëtar, pa u menduar gjatë, votojnë kundër çdo propozimi të tij, madje edhe ndaj atyre propozimeve që janë në të mirën e tyre. Besimet kanë një impakt të madh në perceptim, gjë që shpesh çon në një interpretim të pasaktë apo keqkuptim të mesazheve dhe në nxjerrjen e konkluzioneve të nxituara si dhe na shtyn të bëhemi mbrojtës në komunikim. Ky lloj keqinterpretimi është quajtur edhe tendencë për të personalizuar mesazhet.

### **Stereotipat**

Stereotipat janë imazhe mendore të fiksuara lidhur me një grup, të cilat aplikohen për të gjithë anëtarët e grupit. Stereotipat mund të jenë pjesërisht të saktë ose plotësisht të gabuar. Mund të zbuloni disa nga stereotipat që ju vetë keni duke vërejtur imazhet që ju vijnë në mend kur dëgjoni këto fjalë: "kriminel", "homoseksual", "handikapat". Për shumicën e këtyre fjalëve ju ka ardhur në mendje një imazh i caktuar i njerëzve që u përgjigjen dhe sigurisht ju keni besimet tuaja rreth stilit



të jetesës, vlerave, interesave dhe qëndrimeve të tyre. Gjatë ndërveprimit të parë me dikë që i përket ndonjëres prej këtyre kategorive, ne kemi prirjen t'u përgjigjemi në bazë të pritshmërive tona.

## **Vetëhapja**

Një nga arsyt kryesore për të cilën të tjerët nuk na kuptojnë kur komunikojmë është se ne nuk shprehim plotësisht atë që mendojmë dhe ndiejmë. Ne shpesh mendojmë se deri në çfarë pike duhet të ndajmë me të tjerët mendimet dhe ndjenjat tona. Cila është kostoja dhe çmimi i vetëhapjes?

Vetëhapja është përcaktuar si procesi i zbulimit të qëllimshëm të informacionit rreth vetes sonë që është i rëndësishëm dhe që normalisht nuk do t'i bëhej i ditur të tjerëve. Nëse individët nuk i ndajnë ndjenjat dhe mendimet me të tjerët, kjo do të thotë që ata nuk po komunikojnë hapur ndjenjat dhe mendimet e tyre dhe, për pasojë, nuk kuptohen nga të tjerët. Një marrëdhënie e sinqertë dhe e hapur, e cila konsiderohet e rëndësishme, bazohet te vetëhapja dhe te të pranuarit e tjetrit ashtu siç është.

Megjithatë, përsëri lind pyetja se kur duhet apo nuk duhet të vetëhapemi. Individët duhet të zgjedhin të hapen atëherë kur përfitimet nga vetëhapja i tejkalojnë risqet e mundshme.

Për shembull, terapeuti i grupit duhet të vetëhapet me grupin nëse informacioni që do të japë është terapeutik për anëtarët e grupit. Nëse anëtarët e grupit kanë probleme me alkoolin apo drogën, terapeuti që ndan eksperiencën e tij personale apo familjare në lidhje me pijen mund t'i shërbejë grupit duke rritur afërsinë mes tij dhe anëtarëve. Nga ana tjetër, nëse terapeuti është emocionalisht i përfshirë në një problem të caktuar, nuk duhet të hapet pasi rrezikon që anëtarët ta shohin si klient dhe jo si terapist. Megjithatë, duhet pasur parasysh se niveli i hapjes varet nga vetë individi. Ne mund të zgjedhim kufirin deri ku i lejojmë vetes të hapemi. Mund të zgjedhim të ndajmë disa opinione, ndjenja, mendime apo eksperiencë dhe të rezervohemi në disa të tjera. Duke parë reagimin e marrësit, dërguesi vendos nëse do të ndajë më shumë informacion ose jo.

*Ushtrim: Të ndihesh mirë pas vetëhapjes.*

*Qëllimi - Ky ushtrim ka për qëllim t'ju ndihmojë të kuptoni se si vetëhapja mund të sjellë përfitim.*

*1. Përshkruani një rast në të cilin keni ndarë diçka personale me dikë tjetër dhe jeni ndier mirë pasi e keni bërë këtë. Më pas tregoni pse kjo ju bëri të ndiheshit mirë.*

## **Si të komunikojmë në mënyrë efektive me fëmijët?**

Është e rëndësishme të përpiqemi t'i dërgojmë mesazhet në mënyrë efikase. Më poshtë jepen disa sugjerime për të përmirësuar komunikimin midis dërguesit dhe marrësit.

## **Dërguesi**

Kur mesazhet verbale dhe ato joverbale përputhen, marrësi arrin të interpretojë më mirë informacionet. Mesazhet kontradiktore dërgohen kur mesazhet verbale dhe ato jo verbale nuk përputhen. Nëse i kërkoni fëmijës të veprojë në një mënyrë të caktuar, është mirë të shpjegoni pse. Gjithashtu, është e rëndësishme të specifikoni kërkesën tuaj. Mesazhet evazive apo jo të plota shpesh keqinterpretohen. Zotërojini mesazhet tuaja duke përdorur përemrin vector "Unë" për të

treguar që merrni përgjegjësi të plotë për mendimet dhe ndjenjat tuaja. Kur anëtarët e grupit nuk i zotërojnë mesazhet duke përdorur në vend të përemrit vetor shprehje të tipit "dikush tha" apo "pjesa më e madhe e njerëzve do të ndiheshin..." është e vështirë të përcaktohet nëse ata ndiejnë e mendojnë në atë mënyrë apo thjesht përsërisin mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve. Shoqërimi i mesazheve verbale me foto, me mesazhe të shkruara etj. do ta ndihmonte marrësin të kuptonte më mirë. Gjithmonë kërkoni *feedback* kur nuk ndiheni të sigurt nëse marrësi e ka perceptuar ashtu siç duhet mesazhin. Shpreheni shqetësimin tuaj në mënyrë jofajësuese. Fjalët gjykuese apo vlerësuese i bëjnë fëmijët të vendosen në pozicione mbrojtëse.

Disa nga faktorët që nuk lejojnë që një komunikim të jetë efektiv janë: vendosja e karrigeve në rresht dhe jo në formë rrethore, zhurmat e larta që vijnë nga jashtë, dëgjimi i dobët, temperatura e dhomës jo e përshtatshme, ndriçimi i dobët, karriget e parehatshme dhe koha e pamjaftueshme për të diskutuar çështje të ndryshme. Reduktimi i efektit që kanë këto barriera në komunikim, në përgjithësi, rrit saktësinë e komunikimit midis dërguesit dhe marrësit.

### **Marrësi**

Komunikimi shpesh çalon kur marrësi e merr mesazhin si personal. Në vend që të dalim në konkluzione të gabuara, duhet të bëjmë pyetje për të qartësuar qëllimet dhe arsyetimin e dërguesit. Ky qartësim mund të realizohet duke perifrastuar mesazhin e dërguesit me një pyetje "Po thua që...?" ose "Ti ndien që...?" Është e rëndësishme për komunikimin që ne të flasim vetëm pasi të jemi të bindur për mesazhin e dërguesit. Në zgjedhjen e një argumenti, lideri i grupit mund të përdorë parimin e shkëmbimeve të roleve. Marrësi riformulon idetë dhe ndjenjat e dërguesit me saktësi përpara se të shfaqë këndvështrimet e veta. Marrësi duhet t'i shprehë ndjenjat dhe idetë e dërguesit me fjalët e tij dhe jo t'i përsërisë ato fjalë për fjalë. Përpara se marrësi të aprovojë apo jo mesazhet, duhet ta vërë veten në pozicionin e dërguesit në mënyrë që të kuptojë atë që dërguesi mendon dhe ndien.

### **Aftësia e të dëgjuarit**

Për një komunikim efektiv është i rëndësishëm zhvillimi i mirë i aftësive të dëgjimit; por, ajo që shpesh ndodh është që njerëzit janë shumë të përqendruar te shqetësimet dhe interesat e tyre dhe nuk arrijnë të jenë të vëmendshëm kur të tjerët flasin.

Thomas Gordon ka zhvilluar 4 teknika që kanë për qëllim përmirësimin e komunikimit: dëgjimi aktiv, mesazhet UNË, përplasja e vlerave dhe zgjidhja e problemeve pa humbje.

### **Dëgjimi aktiv**

Dëgjimi aktiv sugjerohet kur jemi duke dëgjuar dikë që flet për një problem, p.sh. anëtarin e një grupi terapie që thotë "jam e shëndoshë dhe e shëmtuar, të gjitha shoqet e mia kanë të dashur, vetëm unë jo". Në situata të tilla Gordon rekomandon që lideri i grupit ose një anëtar tjetër të përdorë dëgjimin e tij. Një nga hapat e parë në dëgjimin aktiv është që marrësi të kuptojë çfarë do të thotë mesazhi ose çfarë ndien dërguesi dhe më pas ta formulojë me fjalët e tij e të marrë konfirmimin e dërguesit. P.sh. një përgjigje aktive dëgjimi ndaj asaj që shpreh anëtarja e grupit mund të jetë "Ti ke

shumë dëshirë të kesh të dashur dhe mendon se arsyeja e vërtetë për të cilën nuk ke është e lidhur me pamjen tënde të jashtme?"

Gordon rendit avantazhet e dëgjimit aktiv. Një nga avantazhet është që lehtëson zgjidhjen e problemit nga personi që e ka problemin. Gjithashtu, duke folur rreth problemit, individi, në vend që vetëm të mendojë për të, ka më shumë mundësi të identifikojë origjinën e problemit derisa të arrijë tek zgjidhja. Kur dikush ndien se të tjerët e dëgjojnë ai/ajo ka shumë të ngjarë t'i dëgjojë ata në të ardhmen. Kjo bën që marrëdhënia në grup të përmirësohet sepse, kur fëmijët ndiejnë që po i dëgjojnë dhe i kuptojnë, ndjenjat e tyre pozitive rriten. Së fundi, dëgjimi aktiv i ndihmon individët të eksplorojnë, të njohin dhe të shprehin ndjenjat.

Kur kjo teknikë përdoret për herë të parë, marrësit mund të bëjnë disa gabime. Një nga këto është përdorimi i saj për të orientuar personin që ka problem drejt zgjidhjes së preferuar nga vetë marrësi.

### **Mesazhet-Unë**

Kur një anëtar i grupit ju kritikon, ju mund të heshtni dhe të ndiheni të irrituar ose t'i dërgoni mesazhe Ti. Ka 2 tipa mesazhesh Ti: "mesazhe zgjidhjeje" dhe "mesazhe zhvlerësuese". "Mesazhi zgjidhjeje" urdhëron, drejton, komandon, paralajmëron, kërcënon, moralizon ose këshillon. "Mesazhi zhvlerësues" fajëson, gjykon, kritikon, tall. Shembuj të mesazhit Ti mund të jenë: "mos e bëj atë", "të urrej", "ti duhet ta dish më mirë". Gordon pohon se mesazhet Unë janë më mirë se mesazhet Ti. Në thelb, mesazhet Unë janë mesazhe jofajësuese që thjesht komunikojnë se si dërguesi i mesazhit beson se marrësi është duke e ndikuar. Mesazhet Unë nuk japin një zgjidhje dhe as nuk kritikojnë. Shembulli në vijim është një format ilustrues lidhur me si mund të formojmë një mesazh Unë: Dërguesi i thotë marrësit "Kur ti ----- (dërguesi identifikon sjelljen irrituese), Unë ndihem ----- (dërguesi përshkruan ndjenjën e tij)".

Mesazhet Ti në përgjithësi janë joproduktive sepse njerëzve nuk u pëlqen të urdhërohen apo kritikohen. Mesazhet Unë komunikojnë më hapur efektin e sjelljes së caktuar. Mesazhet Unë priren të jenë më efektive pasi i ndihmojnë anëtarët e tjerë të grupit të marrin përsipër përgjegjësi për sjelljet e tyre. Ata ndihmojnë në marrëdhënien e anëtarëve midis tyre dhe të anëtarëve me terapistin apo punonjës.

*Ushtrim: Si të përdorim mesazhet Unë*

*Qëllimi - Ky ushtrim ka si qëllim t'ju mësojë të formuloni një mesazh Unë. Përshkruani një mesazh Unë që do të përdornit në rastet e mëposhtme:*

*a) Jeni në kohën e ajrimit dhe një fëmijë ndez cigare. Duke qenë se në institucion nuk lejohet duhani për fëmijët, ju nuk e dëshironi këtë gjë.*

*b. Jeni në makinë me dikë që po e nget atë me shpejtësi dhe në mënyrë të pakujdesshme. Druheni se mund t'ju ndodhë ndonjë aksident.*

*c. Po përpiqeni të flini, është ora 3 pas mesnate dhe në mëngjes keni për të shkuar në punë. Në apartamentin përmbri dikush ndez radion dhe e dëgjon atë me zë të lartë.*

## **Përplasja e vlerave**

Përplasja e vlerave është e zakonshme në punën me fëmijët, midis kolegëve apo midis jush dhe eprorëve. Vlerat që zakonisht ngjallin konflikt përfshijnë ato rreth abortit, sjelljes seksuale, veshjes, fesë, përdorimit të drogave, modelit të prerjes së flokëve dhe zbatimit të detyrave të caktuara.

Gordon pohon se ka tri mënyra konstruktive për të zgjidhur konfliktin e vlerave:

**Mënyra e parë** është të qenët shembull i vlerave që për ty janë më të rëndësishme. Nëse çmon konfidencialitetin, ji konfidencial. Nëse çmon drejtësinë, ji i drejtë. Nëse nuk jeton në pajtim me vlerat që beson, atëherë duhet të ndryshosh vlerat dhe sjelljen tënde. Përputhshmëria midis sjelljes dhe vlerave është e rëndësishme nëse dëshironi të keni një rol efektiv.

**Mënyra e dytë** është të përpiqesh të bëhesh këshillues për anëtarët me të cilët je në konflikt. Ka disa gjëra që duhen bërë dhe disa që nuk duhen bërë për të qenë një këshillues i mirë. Së pari, një këshillues i mirë e pyet fëmijën nëse dëshiron t'i dëgjojë mendimet e tij. Nëse përgjigja është jo, ai nuk jep këshilla sepse fëmija do të reagojë negativisht. Nëse përgjigja është po, atëherë këshilluesi sigurohet që të ketë të gjitha faktet përkatëse. Më pas i ndan ato me fëmijën pasi kështu fëmija mund t'i kuptojë ato. Lejojeni fëmijën të vendosë nëse dëshiron të ndjekë sugjerimet e dhëna. Për të vazhduar këshillimin, fëmija nuk duhet lënë i painformuar por as të ngacmohet për t'i ndjekur udhëzimet menjëherë.

**Mënyra e tretë** për të ulur tensionin rreth temës së vlerave është modifikimi i vlerave. Duke shqyrtuar vlerat e fëmijëve apo dhe të kolegëve mund të kuptosh që ata kanë merita të cilave duhet t'u drejtohesh dhe të mirëkuptosh se pse ata i mbrojnë vlerat e tyre.

*Ushtrim: Gjetja e zgjidhjes kur ka përplasje të vlerave.*

*Qëllimi - Ky ushtrim synon t'ju ndihmojë të identifikoni dhe të zgjidhni konfliktin e vlerave.*

- 1. Përshkruani një situatë në jetën tuaj në të cilën keni pasur një konflikt serioz rreth vlerave me dikë.*
- 2. Përshkruani se si u zgjidh ajo situatë. Nëse situata nuk është zgjidhur, përshkruani çështjet që ende duhet të zgjidhen”.*
- 3. Rishikoni pjesën që flet për konfliktin e vlerave në këtë tekst. A sugjeron kjo pjesë një mënyrë më të mirë për të zgjidhur përplasjen e vlerave që keni përjetuar? Nëse po, specifikoni cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për t'u përdorur.*

## **Komunikimi joverbal**

Është e pamundur të mos komunikosh. Siç jeni tani duke lexuar këtë tekst, ndaloni për një minutë dhe analizoni se çfarë mesazhesh joverbale do të ishit duke transmetuar nëse dikush do të ishte duke ju vëzhguar. A janë sytë tuaj të hapur apo gjysmë të mbyllur? Po qëndroni të qetë apo të tendosur? Çfarë po komunikojnë shprehjet e fytyrës? Mos rastësisht po bëni ndonjë gjest? Çfarë konkluzioni do të nxirrte dikush, po t'ju vëzhgonte, rreth asaj çka ndieni ju në këto çaste?

Veprimet joverbale zakonisht shfaqin ndjenja që një person me qëllim përpiqet të fshehë. Reagimet fizike si djersitja, skuqja në fytyrë dhe rrudhja e ballit apo vetullave nxjerrin në pah zakonisht

praninë e emocioneve të tilla si frika, turpi dhe shqetësimi të cilat përpiqemi t'i fshehim nga të tjerët.

Duke zhvilluar aftësitë e leximit të veprimeve joverbale, punonjësi mund të bëhet më i kujdesshëm për atë çka ndiejnë fëmijët dhe më i aftë për të ndërvepruar me ta në mënyrë më efektive. Veprimet joverbale shprehin atë çka mendojmë dhe ndiejmë.

### **Funksionet e komunikimit joverbal**

Komunikimi joverbal ndërvepron me komunikimin verbal dhe mund të përsërisë, zëvendësojë, theksojë, rregullojë apo kundërshtojë atë që thuhet.

#### **Përsëritja**

Mesazhet joverbale mund të përsërisin mesazhet verbale. Një punonjës mund të theksojë se mezi pret që fëmija të marrë diplomën e shkollës së mesme dhe e përsërit këtë me një shprehje të lumtur në fytyrë.

#### **Zëvendësimi**

Mesazhet joverbale mund të zëvendësojnë mesazhet verbale. Nëse e dimë që një fëmije nuk i kanë ardhur prindërit në takim, edhe pse ai mund të mos flasë për këtë gjë, mund ta marrim me mend se çfarë mendon dhe ndien vetëm duke e vështruar.

#### **Theksimi**

Mesazhet joverbale mund të theksojnë mesazhet verbale. Nëse një fëmijë i thotë dikujt se është i zemëruar dhe i inatosur për diçka që ky dikush ka bërë, ai mund ta theksojë këtë duke drejtuar gishtin nga personi në fjalë. Theksimi dhe përsëritja lidhen ngushtë me njëra-tjetrën edhe pse theksimi vihet më tepër në dukje.

#### **Rregullimi**

Mesazhet joverbale mund të shërbejnë për të rregulluar sjelljen verbale.

#### **Kundërshtimi.**

Mesazhet joverbale mund të kundërshtojnë mesazhet verbale. Një shembull është një person me fytyrë të skuqur e vetulla të ngritura i cili me zë të lartë thotë "I zemëruar, jo drejtin! Çfarë të bën të mendosh se jam i nxehur?". Kur mesazhet joverbale bien në kundërshtim me mesazhet verbale, mesazhet joverbale janë shpesh më të besueshme. Kur një marrës ndesh në një kontradiktë midis mesazheve verbale dhe jo verbale, si i beson mesazhit joverbal që përcillet.

#### **Rreziku i keqinterpretimit**

Mesazhet joverbale mund të shprehin shumë por edhe mund të keqduhëheqin në mënyrë të paqëllimshme. Mendoni rastet në të cilat të tjerët kanë keqinterpretuar mesazhet tuaja joverbale. Ndoshta ju ka ndodhur të mos keni folur shumë kur sapo jeni zgjuar dhe të tjerët e kanë interpretuar sikur keni qenë të shqetësuar apo të zëmëruar. Ndoshta keni anuluar një takim sepse keni qenë të

zënë apo të lodhur dhe kjo është keqinterpretuar si mërzë apo pakënaqësi me marrëdhënien. Ndërsa keni qenë të zhytur në mendime, a keni pasur ndonjëherë një shprehje fytyre që i ka bërë të tjerët të mendojnë se keni qenë të mërzitur? Sjellja joverbale merr shpesh dy kuptime. Një rrudhje vetullash mund të tregojë ndjenja të ndryshme si: zemërim, refuzim, konfuzion, lodhje apo mërzitje. Mesazhet joverbale nuk duhet të interpretohen si fakte por si enigma që zgjidhen në mënyrë verbale për të kuptuar çfarë ndien apo mendon ai që përcjell mesazhin.

*Ushtrim: Interpretimi i shenjave joverbale.*

*Qëllimi - Ky ushtrim ilustron faktin që shprehjet verbale mund të interpretohen saktë por edhe të keqinterpretohen.*

*1) Përshkruani një situatë në të cilën keni interpretuar në mënyrë korrekte shprehjen joverbale të dikujt tjetër.*

*2) Përshkruani një situatë në të cilën keni keqinterpretuar një veprim.*

*3) Kur një veprim joverbal bie në kundërshtim me mesazhin verbal të dikujt, cilin mesazh (verbal, joverbal) jeni të prirur të besoni?*

## MODULI 6

### KONSUMIMI PROFESIONAL

**Të kuptuarit e konsumimit profesional dhe shkaqeve të tij. Simptomat e konsumimit profesional dhe strategjitë personale dhe organizative për ta parandaluar dhe luftuar atë.**

#### PËRMBAJTJA

##### HYRJE

6.1 Konsumimi profesional në përgjithësi dhe në veçanti në stafet e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

6.2 Simptomat e konsumimit profesional.

6.3 Strategjitë personale dhe organizative për të parandaluar dhe trajtuar konsumimin profesional.

##### Objektivat:

- Të kuptojmë fenomenin e konsumimit profesional në përgjithësi dhe në veçanti në stafet e institucioneve të vuajtjes së dënimit.
- Të kuptojmë shkaqet dhe pasojat e konsumimit profesional.
- Të evidentojmë strategjitë personale dhe organizative si dhe teknikat që përdoren për parandalimin dhe trajtimin e këtij fenomeni.

##### Rezultatet e pritura:

Pjesëmarrësi do të mund:

- Të shpjegojë çfarë është konsumimi profesional dhe cilat janë shkaqet e tij.
- Të identifikojë simptomat e konsumimit profesional dhe disa nga strategjitë personale dhe organizative për të parandaluar dhe trajtuar konsumimin profesional.
- Të praktikojë nëpërmjet ushtrimeve disa prej njohurive të mësuara.

Metodologjia : Prezantim në PP, ushtrime.

### Përshkrimi i modulit

Ky modul do t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri mbi konsumimin profesional, shkaqet e tij dhe pasojat në nivelin personal dhe profesional për stafin që punon me të dënuarit/të paraburgosurit. Pjesëmarrësit do të njihen me shenjat dhe simptomat e konsumimit profesional. Ky modul do t'u paraqesë atyre praktika profesionale të tilla si teknikat personale dhe ndërhyrjet administrative si p.sh. supervizimi, të cilat ndihmojnë në parandalimin apo trajtimin e konsumimit profesional. Pjesëmarrësve do t'u jepet mundësia të diskutojnë për njohuritë e marra në këtë modul dhe t'i aplikojnë ato në praktikë.

### Shtjellimi i sesionit:

1. Trajneri/ja e hap seancën duke kërkuar përkufizime personale të bëra nga pjesëmarrësit për konsumimin profesional. Trajneri/ja pastaj shpjegon përkufizimin për konsumimin profesional. Shpjegohen shkaqet dhe simptomat e konsumimit profesional.

2. Pas shpjegimit të konsumimit profesional, shkaqeve dhe simptomave të tij, trajneri/ja organizon leximin e miteve dhe të vërtetave në lidhje me konsumimin profesional. Pjesëmarrësit ftohen të lexojnë mitet ndërsa drejtuesi i seancës lexon të vërtetën dhe e thekson atë.

1. Në fund, trajneri/ja fton pjesëmarrësit të rikujtojnë edhe njëherë çfarë është konsumimi profesional dhe cilat janë shkaqet dhe simptomat e tij. Pjesëmarrësit duhet të identifikojnë disa nga teknikat personale dhe administrative për parandalimin e konsumimit profesional.

Mjetet: Prezantim në PP, ushtrim.

Rreziku i prekjes nga konsumimi profesional (*burnout*) është i lartë veçanërisht në profesionet që përfshijnë punën e drejtpërdrejtë me njerëzit apo klientët. Ndër profesionet më të rrezikuara nga konsumimi profesional është ai i mësuesit, punonjësit social dhe punonjësit të policisë. Punonjësit e burgjeve dhe paraburgimeve janë të rrezikuar nga konsumimi profesional për shkak të punës me "klientë" të vështirë, rreziqeve me të cilat përballen, rutinës së detyrueshme për t'u ndjekur në punë dhe orëve të zgjatura të punës jashtë orarit.

Termi konsumim profesional u përdor për herë të parë në fillim të viteve '70 për të përshkruar pacientë të vendosur në disa institucione të cilët kishin probleme të shëndetit mendor dhe karakterizoheshin nga një lodhje emocionale dhe fizike. Më vonë, termi u përdor edhe për punonjësit të cilët shfaqnin këto simptoma për shkak të ngjarjeve dhe emocioneve që përjetonin në punën e tyre.

Maslach e përkufizon konsumimin profesional si:

"Një sindromë e shterimit emocional, depersonalizimit dhe arritjeve të reduktuara personale që mund të ndodhë ndër individët që punojnë me njerëz. Është një reagim i zgjatur ndaj faktorëve emocionalë dhe ndërpersonalë kronikë të stresit të shkaktuar nga të punuarit në vazhdimësi me njerëzit, veçanërisht me ata që kanë probleme".

Pra, në përgjithësi, konsumimi profesional ka për pasojë tre përfundime:



Së pari, shterimin emocional, mungesën e energjive emocionale për t'i përdorur dhe investuar tek të tjerët.

Së dyti, depersonalizimin, dhënien e përgjigjeve të pashpirta, mungesën e kujdesit ndaj të tjerëve si dhe reagimet jo miqësore ndaj të tjerëve.

Së treti, zvogëlimin e arritjeve personale në të gjitha fushat duke qenë se profesionisti ndihet i shterur, sikur nuk mund të japë më asgjë, dhe vërtet nuk jep asgjë.

Maslach ka nënvizuar se, në përgjithësi, femrat dhe meshkujt përjetojnë të njëjtën përvojë të konsumimit. Femrat përjetojnë më shumë shkatërrimin emocional ndërsa tek meshkujt është më i përhapur depersonalizimi. Profesionistët me statusin e të pamartuarit mund të preken më lehtë nga konsumimi profesional sesa profesionistët që janë të martuar apo që jetojnë me familjarët e tyre. Gjithashtu, profesionistët e rinj janë më të predispozuar të arrijnë në pikën më të lartë të konsumimit në krahasim me ata që kanë më shumë vite pune. Konsumimi profesional është problem individual dhe zgjidhja e tij mund të përkojë me nevojat e vetë individit.

Në lindjen e konsumimit profesional, krahas faktorëve që lidhen me punën, ndikojnë edhe faktorët mjedisorë si: zhurmat, temperaturat, kushtet e papërshtatshme të punës etj. Një fakt tjetër për t'u theksuar është që profesionistët të cilët punojnë me fëmijët janë më lehtësisht të ndjeshëm ndaj kësaj dukurie dhe, nëse konsumimi nuk konstatohet apo adresohet, mund të "infektojnë" edhe profesionistë të tjerë të të njëjtit staf.

### **Konsumimi profesional në stafin e burgjeve dhe paraburgimeve**

Konsumimi profesional është një term psikologjik e biologjik që përkufizohet si një lodhje fizike, emocionale dhe mendore e shkaktuar nga ekspozimi për një kohë të gjatë i individit ndaj situatave apo stresorëve që shkaktojnë lodhje emocionale. Gjithashtu, ai është përkufizuar si një gjendje e natyrshme, e parashikueshme dhe e parandalueshme e cila mund të trajtohet. Më tepër se një gjendje statike, konsumimi profesional është një proces. Kjo gjendje fillon me ekspozimin gradual ndaj stresorëve dhe pastaj fillon të përkeqësohet gradualisht në mënyrë progresive. Konsumimi profesional i pengon profesionistët të jenë më efektivë në punën e tyre.

Punonjësit e burgjeve dhe paraburgimeve janë personat që përpiqen të ndihmojnë të dënuarit dhe t'u shërbejnë atyre në zgjidhjen e problemeve me gjithë kompleksitetin e situatës në të cilën ndodhen. Këta punonjës duhet të besojnë në mundësinë për rritje dhe zhvillim të qenieve njerëzore dhe kapacitetin e tyre për të ndryshuar gjatë gjithë jetës. Profesionit i punonjësit të sistemit të burgjeve/paraburgimeve është një profesion që nuk mund të jetë i përjashtuar nga konfliktet, kështu që ata duhet të jenë të përgatitur për të përballuar strese dhe tensione të ndryshme në punën e tyre. Nëse këta punonjës do t'i dinë që më parë këto probleme, do të jenë më të përgatitur për t'i zgjidhur e do t'i pranojnë më lehtë ato. Çdo punë ose profesion sjell me vete strese apo konflikte të ndryshme. Aftësitë profesionale dalin në pah në mënyrën me të cilën profesionistët i pranojnë këto strese dhe konflikte dhe në gjetjen e mënyrave më të përshtatshme për t'i përballuar ato.

Punonjësit e burgjeve/paraburgimeve punojnë me individë të moshave, gjinive dhe origjinave të ndryshme të cilët kanë probleme nga më të ndryshmet dhe kanë dëmtuar individë apo komunitete me veprën që kanë kryer. Ndodh që një punonjës të ketë një numër të madh të dënuarish të cilëve duhet t'u shërbejë në një kohë të caktuar. Kështu, ai mund të ndihet i mbingarkuar. Ajo çfarë duhet të mbajë parasysh është fakti se ai asnjëherë nuk mund të veprojë përtej kapacitetit të tij. Në këto

raste, ai duhet të përdorë aftësitë profesionale për të vendosur se cilat janë punët apo detyrat që duhen kryer më parë dhe cilat janë ato që mund të presin për një periudhë kohe.

Në praktikë, mes punonjësve të burgjeve dhe paraburgimeve është vënë re rritja e konsumimit profesional e cila përbën një shkak për uljen e motivimit në punë. Studimet tregojnë se mjaft punonjës ndiejnë lodhje emocionale në nivele të tilla që cenojnë përdorimin në mënyrë adekuate të aftësive të tyre profesionale. Në konsumimin profesional të punonjësit të burgjeve/paraburgimeve mund të ndikojnë një sërë faktorësh ndër të cilët më kryesorët janë:

Shpeshherë, punonjësit e burgjeve/paraburgimeve punojnë me individë që kanë probleme të cilat ndikojnë edhe në jetën e punonjësit. Këto probleme shpesh janë intensive, personale dhe të paqëndrueshme. Disa nga këto ndjenja, duke u brendësuar nga punonjësi, i shkaktojnë atij konsumim profesional.

Shumë punonjës kanë ngarkesa të mëdha pune dhe një rutinë të detyrueshme për të ndjekur çdo ditë.

Rreziqet me të cilat përballen punonjësit e burgjeve/paraburgimeve janë të ndryshme. Përpjekja për arratisje, dhuna, grindjet, pengmarrjet, janë situata të rrezikshme me të cilat këta punonjës mund të përballen në punën e tyre.

Në punën në burgje/paraburgime presioni për të pasur maksimumin e efektivitetit pa asnjë problem është i madh. Kjo shkakton shpesh konsumim profesional.

### **Simptomat e konsumimit profesional**

Simptomat e konsumimit profesional janë të shumta dhe ndryshojnë në varësi të shumë faktorëve. Por, gjithë këto simptoma do t'i kategorizojmë në tre grupe: simptomat emocionale dhe psikologjike, simptomat konjitive dhe simptomat fizike.

#### *Simptomat emocionale/psikologjike*

Këto lloj simptomash nuk ndikojnë vetëm gjatë punës që jeni duke bërë por edhe në marrëdhënie dhe ndërveprime të tjera. Ato janë:

Depresioni: të ndierët emocionalisht i lodhur, mospërfshirja në aktivitetet e punës dhe ato shtëpiake, ndeshja me ndjenja të tilla si humbja dhe mospasja e shpresës, të bërit gradualisht negativ dhe cinik dhe të menduarit rreth vetëvrasjes.

Ankthi: Ankthi i vazhdueshëm mund të çojë në hipervigjilencë, parandjenja të pabazuara të fatkeqësive, mendime obsesive, vështirësi në përqendrim, paaftësi për të fjetur dhe reduktim të tolerancës.

Simptoma të tjera emocionale/psikologjike janë edhe:

Shterimi emocional

Shkëputja

Izolimi

Irritueshmëria

Frustracioni

Ndjenja e dështimit

Ndjenja e të qenit i zënë në kurth

Dëshpërimi

Cinizmi

Apatia

### **Simptomat konjitive**

Këto simptoma mund të çojnë në një rritje të abstinencës dhe/ose në uljen e produktivitetit.

Më konkretisht, disa prej këtyre simptomave janë:

Ulja e vëmendjes në detyrë

Paaftësia për t'u përqendruar

Kujtesa shumë e dobët

Reduktimi i aftësive të zgjidhjes së problemit

Humbja e kreativitetit

Humbja e interesit

### **Simptomat fizike**

Personat që hasin sindromën e konsumimit profesional mund të përjetojnë këto simptoma fizike:

Sëmundje: probleme të natyrës kardiovaskulare (rritje të tensionit); probleme të natyrës dixhestive (diarre dhe dhimbje stomaku); dhimbje qafe dhe shpine (për shkak të tensionit i cili nuk është i qëndrueshëm); disfunkcionim seksual etj.

Pagjumësi ose përgjumje të vazhdueshme: kjo vjen si pasojë e lodhjes kronike dhe e nivelit të ulët të energjisë.

Mbingrënie: kjo është një formë e kujdesit për veten. Ka një efekt shumë qetësues që vjen si rezultat i lëvizjes së gjakut nga truri drejt organeve të tjera të trupit.

Humbje të pëlqimit të ngrënies dhe preferencë për substanca që ulin nivelin e ankthit dhe rrisin meditimin. Disa nga këto substanca janë: alkooli, kafeina, nikotina, substancat narkotike.

Probleme të cilat ndeshen shpesh tek punonjësit e burgjeve/paraburgimeve dhe që mund të vijnë nga konsumimi profesional janë:

- Përdorimi i alkoolit
- Tentativat për vetëvrasje
- Vetëvrasja

### **Faktorët që ndikojnë në konsumimin profesional**

- Psikologjia individuale dhe struktura e personalitetit: vetëvlerësimi i ulët dhe mosnjohja e pikave të forta, dobësive dhe kufijve të vetvetes
- Mjedisi i punës: ngarkesa në punë, rolet e dyfishta si dhe konflikti i roleve
- Marrëdhëniet me kolegët dhe suprvizorët
- Vendosija e qëllimeve jorealiste
- Të priturit e shumë gjërave nga shumë njerëz
- Të bërit e një pune që shtyn në mënjanimin e vlerave personale
- Të bërit e një pune që nuk ndryshon dhe që nuk është sfiduese
- Të ndërjetit i mbërthyer në një vend pune vetëm për arsye ekonomike etj.

### **Fazat e konsumimit profesional janë katër:**

1. Entuziazmi: personi e fillon punën me shpresa dhe pritshmëri realiste
2. Stanjacioni: kur krijohet një përshtypje më e qartë për natyrën e punës, personi ndien që nuk po realizon interesat e tij financiare, personale apo ato që lidhen me karrierën.
3. Frustracioni: personi fillon vlerëson efikasitetin, vlerat ose impaktin e përpjekjeve të tij ose të saj përkundrejt pengesave të panumërta që ka përballë
4. Apatia: personi fillon e shfaq një indiference kronike për situatat që po kalon

### **Roli i suprvizorit, parandalimi dhe shmangia e konsumimit profesional**

Suprvizori është një anëtar administrativ i stafit autoriteti i të cilit konsiston në drejtimin, koordinimin, rritjen dhe vlerësimin e punës së kryer nga personat e suprvizuar. Roli i suprvizorit është të mbështesë, të inkurajojë, të japë informacion dhe të dëgjojë punonjësit, veçanërisht të rinjtë dhe ata pa eksperiencë. Suprvizorët e aftë u vënë rëndësi dobësive të njohurive dhe dallimeve në aftësitë e punonjësve dhe i ndihmojnë ata të kontrollojnë veten e sidomos paanshmërinë në punën e tyre. Ata ndihmojnë në uljen e ankthit dhe ofrojnë mbështetje duke treguar interes dhe mirëkuptim.

Supervizorët janë modele profesionalizmi për punonjësit e rinj dhe urë lidhjeje për organizatën duke ofruar bashkëpunim mes punonjësve të rinj dhe punonjësve më me eksperiencë që vijnë nga institucione të tjera.

Levy, duke folur për supervizorin, përshkruan në mënyrë të qartë kontributin e tij. Kështu, sipas tij, supervizori, në bazë të rolit që i është caktuar në institucion dhe në bazë të marrëdhënieve me të cilat ai e realizon këtë rol, ndihmon të supervizuarin të bëjë një punë më të mirë për institucionin dhe të bëhet një punonjës kreativ dhe i efektshëm. Në procesin e supervizionit, supervizorët ndihmojnë të supervizuarit të marrin përsipër përgjegjësi më të mëdha brenda të njëjtit institucion apo brenda sistemit.

Duke qenë se procesi i supervizimit është një proces i ndërlikuar, edhe veprimet që duhet të kryejë supervizori duhet të jenë sa më efektive për të supervizuarin. Roli i supervizorit në praktikën e punës është që jo vetëm të sigurojë punonjësën lidhur me atë që bën por edhe të lejojë shqetësimin emocional të ndahet brenda një mjedisi të sigurt, siç është marrëdhënia mes supervizorit dhe të supervizuarit, në të cilën mund të mësohet, kritikohet, konfrontohet dhe mbijetohet.

Prandaj, supervizori ka një influencë të konsiderueshme, direkte apo indirekte, mbi punonjësën dhe jetën profesionale të tij dhe mund të jetë një nga shkaktarët apo ndihmuesit kryesorë të konsumimit profesional nëpërmjet burimeve të pushtetit që zotëron si autoriteti i caktuar administrativ, roli i mediatorit apo ndërmjetësit në marrëdhëniet mes të supervizuarit dhe institucionit, roli që ka në punësimin dhe pushimin nga puna të të supervizuarit, kontrolli mbi pagën dhe rritjen në detyrë, të pasurit e më shumë njohurive praktike se i supervizuarit. Supervizori pret por nuk kërkon që i supervizuarit të tregojë më shumë rreth vetes së tij gjatë marrëdhënies që ata kanë gjatë supervizimit. Influenca e supervizorit i kalon njohuritë e të supervizuarit.

Konsumimi profesional ul produktivitetin dhe shteron energjitë duke lënë një ndjenjë të mungesës së shpresës, pafuqi dhe cinizëm. Rastet e konsumimit profesional mund të kërcënojnë punën me të tjerët dhe shëndetin. Nëse ndodh menjëherë, konsumimi profesional është i vështirë të luftohet ndërsa nëse kapet në gjysmë të rrugës mund të parandalohet. Është e rëndësishme të njohësh shenjat e hershme të konsumimit profesional në mënyrë që ta parandalosh atë. Themelet e konsumimit profesional janë tek stresi; sa më shpejt t'i njohësh simptomat e stresit dhe t'i adresosh ato, aq më të mëdha janë mundësitë për ta parandaluar konsumimin profesional. Nëse po përjeton një konsumim profesional dhe ky konsumim shprehet me irritim, mund ta gjesh veten shumë nervoz dhe duke bërë titur. Nëse konsumimi manifestohet me depresion, ti do të duash të flet gjatë gjithë ditës dhe do të jesh shumë i lodhur për t'u marrë me aktivitetet e ditës, do të përfshihesh në sjellje të tilla si përdorimi i alkoolit dhe drogave apo do të bësh shpenzime tërë ditën për të shpëtuar nga ndjenjat negative. Gjithashtu, marrëdhëniet e tua në punë dhe në jetën personale mund të fillojnë të lihen mënjanë; mund të humbasësh besimin tek të tjerët duke besuar që njerëzit janë egoistë dhe ti nuk mund të bësh asgjë për këtë. Prandaj, një nga funksionet kryesore të supervizorit është ai mbështetës i cili duhet të jetë një burim ndihme për diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve individuale.

Disa nga karakteristikat që duhet të ketë një supervizor efektiv në punën e tij me punonjësën janë:

- Zotërimi i njohurive dhe aftësive të duhura, në mënyrë që ta ndihmojë të supervizuarin të zhvillojë më tej njohuritë e tij.
- Aplikimi i politikës së dyerve të hapura: supervizori e ka derën vazhdimisht të hapur për të supervizuarin në mënyrë që ai të hyjë të bëjë pyetje e të marrë ndihmë.

- Përkushtimi ndaj supervizionit: supervizorët e aftë kanë një interes dinamik për institucionin, për veten e tyre dhe për të supervizuarin. Kjo gjë nuk duhet të jetë artificiale ose sipërfaqësore; i supervizuari duhet të ndiejë që ky interes është i vërtetë. Shprehja e këtij interesi mund të bëhet faktor pozitiv motivimi dhe mund të shërbejë për rritjen e aftësive dhe dijeve të të supervizuarve.

- Sinqeriteti: supervizorët efektivë janë pa paragjykime dhe të hapur.

- Shfaqja e vlerësimit dhe dhënia e aprovimit; veçanërisht punonjësit e rinj kanë nevojë për aprovim dhe vlerësim. Qëndrime të tilla pozitive mund të rrisin motivimin dhe zhvillimin profesional.

Shumë studime sot rekomandojnë strategji dhe mënyra për parandalimin pasojave të konsumimit profesional. Strategjitë për parandalimin e konsumimit profesional janë individuale, organizative dhe sociale.

#### Strategjitë individuale:

- Vendosja e qëllimeve realiste, si lidhur me rolin e profesionistit në mjedisin e punës ashtu edhe në punën e drejtpërdrejtë me të dënuarin.

- Përqendrimi në pikat e forta, aftësitë dhe burimet e të dënuarit, gjë që zvogëlon mundësitë e konsumimit të punonjësit.

- Edukimi i vetes, vetëdija, të kuptuarit dhe njohja e mirë e vetes

- Të pranuarit e ndjenjave

- Njohja e kufijve të vetvetes

- Administrimi i mirë i kohës

- Kontrolli i ankthit

- Aftësia për të menduar në një perspektivë të gjerë

- Aftësitë empatike

- Të menduarit nga një këndvështrim pozitiv dhe optimist

- Ndërtimi i një sistemi social mbështetës. Ky është vendimtar në uljen e mundësisë së arritjes në konsumim.

#### Strategjitë organizative dhe sociale:

- Zhvillimi i programeve të trajnimit me ndihmën e supervizorit: nëpërmjet trajnimeve ai u jep mundësi anëtarëve të stafit të kuptojnë më mirë rolin e tyre, të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të rrisin kapacitetin e të kuptojnë përgjegjësitë e tyre.

- Politikat e institucionit: krijimi i një sistemi social përkrahës nga kolegët dhe supervizorët.

- Puna në ekip: zgjidhja e problemeve në nivel grupi mund të ndodhë që të reduktojë ndjenja të tilla si pamundësia për të ndihmuar veten ose izolimi.
- Ndërgjegjësimi i supervisorëve dhe bashkëpunëtorëve të cilët, në shumicën e rasteve, janë personat e parë që konstatojnë konsumimin profesional të të tjerëve dhe, në të njëjtën kohë, ofrojnë rrugën dhe mënyrat për zbutjen ose parandalimin e tij. Supervisorët janë ata që marrin vendime për numrin e orëve të punës, numrin e rasteve, lejet ose pushimet, prandaj është e rëndësishme që ata të kuptojnë rëndësinë e këtyre faktorëve që mund të ndikojnë në parandalimin e konsumimit profesional.
- Ofrimi i një varieteti aktivitetesh në punë nga ana e supervisorit.
- Zhvillimi i një sistemi mbështetës midis anëtarëve të stafit.

### **Në vendin e punës supervisorët duhet:**

Të kenë marrëdhënie ndihme dhe bashkëpunimi.

Të mbajnë të hapur linjën e komunikimit ndërmjet anëtarëve të stafit.

T'u ofrojnë punonjësve *feedback* pozitiv.

Të krijojnë besimin se supervisorët janë mbështetës të anëtarëve të stafit.

Të krijojnë mundësi që herë pas here anëtarët e stafit të kenë ditë pushimi.

Të ketë një agjendë të ekuilibruar, me afate kohore të përcaktuara.

Të ndihmojë në zhvillimin e njohurive dhe shprehive të anëtarëve të stafit duke lexuar literaturën profesionale, përmes ndarjes së eksperiencave etj.

Përveç strategjive më sipër, disa faktorë të tjerë që lidhen me motivimin në punë, menaxhimin e kohës dhe aftësitë e komunikimit mund të rrisin ose zvogëlojnë konsumimin profesional.

1. Motivimi në punë zvogëlon konsumimin profesional. Punonjësit që kanë jetë të stabilizuar personale, dinë të menaxhojnë kohën, kanë mbështetje administrative, shohin mundësinë e ngritjes në detyrë, janë të qartë për përgjegjësitë dhe autoritetin, kanë miratim dhe vlerësim të punës, punojnë në ekipe dhe kanë mundësi për arritje janë ata që rrezikohen më pak nga konsumimi profesional.
2. Ndarja e punës dhe bashkëpunimi me të tjerët ndikon në parandalimin e konsumimit profesional.
3. Zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme sociale nga institucioni dhe supervisorit, i udhëtimeve, i *workshop*-eve dhe i trajnimeve të ndryshme për zhvillimin e njohurive si dhe kontakti me literaturën bashkëkohore ndihmojnë në parandalimin e konsumimit profesional.

4. Kushtimi i vëmendjes, kohës dhe kujdesit vetes dhe familjes ndihmon në parandalimin e konsumimit profesional.
5. Kërkimi i ndihmës tek supervizori: kjo e ndihmon punonjësën të shprehë ndjenjat, mendimet e shqetësimet që ka dhe të ndiejë një çlirim si dhe të marrë këshillim.
6. Komunikimi efektiv ndihmon në zgjidhjen e konflikteve: t'u bësh të mundur njerëzve të kuptojnë çfarë pret ti prej tyre si dhe të mësosh çfarë ata presin prej teje. Të qenët i qartë në atë që thua dhe mënyra me të cilën e thua ndihmojnë në parandalimin e konsumimit profesional.
7. Krijimi i një marrëdhënieje sa më të mirë me bashkëshortin/en apo partnerin/en, fëmijët dhe miqtë, hapja me ta: kjo ndihmon në largimin e një sërë emocioneve negative dhe të simptomave psikologjike të konsumimit profesional.
8. Punonjësit që janë të prekur nga konsumimi profesional këshillohen të merren me aktivitet fizik, të ushqehen shëndetshëm dhe të konsumojnë ujë, gjë që ndihmon në menaxhimin e stresit dhe rrjedhimisht edhe në reduktimin e konsumimit profesional. Pushimi i mirë, gjumi dhe planifikimi i aktiviteteve për kohën e lirë janë faktorë që ndihmojnë gjithashtu në këtë drejtim.

Shpesh rekomandohen edhe teknikat e menaxhimit të stresit që përfshijnë:

- Teknika relaksuse
- Joga
- Ushtrime të frymëmarrjes
- Ushtrime fizike

### **Përfundime**

Konsumimi profesional është një fenomen si psikologjik ashtu edhe biologjik. Është një shterim emocional dhe fizik i shkaktuar nga një stres i tepërt dhe i tejzgatur. Fenomeni i konsumimit profesional prek më shumë punonjësit e arsimit, shëndetësisë, profesioneve ndihmëse (psikologjia dhe puna sociale) dhe vihet re dukshëm edhe në profesionin e punonjësit të burgjeve/paraburgimeve duke qenë se është një profesion që mbart shumë ngarkesë emocionale. Konsumimi profesional mund të shkaktohet nga stresorë të natyrave dhe kategorive të ndryshme. Ai mund të prekë si femrat ashtu edhe meshkujt. Më të rrezikuar ndaj këtij fenomeni janë punonjësit e rinj sesa punonjësit me eksperiencë.

Konsumimi profesional mund të sjellë si pasoja fizike ashtu edhe emocionale e të sjelljes. Mund të përmendim humbjen në peshë, pamundësinë për të ndihmuar vetveten, zemërimin, depresionin, ankthin, ndjenjat e fajit, agresivitetin, abuzimin me drogën, dëshirën për të mos vajtur në punë, komunikimin e dobët me të tjerët etj.

Një rol të rëndësishëm në parandalimin e konsumimit profesional luan edhe supervizori. Për parandalimin dhe trajtimin e konsumimit profesional përdoren një sërë strategjish ndër të cilat mund të përmendim strategjitë individuale, strategjitë organizative dhe sociale si dhe teknikat e relaksimit.



## **KAPITULLI: DREJTËSIA RESTAURUESE**

### **MODULI 1**

#### **DREJTËSIA RESTAURUESE E ORIENTUAR NGA TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN**

##### **Hyrje**

**1.1** Të kuptuarit e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese.

**1.2** Të kuptuarit e qëllimeve të ndërmjetësimit midis viktimës dhe të akuzuarit kur janë të përfshirë të mitur

### **MODULI 2**

#### **PROCESI I NDËRMJETËSIMIT NË ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE**

##### **Hyrje**

**1.1** Analiza e procedurës së ndërmjetësimit dhe e hapave që duhet të ndiqen

**1.2** Dhënia e njohurive përmes demonstrimit të rolit lehtësues të ndërmjetësit në procesin e ndërmjetësimit të konflikteve ku përfshihen të mitur.

## **MODULI 1**

### **DREJTËSIA RESTAURUESE E ORIENTUAR NGA TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN**

*(Ndërmjetësimi Viktimë-Kundërvajtës)*

#### Objektivat

- Të kuptuarit e konfliktit dhe situatave konfliktuale si pjesë e jetës
- Përcaktimi i qëndrimeve ndaj konfliktit
- Të kuptuarit e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese
- Të kuptuarit e qëllimeve të ndërmjetësimit midis viktimës dhe të akuzuarit kur janë të përfshirë të mitur
- Njohja me eksperiencën shqiptare në fushën e drejtësisë restauruese për të miturit në kontakt me ligjin

#### Rezultatet e pritura

- Informimi dhe aftësimi i punonjësve të sektorit të edukimit dhe shërbimit policor në institucione të mbyllura (burgje), të cilët merren me edukimin dhe trajtimin e të miturve në këto institucione, në identifikimin, analizimin dhe menaxhimin e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve të natyrave të ndryshme.
- Aftësimi për t'u përfshirë në programe restauruese për të miturit të cilët vuajnë dënimin në institucione të mbyllura dhe, në mënyrë të veçantë, qartësimi i modelit viktimë-kundërvajtës.
- Rritja e njohurive të pjesëmarrësve rreth instrumenteve ndërkombëtare të administrimit të drejtësisë restauruese për të miturit dhe mundësisht aplikimi në institucionet ku ata punojnë.

#### Metodologjia

Organizim ndërveprues i seancës me pjesëmarrje aktive, diskutime në grup bazuar në raste konkrete konfliktesh ku janë përfshirë të mitur, prezantim me PowerPoint, lojë me role etj.

#### Përshkrimi i modulit

Moduli nis me përshkrimin e konfliktit dhe situatave konfliktuale me të cilat individit në përgjithësi dhe veçanërisht të miturit ballafaqohen në jetën e përditshme.

#### **Konfliktet dhe mosmarrëveshjet si pjesë e jetës**

Konfliktet janë pjesë e rëndësishme, e natyrshme, e pandashme dhe e pashmangshme e jetës dhe veprimtarisë së çdo individit, të grupeve sociale dhe të shoqërisë në tërësi.

Njerëzit, duke qenë në marrëdhënie dhe bashkëveprim të vazhdueshëm, ballafaqohen në çdo moment me konflikte dhe mosmarrëveshje të llojeve të ndryshme.

### **Përkufizimet e konfliktit**

Në literaturën mbi analizën e konflikteve gjenden përcaktime të shumta me nuanca të ndryshme por që në thelb shprehin një situatë në të cilën dy ose më shumë individë ose grupe sociale që ndërveprojnë, duke pasur qëllime jo të ngjashme dhe koncepte të papajtueshme mes tyre, bien në mosmarrëveshje.

Konflikti mund të përkufizohet si një situatë në të cilën elementë që duken të papajtueshëm ndërmjet dy apo më shumë palëve të përfshira në të ushtrojnë forcë në drejtime të kundërta ose divergjente. Këto forca divergjente krijojnë tensione por jo domosdoshmërisht armiqësi apo luftë. Fjala “konflikt” jo domosdoshmërisht do të thotë betejë! Konflikti mund të jetë i heshtur dhe i pashprehur. Ai thjesht nënkupton që palët janë në opozitë.

Një pjesë tjetër e studiuesve të konfliktit, kur përpiqen të japin një përkufizim të tij, e vënë theksin në sjelljen e pjesëmarrësve në konflikt; të tjerë tentojnë të përqendrohen në shkaqet e konfliktit ose në përjetimet dhe ndjenjat që shoqërojnë një situatë konfliktuale.

Çështja kryesore që shtrohet përpara teoricienëve dhe praktikienëve është se si mund të menaxhohen pozitivisht dhe në mënyrë paqësore konfliktet, si mund të orientohen ato drejt në kahun pozitiv dhe të shndërrohen në forca konstruktive duke mënjanuar tendencën destruktive.

### **Aspekti kulturor i konfliktit**

Kultura e konfliktit u referohet normave specifike kulturore, praktikave dhe institucioneve që lidhen me konfliktin në shoqëri. Kultura përcakton atë çka njerëzit vlerësojnë dhe atë për çka ata janë të prirur të hyjnë në diskutime. Ajo sugjeron mënyrat e duhura të sjelljes dhe u jep formë niveleve të komunikimit. Gjithashtu, kultura ndikon mbi atë për të cilën njerëzit luftojnë dhe mbi mënyrën me të cilën ata sillen.

Kultura ndikon në sjelljen konfliktuale dhe konflikti mund të kuptohet edhe si një sjellje kulturore. Të gjitha llojet e konflikteve ndodhin në një kontekst kulturor i cili i jep formë rrjedhës së konfliktit.

Kultura e konfliktit përmbledh vlerat më thelbësore të shoqërisë dhe pasqyron konfliktet në fazën fillestare që kanë favorizuar disa individë dhe grupe kundrejt të tjerëve.

Çështje kryesore për kulturën e konfliktit janë interesat sociale, kulturore dhe interpretimet psikokulturore.

### **Dy anët e konfliktit**

Konfliktet dhe mosmarrëveshjet gjenden në të gjithat komunitetet njerëzore dhe reagimet ndaj situatave konfliktuale janë të ndryshme në kultura, grupe dhe individë të ndryshëm. Pse shfaqen reagime të caktuara në situata të veçanta? Cilat janë pasojat për palët dhe komunitetet e tyre përkatëse kur shfaqen reagime të ndryshme?

Studiuesit e menaxhimit të konfliktit i kanë shqyrtuar këto pyetje dhe kanë tentuar të na japin përgjigje. Ata që analizojnë konfliktin na kanë treguar shumë për rrënjët dhe evoluimin e konflikteve por shpesh i kanë kushtuar shumë më pak vëmendje mënyrës se si përfundojnë mosmarrëveshjet, mënyrës se si veprimet alternative të palëve mund të çojnë në përfundime të tjera dhe pasojave që marrëveshjet mes palëve kanë mbi marrëdhëniet ndërgrupore pasuese. Në dallim me këtë, kërkimet në fushën e zgjidhjes së konflikteve i kushtojnë vëmendje pikërisht mënyrave të zgjidhjes së konflikteve dhe teknikave për menaxhimin e tyre në një sërë situatash.

Trajtimi i konfliktit si i tillë, i burimeve, tipareve dhe pasojave të tij, nuk vlerësohet si ndonjë qëllim në vetvete në procesin trajnues. Por, ky trajtim, është i lidhur ngushtë me mundësinë e menaxhimit, trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit.

### **Në analizën e konfliktit dallohen qartë:**

Palët në konflikt

Sjelljet konfliktuale

Interesat konfliktuale

### **Dukuri që shoqërojnë konfliktet**

#### *Karakteri konkurrues*

Palët vihen përballë njëra-tjetrës sepse përcaktojnë dhe synojnë qëllime të kundërta të cilat nuk kanë mundur t'i arrijnë në të njëjtën kohë. Megjithatë, këto qëllime ose synime jo gjithmonë janë në kundërvënie. Kështu pra, për palët ekziston mundësia e shmangies së ballafaqimit apo konfliktimit me njëra-tjetrën.

#### *Perceptimi i njëanshëm*

Gjatë shkallëzimit të konfliktit, perceptimi i veprimeve të njëjës apo tjetrës palë është disi i njëanshëm ose i shtrembëruar. Procesi i të menduarit të palëve në konflikt është tejet i ngarkuar. Ato përpiqen, secila në mënyrën e vet, që t'u japin të drejtë veprimeve që kryejnë dhe të quajnë të gabuara veprimet e palës tjetër.

#### *Ngarkesa emocionale*

Sa më shumë shkallëzohet konflikti, aq më shumë palët zhyten në zemërim dhe vuajtje duke bërë që emocionet të ndrydhin mendimin.

#### *Komunikimi i pamjaftueshëm*

Gjatë fazave nëpër të cilat kalon konflikti kemi një zvogëlim gradual të komunikimit i cili, në pikën më të lartë të shkallëzimit, mund të shkojë deri në ndërprerje. Në këtë fazë, palët parapëlqejnë të komunikojnë me një palë të tretë dhe jo me njëra-tjetrën.

#### *Mjegullimi i problemit*

Me kalimin e kohës, fillon të mjegullohet problemi tek i cili qëndron konflikti dhe t'i mbivendosen atij çështje të tjera anësore. Kjo e bën më të paqartë shkaku e konfliktit dhe më të vështirë zgjidhjen e tij.

#### *Mendimi ngurtësohet*

Me thellimin e konfliktit, zvogëlohen hapësirat e të menduarit dhe të të gjykuarit tolerant tek palët. Përgjithësisht, vihet re prirja për ta ndërlikuar më tej problemin themelor të konfliktit duke e trajtuar atë me një vizion "bardhë e zi".

#### *Zmadhimi i dallimeve dhe zvogëlimi i ngjashmërive*

Në procesin konfliktual ekziston prirja për të theksuar të gjitha momentet që i dallojnë palët në konflikt duke minimizuar ndërkohë tej mase të gjitha ngjashmëritë dhe pikat e përbashkëta.

**Diskutime në grup dhe ushtrime** për identifikimin e objektit, elementëve dhe palëve në konflikt.

### **Ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese për të miturit në kontakt me ligjin**

*(Instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë proces dhe legjislacioni shqiptar)*

Ndërmjetësimi konsiderohet një alternativë për zgjidhjen e konfliktit ndërmjet dy apo më shumë palëve; ai bëhet në praninë e një personi të tretë, asnjans dhe të pavarur, që është ndërmjetësi.

Ndërmjetësimi si një metodë jashtëgjyqësore, që synon në arritjen e një marrëveshjeje midis palëve të konfliktuara, mund të realizohet në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale, d.m.th. në fazën e hetimit të veprës penale, gjatë procesit gjyqësor si dhe pas dhënies së vendimit, gjatë kryerjes së dënimit në sisteme të mbyllura (burgje) dhe gjatë shërbimit të provës.

Forma alternative e zgjidhjes së konflikteve penale është veçanërisht e rekomandueshme për të miturit në kontakt me ligjin. Për këtë qëllim, janë hartuar disa instrumente ndërkombëtare që nxisin këtë proces, duke nisur nga rekomandimet për devijimin e rasteve nga procedurat tradicionale penale e deri tek mundësia e përfshirjes së të miturve në programe restauruese.

Kështu, devijimi i rasteve penale ku janë të përfshirë të miturit është një nga Rekomandimet e miratuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në të cilin u kërkohet qeverive të vendeve anëtare që, nëse është e nevojshme, të rishikojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre në lidhje me devijimin e rasteve në ndërmjetësim duke theksuar:

...nxitjen e zhvillimit të procedurave të devijimit (shmangien e procedimit penal) dhe ndërmjetësimit në nivel prokurorie, apo në nivel policie në vendet ku policia ka funksionet e prokurorisë, me qëllim që të parandalohet hyrja e të miturve në sistemin e drejtësisë penale dhe vuajtja nga ana e tyre e pasojave që rrjedhin prej kësaj... (Rekomandimi nr. R(87)20, Miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 17 Shtator 1987. Paketa e Rekomandimeve të Këshillit të Evropës në lidhje me administrimin e drejtësisë restauruese, fq. 18, Tiranë 2007).

Sipas Rekomandimit nr. R(99)19 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës ndërmjetësimi në çështjet penale është:

...një proces me anën e të cilit viktimës dhe kundërvajtësit u mundësohet, me pëlqimin e të dyja palëve, të marrin pjesë në mënyrë aktive në zgjidhjen e çështjeve që lindin nga krimi, nëpërmjet ndihmës së një pale të tretë asnjënjëse (ndërmjetësit). (Paketa e Rekomandimeve të Këshillit të Evropës në lidhje me administrimin e drejtësisë restauruese, fq. 72, Tiranë 2007).

Në bazë të ligjit nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”:

...ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjënjëse (ndërmjetësi), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

Në mënyrë të veçantë, në legjislacionin shqiptar tregohet kujdes për ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit për të miturit e përfshirë në vepra penale.

Në nenin 2, pika 4/a, të ligjit për ndërmjetësimin, ku flitet për fushat e zbatimit, ligjvënësi shprehet se:

...gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht por pa e kufizuar vetëm me to, të mosmarrëveshjeve a) në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve.

Metoda alternative e zgjidhjes së konflikteve penale rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe veçanërisht nga Kodi i Procedurës Penale. Rregullimet e bëra konsiderohen si të pamjaftueshme, veçanërisht për të miturit të cilët kryejnë kundërvajtje ose vepra penale. Për këtë qëllim, janë kërkuar ndryshime në Kodin e Procedurës Penale për të bërë harmonizimet e duhura në mënyrë që ligji për ndërmjetësimin të jetë i zbatueshëm.

Në zgjidhjen me ndërmjetësim të konflikteve penale, një rol të rëndësishëm ka sistemi gjyqësor shqiptar. Në traditën e legjislacionit vendas është pranuar e drejta e gjykatës si dhe detyrimi i saj për të ftuar palët për ndërmjetësim. Kështu, gjykata mund ta bëjë këtë për rastet penale të parashikuara në nenin 59 dhe 284 të KPP.

- Duke iu referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, për një kategori rastesh penale të tilla si rrahja, plagosja e rëndë nga pakujdesia, plagosja e lehtë nga pakujdesia, dhunimi i banesës, shpifja dhe disa raste të tjera, i dëmtuari (viktima) ka të drejtë të paraqesë kërkesë drejtpërdrejt në gjykatë për fillim të çështjes penale dhe të marrë pjesë në gjykim si palë, për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Bazuar në Kodin e Procedurës Penale për rastet e mësipërme, gjykata fton së bashku viktimën dhe të akuzuarin dhe u propozon të zgjidhin çështjen me ndërmjetësim. Nëse i dëmtuari, viktima, bindet të tërheqë kërkesën për procedim penal dhe ai që akuzohet e pranon këtë tërheqje, gjykata vendos pushimin e çështjes dhe palët në konflikt i drejtohen ndërmjetësimit.

- Gjithashtu, në nenin 284 të Kodit të Procedurës Penale janë përcaktuar edhe rastet e konflikteve penale për të cilat procedimi penal fillon nga prokuroria ose policia gjyqësore vetëm duke u bazuar në ankimin e viktimës (të dëmtuarit) ndaj të akuzuarit, e cila mund ta tërheqë

ankimin duke iu drejtuar ndërmjetësimit në çdo fazë të procedimit. Këto raste janë plagosja e lehtë pa dashje, vrasja nga pakujdesia, fyerja e shpifja për shkak të detyrës etj.

Ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit në çështjet penale konsiderohet ndryshe si **drejtësi restauruese** ose **praktikë restauruese**.

Drejtësia restauruese është një proces në të cilin viktimat dhe kundërvajtësit dhe, kur shihet e arsyeshme, çdo individ tjetër ose anëtar i komunitetit që është prekur nga krimi marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për zgjidhjen e çështjeve që lindin nga krimi, përgjithësisht me ndihmën e një personi të tretë që është ndërmjetësi. (Parimet bazë të Kombeve të Bashkuara lidhur me Përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese për Çështjet Penale. Paketa e Rekomandimeve të Këshillit të Evropës në lidhje me administrimin e drejtësisë restauruese, fq. 111 Tiranë 2007). Zbatimi i drejtësisë restauruese dhe shërbimit të ndërmjetësimit për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin është një formë e re bashkëkohore e trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit. Thelbi i kësaj zgjidhjeje konsiston në riparimin e dëmeve dhe pasojave negative që shkaktohen nga një konflikt ose situatë konfliktuale, dëme të cilat prekin palët e përfshira në konflikt, familjet e tyre dhe mjedisin social ku ata jetojnë dhe punojnë. Rrjedhojat negative që shkaktohen nga konfliktet me natyrë penale tek të miturit dhe të rinjtë janë të natyrave të ndryshme si ankth, stres, pasiguri, frikë etj.

Modeli viktimë-i akuzuar-ndërmjetësim përbën një nga format e zbatimit të drejtësisë restauruese dhe aplikohet si për të miturit në konflikt me ligjin ashtu edhe për moshat e rritura. Modeli konsiston në devijimin e rastit të konfliktit nga shqyrtimi në një proces penal tradicional në programe restauruese dhe konkretisht në ndërmjetësim, ku palët (në rastin e të miturve) ftohen të gjejnë zgjidhjen përmes komunikimit duke arritur konsensusin dhe pajtimin, gjithnjë në respektim të vullnetit të tyre të lirë.

Përmes ofrimit të drejtësisë restauruese dhe veçanërisht të modelit të ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës, ftohen palët e përfshira në konflikt për të komunikuar e bashkëbiseduar me njëra-tjetrën për të gjetur zgjidhjen më të kënaqshme, gjithnjë në respektim të legjisllacionit. Zgjidhja alternative e konflikteve jashtë rrugës gjyqësore, përmes shërbimit të ndërmjetësimit, krahas influencës pozitive në krijimin e mirëkuptimit dhe harmonisë ndërmjet palëve, shkurton kohën e zgjidhjes dhe redukton edhe kostot financiare, si për palët e përfshira ashtu edhe për tërë sistemin që merret me administrimin e konfliktit.

Përmes përfshirjes në programin e drejtësisë restauruese, *i mituri i dëmtuar informohet mbi çfarë ndodhi, pse nisi konflikti dhe cila ishte e vërteta rreth historisë së konfliktit*; ai bëhet pjesë e kontrollit të trajtimit të situatës konfliktuale në të cilën është përfshirë.

Gjithashtu, përfshirja në programe restauruese u jep të miturve të dëmtuar dhe prindërve të tyre akses në:

- të drejtën për t'i bërë pyetje kundërvajtësit dhe për të marrë përgjigje;
- të drejtën për t'i shprehur kundërvajtësit ndjesitë dhe mendimet e tyre rreth dëmit të shkaktuar;
- të drejtën për të shprehur se si u ndien kur ndodhi vepra penale.

Sistemi i drejtësisë restauruese u jep gjithashtu mundësi autorëve të mitur të veprave penale:

- të kuptojnë dhe të marrin përgjegjësi për dëmin që kanë shkaktuar ndaj viktimave;
- të përmirësojnë situatën e tyre duke shmangur sjelljet devijante me natyrë kriminale;
- të marrin ndihmë për transformimin e ndjenjave;
- t'u kërkojnë ndjesë viktimave për dëmin e shkaktuar;
- të integrohen në jetën normale në komunitet;

Nisur nga praktika ndërmjetësuese dhe studimet e bëra, evidentohen qartë disa nga avantazhet e përfshirjes së të miturve në programet restauruese dhe veçanërisht në modelin ndërmjetësim-viktimë-kundërvajtës. Në vijim janë renditur disa nga këto avantazhe:

- shkurtim i kohës së zgjidhjes së konfliktit penal në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të rastit në një proces gjyqësor;
- kosto më e ulët financiare në raport me trajtimin e rastit në një proces gjyqësor;
- normalizim i marrëdhënieve ndërmjet palëve të të miturve të përfshirë në situatën konfliktuale;
- mënjanim i stresit, ankthit, frikës dhe pasigurisë që rrjedhin nga përfshirja në një situatë konfliktuale;
- riintegrim më i shpejtë i të miturve të përfshirë në një situatë konfliktuale në jetën sociale dhe në komunitet;
- lehtësim i sistemit të drejtësisë nga trajtimi i një numri çështjesh penale ku përfshihen të miturit;
- ulje e recidivizmit.

### **Përvoja në fushën e Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës, Drejtësia Restauruese për të Miturit në Shqipëri**

Komponenti i drejtësisë restauruese për të miturit (2006-2010) ka qenë pjesë e Reformës së Drejtësisë për të Miturit realizuar në partneritet nga UNICEF, Ministria e Drejtësisë dhe FZK dhe mbështetur nga Komisioni Evropian dhe SIDA.

Programi më i fundit i “Drejtësisë Restauruese dhe Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës për të miturit” (2010-2012), i cili po zbatohet nga Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve & Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, është bërë i mundur në sajë të bashkëpunimeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Shkollën e Magjistraturës. Programi është mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, UNICEF dhe Save the Children.

Falë partneritetit institucional të krijuar dhe të mbështetjes së arritur gjatë periudhës 2010-2012, programi është shtrirë në dhjetë rrethe të Shqipërisë, përkatësisht në Tiranë, Shkodër, Lezhë, Kavajë, Fier, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë.



Gjithashtu, në sajë të zbatimit të komponentit të ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese të zbatuar në Institutin e të Miturve në Kavajë-IMK (2011), mbështetur nga Save the Children dhe UNICEF, janë trajtuar dhe zgjidhur me sukses 14 raste konfliktesh ndërmjet të miturve në këtë institucion.

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2012, në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Shërbimit të Provës dhe FZK-së, punonjësit e shërbimit të provës kanë referuar në shërbimin e ndërmjetësimit 80 raste. Nga këto raste, 72 janë zgjidhur me sukses, 4 janë në proces dhe 4 kanë qenë të pasuksesshme.

Objekt konflikti për rastet e trajtuara dhe të zgjidhura me ndërmjetësim kanë qenë vepra të ndryshme penale të rrahjes, fyerjes dhe plagosjes së lehtë. Ka pasur edhe raste të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet palëve pas dënimit të autorëve për vepra penale të vjedhjes, plagosjes dhe vrasjeve.

Gjatë muajve të fundit është intensifikuar bashkëpunimi institucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe zyrat vendore të këtij shërbimi në rrethet përkatëse.

Pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit kanë qenë dhe veprimtaritë ndërgjegjësuëse dhe informuese për të dënuarit, kryesisht të mitur dhe të rinj deri në 21 vjeç, që kryejnë dënimin nën mbikëqyrjen e shërbimit të provës. Përmes seminareve të përbashkëta, të miturit dhe të rinjtë janë informuar për mundësinë e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese për normalizimin e marrëdhënieve konfliktuale ose të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet palëve.

- Diskutime në grup.
  
- Prezantim rastesh studimore

## MODULI 2

### PROCESI I NDËRMJETËSIMIT NË ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE

*(Aspekte procedurale dhe të metodologjisë së ndërmjetësimit)*

#### Objektivat:

- Analiza e procedurës së ndërmjetësimit dhe e hapave që duhet të ndiqen.
- Qartësimi i rolit të ndërmjetësit në këtë proces dhe i veprimeve që ai kryen.
- Dhënia e njohurive përmes demonstrimit të rolit lehtësues të ndërmjetësit në procesin e ndërmjetësimit të konflikteve ku përfshihen të mitur.

#### Rezultatet e pritura:

- Familjarizimi i pjesëmarrësve në trajnim me procedurën e ndërmjetësimit që është e ndryshme nga procedura gjyqësore;
- Ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve për vlerat pozitive dhe avantazhet që mbart shërbimi i ndërmjetësimit në zgjidhjen e konflikteve.
- Aftësimi i pjesëmarrësve në rolin e lehtësuesit dhe mbështetësit në zbatimin e drejtësisë restauruese për të miturit në konflikt me ligjin.

#### Metodologjia:

Aktivizim i pjesëmarrësve në lojë me role për seanca ndërmjetësimi, prezantim në PowerPoint etj.

#### Përshkrimi i modulit:

Seanca trajnuese nis me demonstrimin e rolit të ndërmjetësit, duke ndjekur hap pas hapi fazat dhe procedurën e ndërmjetësimit. Më pas, krahas trajtimit të hollësishëm të rolit të ndërmjetësit dhe të seancës së përbashkët ndërmjetësuese, pjesëmarrësit përfshihen në ushtrime duke performuar rolin e viktimës, kundërvajtësit, ndërmjetësit, mbështetësit, vëzhguesit etj.

### FILLIMI I PROCEDURËS LIGJORE TË NDËRMJETËSIMIT

Ndërmjetësimi përfshin në vetvete elementë ligjorë, ekonomikë dhe emocionalë. Sikurse çdo proces, ndërmjetësimi kalon nëpër disa faza që duhet të njihen dhe ndiqen me rigorozitet.

#### **Procedurat e Ndërmjetësimit**

*Referimi i rasteve*

Procedurat e Ndërmjetësimit për të miturit në kontakt me ligjin, ashtu sikurse edhe për të rriturit, përfshijnë rregullat dhe standardet që duhet të ndiqen për ndërmjetësimin, që nga faza fillestare e referimit të çështjes për ndërmjetësim, deri tek rezultati përfundimtar i procesit të ndërmjetësimit.

Ligji “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i miratuar në shkurt 2011, përbën referencën kryesore për realizimin e shërbimit të ndërmjetësimit. Ai përshkruan dispozitat bazë që duhet të ndiqen nga Ndërmjetësi si dhe bazën për procesin e plotë të ndërmjetësimit, duke filluar me referimin e çështjes e duke vijuar më pas me procedurën e ndërmjetësimit, caktimin e ndërmjetësit dhe raportimin në institucionin referues lidhur me rezultatin e çështjes së ndërmjetësuar.

Ndërmjetësi mund ta zhvillojë seancën e ndërmjetësimit në një vend të përshtatshëm për të cilin është rënë dakord me palët.

Në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, referimi i palëve në konflikt te ndërmjetësi ose zyra/qendra e ndërmjetësimit mund të vijë nga institucioni që arsimon ose trajton të miturin. Gjithashtu, referimi mund të vijë edhe nga vetë të miturit (palë në konflikt) ose nga prindërit e tyre.

Pas vlerësimit të konfliktit si i përshtatshëm për ndërmjetësim, ndërmjetësi ose zyra/qendra e ndërmjetësimit e pranon çështjen dhe e regjistron atë në librin e çështjeve për ndërmjetësim. Pas mbledhjes së informacionit të mjaftueshëm nga institucioni ose palët e interesuara, përgatitet njoftimi dhe u dërgohet palëve për të nisur procedurën e ndërmjetësimit.

Me referimin e rastit, palët ftohen të përfshihen në një proces komunikimi për të arritur në zgjidhjen me ndërmjetësim të konfliktit të tyre.

Në rastet kur çështjet nuk janë të përshtatshme për t’u zgjidhur përmes ndërmjetësimit, njoftohen për këtë me letër reference palët dhe institucioni referues.

Gjithashtu, kur rasti i trajtuar zgjidhet me ndërmjetësim, ndërmjetësi ose qendra/zyra e ndërmjetësimit dërgon një letër reference të shoqëruar nga aktmarrëveshja e arritur si dhe dokumentacionin përkatës në institucionin referues.

Edhe në rastet kur nuk arrihet zgjidhja me ndërmjetësim e çështjes së referuar, njoftohet përmes një letre reference institucioni që e ka dërguar çështjen.

#### *Hapat e ndërmjetësimit:*

- Procedura ligjore për ndërmjetësim fillon në datën kur është referuar nga gjykata ose një institucion tjetër si dhe kur palët bien dakord në rastet kur ata i drejtohen vetë shërbimit të ndërmjetësimit. Në çdo rast, kur njëra palë referohet në shërbimin e ndërmjetësimit duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet ndërmjetësimit, ndërmjetësi ose qendra/zyra e ndërmjetësimit duhet të kontaktojë palën tjetër duke e vënë në dijeni për kërkesën e bërë për ndërmjetësimin e mosmarrëveshjes si dhe duke i kërkuar konfirmimin për pjesëmarrjen ose jo në proces;
- Nëse pala tjetër nuk i përgjigjet kërkesës brenda një afati të caktuar të vendosur nga institucioni që e ka referuar rastin ose brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesë, atëherë çështja do të konsiderohet si mospranim;

- Kur palët në konflikt bien dakord për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, atëherë ndiqet procedura për caktimin e Ndërmjetësit. Palëve u bëhet e ditur lista e ndërmjetësve të licencuar nga Komisioni i Licencimit dhe ato bien dakord për ndërmjetësin;
- Fillimisht ndërmjetësi organizon punën dhe nis takimet veç e veç me palët. Më pas, ndërmjetësi njofton palët për seancën e parë të përbashkët të ndërmjetësimit;
- Në takimin e parë të ndërmjetësit me palët, diskutohet për rregullat bazë që duhet të njihen dhe respektohen nga palët në seancën ndërmjetësuese, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e shërbimit të ndërmjetësimit. Në funksion të mbarëvajtjes së seancës së ndërmjetësimit, në fillim të seancës, arrihet nënshkrimi nga ana e palëve e një marrëveshjeje për seancën e ndërmjetësimit (Modeli i Marrëveshjes 1).
- Ndërmjetësi mund ta zhvillojë procesin e ndërmjetësimit duke komunikuar me të dyja palët së bashku në të njëjtën kohë ose veçmas me secilën prej tyre, duke bërë kujdes që të manifestojë një sjellje të paanshme. Në rastin e takimeve dhe seancave të ndara, ndërmjetësi mund t'u japë palëve informacion për bisedat me palën tjetër me kusht që një gjë e tillë të pranohet prej palëve.
- Çdo e dhënë që del gjatë procesit të ndërmjetësimit mbetet konfidenciale.
- Procedura e ndërmjetësimit mbaron me arritjen e marrëveshjes për ndërmjetësim me shkrim të palëve të cilat pranojnë se procedura e ndërmjetësimit ka mbaruar me ose pa sukses (Modeli i Marrëveshjes 2).

## **Roli i ndërmjetësit dhe veprimet që ai kryen**

### *Fjala e hapjes së ndërmjetësit*

Fjala e hapjes së ndërmjetësit në sesionet e përbashkëta shërben si themel mbi të cilin palët mund të fillojnë të ngrenë zgjidhjen e konfliktit. Normalisht, ndërmjetësi përpiket të flasë me zë të qetë, jo zyrtar, dhe t'i bëjë palët të ndihen më mirë. Nuk ka ndonjë fjalim të përsosur për të gjitha rastet, por në vazhdim është një listë e çështjeve që duhen të merren parasysh gjatë fjalës së hapjes:

- U uron mirëseardhjen pjesëmarrësve në ndërmjetësim;
- Prezanton veten e tij lidhur me profesionalizimin dhe eksperiencën e fituar;
- Prezanton gjithë të tjerët – emrat dhe rolet në ndërmjetësim;
- Falënderon palët për mundësinë dhe besimin që i kanë dhënë për të qenë ndërmjetës në çështjen e tyre;
- Komenton lehtësitë dhe avantazhet që ofron shërbimi i ndërmjetësimit;
- Merr miratimin e tyre për të shpenzuar disa momente për të përshkruar procesin e ndërmjetësimit;
- Përshkruan procesin dhe rolin e ndërmjetësit;
- Konfirmon konsensusin për kohën;

- Sugjeron udhëzime (për dëgjimin me vëmendje, mosndërprerjen, qytëtarinë, respektin...);
- Pyet nëse ata kanë sugjerime të tjera;
- Konfirmon parimet bazë të shërbimit të ndërmjetësimit (konfidencialiteti, neutraliteti, paanshmëria, vullnetarizmi);
- U tregon palëve në konflikt se ata kanë të drejtë të jenë optimistë lidhur me zgjidhjen e çështjes në një mënyrë që përmbush interesat e tyre dhe se kjo varet nga ata;
- Njofton se nëse arrihet një marrëveshje, ajo duhet të dokumentohet.
- I pyet ata nëse kanë sugjerime ose pyetje të tjera rreth procesit,
- Pyet nëse kanë dëshirë të vazhdojnë me sesionin në mënyrën e përshkruar prej tij;
- Konfirmon që është nënshkruar Marrëveshja e Ndërmjetësimit;
- U kërkon palëve të mbajnë fjalë hapëse.

*Gjatë seancës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi bën kujdes në:*

- Vendorsjen e situatës së mirëbesimit ndërmjet palëve;
  - Caktimin e radhës së të folurit të palëve në proces;
  - Bërjen e pyetje të hapura, jo sugjestionuese si p.sh: Çfarë ka ndodhur? Pse jemi sot në këtë konflikt? Më shpjegoni si e perceptoni konfliktin?
  - Programimin në mënyrë të barabartë të kohës për secilën palë në seancën ndërmjetësuese;
  - Dhënien e kohës së të folurit të barabartë të dyja palëve;
  - Manifestimin e empatisë dhe bërjen herë pas here të një përmbledhjeje të bisedës së zhvilluar;
- Diskutim në grup
  - Raste studimore konfliktesh
  - Demonstrim situatash konfliktuale nga të pranishmit në trajnim

## Modeli i Marrëveshjes Nr. 1

Datë, \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

### MARRËVESHJA PËR PJESËMARRJE NË NDËRMJETËSIM

Në pajtim me nenin 17 të ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, kjo Marrëveshje nënshkruhet ndërmjet: (informacion mbi palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre):

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

Përshkrimi i mosmarrëveshjes:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Palët, pasi kanë pranuar parimet e ndërmjetësimit dhe pasi kanë rënë dakord për Ndërmjetësin e caktuar, bien dakord që të marrin pjesë në procesin e ndërmjetësimit për të zgjidhur mosmarrëveshjen mes tyre.

Gjithashtu, palët kanë rënë dakord edhe për sa më poshtë :

- Procesi i ndërmjetësimit do të zhvillohet në: \_\_\_\_\_ (vendi), \_\_\_\_\_ (orari).

Pala e parë

\_\_\_\_\_

Pala e dytë

\_\_\_\_\_

Ndërmjetësi

\_\_\_\_\_

## Modeli i Marrëveshjes Nr. 2

### MARRËVESHJE

Sot, më datë: \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_, në: \_\_\_\_\_, në përputhje me ligjin nr. 10 385, datë 24.02.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, nënshkruhet kjo marrëveshje ndërmjet:

(informacion mbi palët)

1.

---

---

2.

---

---

Përshkrimi i mosmarrëveshjes:

---

---

---

Detyrimet dhe kushtet e vendosura nga palët:

---

---

---

---

Mënyrat dhe afatet për përmbushjen e tyre:

---

---

---

Me vullnetin e tyre të lirë, palët deklarojnë se do t’i përmbushin me korrektësi të gjitha detyrimet dhe kushtet reciproke të përcaktuara në marrëveshje.

Pala e parë

Pala e dytë

---

---

Ndërmjetësi

---

## **Rast studimor**

### *Përshkrimi i rastit*

Rasti i konfliktit ka ndodhur në një paraburgim.

I mituri A. (pala e parë) është 18 vjeç , ndërsa i mituri N. (pala e dytë) është 15 vjeç. Të dy palët janë të paraburgosur dhe ndajnë të njëjtën dhomë paraburgimi. Një pasdite, kur të dy të miturit po shikonin televizor, pala e parë (A.) dëshironte të shikonte një ndeshje futbollit ndërsa pala e dytë një film. Në ato momente, të dy të miturit filluan të debatonin me njëri-tjetrin sepse A. kishte marrë pultin e televizorit dhe insistonte të shihte ndeshjen e futbollit ndërkohë që N ishte shumë i nervozuar dhe filloi ta ofendonte si dhe tentoi t'i merrte pultin. Të dy filluan t'i drejtoheshin njëri-tjetrit me fjalë fyese derisa A, filloi të godiste N. me grushte. Gjithashtu N., në gjaknxehtësi, iu kundërpërgjigj.

Roja i shërbimit dëgjoji që palët po rriheshin dhe menjëherë ndërhyri për t'i ndaluar. Njëkohësisht, lajmërohen edhe rojet e tjerë të sigurisë të cilët i shoqërojnë të miturit në izolim.

Me gjithë ndërhyrjen e policisë, palët, edhe pse të veçuar, vazhdonin të shanin dhe fajësonin njëri-tjetrin. Punonjësja sociale e sektorit të të miturve, pasi u vu në dijeni për rastin, bisedoi me të miturit për çfarë kishte ndodhur dhe vuri re që ata ishin shumë të zemëruar dhe insistonin të mos komunikonin me njëri-tjetrin. Për këtë konflikt u lajmërua ndërmjetësi nga Qendra e Ndërmjetësimit për të ndërmjetësuar në zgjidhen e mosmarrëveshjes dhe pajtimin e dy të miturve.

### *Takimi para ndërmjetësimit*

(Takimet paraprake me palët)

Ndërmjetësi, pasi informohet nga punonjësja sociale e sektorit të të miturve, shkon për të biseduar me palët. Të miturit kishin dëgjuar më parë për procesin e ndërmjetësimit si një mënyrë alternative për zgjidhjen e konflikteve. Megjithëse A. ishte disi dyshues për këtë proces, në Institucion iu shpjegua që ky shërbim ofrohej nga një zyrë e posaçme dhe marrëveshja kishte fuqi ligjore. Pas këtij shpjegimi, i mituri ra dakord që të ballafaqohej dhe të komunikonte me palën tjetër. Pala A. i tregoi ndërmjetësit variantin e tij të situatës duke theksuar shqetësimin që i kishte shkaktuar pala tjetër dhe motivin e nxehjes së tij. Ndërmjetësi, pasi i shpjegon procesin dhe vlerat e ndërmjetësimit si formë zgjidhjeje, i kërkon mendim për rrugëzgjidhjen e këtij konflikti me të miturin tjetër me të cilin ndan të njëjtën dhomë në paraburgim. Takimi zgjati rreth 45 minuta dhe në fund të takimit u nënshkrua raporti i takimit i cili u firmos nga pala dhe ndërmjetësi.

Ndërmjetësi gjithashtu bisedoi me palën e dytë N. e cila këmbëngulte se nxehja e palës së parë dhe goditja me grushte kishte qenë tërësisht e paarsyeshme dhe kjo kishte nxitur përshkallëzimin e situatës konfliktuale. Sërish, ndërmjetësi zhvillon një bisedë me të miturin duke i prezantuar domosdoshmërinë e përfshirjes në komunikim me palën tjetër për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme që do të kënaqte të dyja palët. Edhe në fund të këtij takimi u nënshkrua një raport i takimit që gjithashtu u firmos nga pala e dytë dhe ndërmjetësi.

### *Seanca e përbashkët e ndërmjetësimit*

Të miturit erdhën në seancën e përbashkët të ndërmjetësimit e cila u zhvillua në një ambient të përshtatshëm të institucionit. Ata vazhdonin të ishin të zemëruar me njëri-tjetrin megjithëse në



dukje ishin të qetë. Ndërmjetësi u shpjegoi rregullat të cilat duhet të zbatoheshin nga ata gjatë këtij takimi të përbashkët:

- Të respektonin njëri-tjetrin gjatë seancës së ndërmjetësimit,
- Të mos ndërprisnin njëri-tjetrin ndërkohë që flisnin,
- Të mos ofendonin njëri-tjetrin duke përdorur fjalë fyese etj.

Ai gjithashtu u shpjegoi palëve se gjithçka që ata do të diskutonin së bashku do të ishte konfidenciale.

Ndërmjetësi gjithashtu vuri në dijeni palët se marrëveshja e arritur nga ky proces do të hartohet në një formë të shkruar dhe do të firmosej nga të dyja palët.

Pasi ranë dakord për rregullat e mësipërme, palët u ftuan nga ndërmjetësi të shpjegonin variantet e tyre të situatës. I mituri A., pala e parë, duke qenë më i madh në moshë, pretendonte që të ishte ai që të vendoste rregullat në dhomën e përbashkët. Ky pretendim nuk pranohej nga i mituri N. me pretendimin se edhe ai kishte dëshirat e tij dhe jo gjithmonë duhej të toleronte.

Takimi zgjati rreth një orë dhe në fund të miturit ranë dakord që:

- A. (pala e parë) të pranonte pjesën e tij të përgjegjësisë dhe t'i kërkonte të falur N. (palës së dytë) për veprimet e tij të nxituara, por, nga ana tjetër, edhe N. pranoi t'i kërkonte të falur A. për veprimet e tij. Gjithashtu, ata pranuan që në vazhdim të jenë më tolerantë me njëri-tjetrin dhe të jenë pjesë e aktiviteteve të përbashkëta socio-kulturore duke ruajtur një komunikim korrekt dhe deklaruan se nuk do të përdornin më fjalë fyese. Ata pohuan se për çdo mosmarrëveshje do t'i drejtohen punonjësve të institucionit dhe ndërmjetësit për t'i zgjidhur ato me mirëkuptim.

Ndërmjetësi përpiloi një procesverbal për takimin e përbashkët dhe akt-marrëveshjen e pajtimit, të cilat u firmosën nga palët dhe nga ndërmjetësi.

#### *Post ndërmjetësimi*

Dy javë pas nënshkrimit të akt-marrëveshjes ndërmjetësi kontaktoi me palët në institucion. Ata u shprehën shumë optimistë për procesin e ndërmjetësimit dhe treguan se mes tyre nuk kishte pasur më asnjë mosmarrëveshje, madje ata ishin bërë dhe shokë dhe pjesën më të madhe të kohës e kalonin në aktivitete të përbashkëta.

ISBN: 978-9928-173-02-7



9 789928 173027